

HEJZA

Shazim Mehmeti, shkrimtar

BËRJA LETËRSI ËSHTË NJË BURG I BUKUR!

Bërja art është një lloj vuajtje e ëmbël, një lloj vuajtje që ti e kërkon, një lloj vuajtje pa të cilën s'bën dot. Është një kërkim përtej reales. Është një lloj dëshirimi për të bërë nga asgjëja një fluturim zogu

Në thjerrë

URREJTJA E KATALO- GIZUAR

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut asnjëherë nuk arritën që bashkërisht, të gjithë faktorët me relevancë, të organizonin debate, t'i tubonin subjektet kulturore, artistët, krijuesit, të shteroheshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do ta ndihmonin një strategji afatgjate kulturore e cila, do të ishte e paprekshme, pavarësisht ndërrimit të pushteteve



Nga Avni HALIMI

Në periudhën e "zgjimit etnik" për "rimodelim të kombit", kuazi-intelektualët maqedonas si dhe ata intelektualë të instrumentalizuar nga pushteti gruevskian, nisën realizime të shumë projekteve të cilët, fatkeqësisht, u rikthyen si bumerang dhe sot po i vuajnë pasojat vetë maqedonasit si asnjë komb në botë! U munduan të vjedhin histori, heronj, vlera të shumta nga trashëgimia kulturore, nisën t'i riemërtojnë gjetjet arkeologjike dhe, përtej kësaj "hajnie intelektuale", çuditërisht, hapën një front të provokimeve etnike duke shpresuar në ndonjë qërim hesapesh etnike në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve. Peng e kishin (madje, akoma e kanë) "poshtërimin" që e përjetuan nga konflikti 2001. Krahas përvetësimit të fakteve të huaja, nisën edhe me përçmim, ofendim e nënvlerësim të shqiptarëve rezidentë! Sa i përket përvetësimit të fakteve nga historiografia dhe arkeologjia greke e bullgare, tashmë ndërkombëtarisht janë obliguar që përmes komisioneve të ndryshme t'i revidojnë të gjitha shkrimet, tekstet, librat, botimet për një "popull maqedonas antik, me një mesjetë të begatë dhe me ngjare e heronj që qysh se u re-

hatua toka në sistemin e planetëve paskëshin luftuar dhe na qenkan angazhuar për Maqedoninë e sotme!

"Enciklopedia" e dështuar e filmit

Po kështu, tekste të pista ka pasur edhe për shqiptarët të cilët, madje u quajtën si cuba të zbritur nga malet që kanë plaçkitur, vlarë e detyruar maqedonas që të ikin "nga vatrat e tyre shekullore"! Heronjtë shqiptarë të 2001-shit u quajtën terroristë. Dhe, fatkeqësisht, edhe sot e kësaj dite këto tekste janë legale, përdoren nëpër shkolla dhe, të rinjtë maqedonas mësohen me të tilla teza fashizoide që nuk i bëjnë nder asnjë maqedonasi. Asnjëherë nuk u formuan komisione të përbashkëta shqiptaro-maqedonase, siç po funksionojnë komisione maqedono-bullgare, maqedono-greke! Të tilla tekste jo që akoma nuk janë reviduar, por gjenden të arkivuar, madje të katalogizuar e me isbn numra, të radhitura nëpër raftet e hapësirave të bibliotekave (në Shkup, Manastir, Shtip), nëpër të cilat nuk mund të kenë qasje qytetarë të rëndomtë (studentë dhe studiues shqiptarë)! Shqiptarëve mbase u thonë se e kanë tërhequr tirazhin e botimit problematik, por, në të vër-

retë, ato botim tashmë janë të regjistruar nëpër biblioteka dhe bëjnë jetën institucionale! Studiohen dhe përdoren si literaturë shkencore për citime, për fusnota!

Një prej "enciklopedive" të fundit dhe mjaft problematik ka qenë edhe "Enciklopedia e filmit", i autorit Georgi Vasilevski, botuar nga ShB "Kultura", sponsorizuar nga Ministria e Kulturës së RMV-së. Sipas autorit, bëhet fjalë për një enciklopedi që përfshinë ngjarje, personalitete e krijime nga bota e filmit. Ajo që të bie sakaq në sy është fakti i irritues e që ka të bëjë me përfshirjen e shumë aktorëve e filmave maqedonas që janë ngritur në nivelin e aktorëve dhe filmave botërore. Në kuadër të filmave dhe aktorëve botërore vend të konsiderueshëm zënë edhe filmat dhe aktorët serbë, pastaj ata kroatë, boshnjakë, turq dhe, si shkarazi do t'i jepet një shtyllë hapësirë edhe aktorit me përmasa botërore, Bekim Fehmiut. Asgjë nga bota filmike shqiptare! Fatkeqësisht, edhe në këtë rast vije në shprehje qëndrimi antishqiptar tashmë i brumosur në ndërdijen e disa qarqeve intelektuale maqedonase! Vasilevski, Bekim Fehmiu e quan "aktor serb"! Tekstualisht thuhet: "Bekim Fehmiu është aktor serb i filmit dhe i teatrit"! Tërë bota,

madje edhe vetë serbët e njohin si aktor shqiptar, përveçse maqedonasit! Autori i kësaj "enciklopedie" nuk nënvizon faktin që, në vitin 1987, në mënyrë demonstrative Bekim Fehmiu hoqi dorë nga shfaqja "Madame Kolontine" të autorit Anete Playel, edhe atë jo për shkaqe teknike, por pikërisht për faktin se serbët e kishin mbushur kupën e propagandës antishqiptare. Dhe, që nga ky moment, ai kurrë më nuk është ngjitur as në skenat e teatrit serb dhe as në sheshxhirimet e filmit serb!

Gënjeshtra e heshtur nis dhe e merr trajtën e së vërtetës! Në rastin e Bekim Fehmiut është vetëm një e vërtetë. Ai ishte shqiptar me rrënjë e me gjak. Fatkeqësisht, askush nuk u mor me këtë "Enciklopedi", heshtën të gjithë subjektet shqiptare, heshtën institucionet përkatëse kombëtare. Mbase duke u nisur nga një logjikë e mbrapshtë që projektet maqedonase t'i kundrojnë vetëm si "problemi i karakterit etnik maqedonas"! Megjithatë, si pasojë e këtij karakteri, raftet e bibliotekave nacionale maqedonase janë përplot me botime të katoligizuara që mes kopertinave ruhen shtrembërimet e fakteve, shpifjet, trillimet, urretjet antishqiptar të ca "akademikëve" maqedonas!

Morali i heshtjes

Trashëgimia kulturore është bazë e pacenueshme e një etnie, është Arka e ADN-së së një populli që ka një kontinuitet historik. Trashëgimia kulturore, është fakt autentik që flet për autoktoninë e një populli shumë të moçëm. Prandaj, relikte që janë pjesë e trashëgimisë kulturore e që vijnë nga atllasi i arkeologjisë, etnologjisë, folklorit, as nuk huazohen, as nuk mund të vidhen, as nuk mund të përvetësohen; madje as që lejohet që dikush të shërbehet me ato relike sa për ta krijuar identitetin e vet etnik, sepse kësaj i thonë IDENTITETI I TRAZUAR që jeta do ta mbajë mend si një shaka me fund tragjik! Kjo që po i ndodhë kombit maqedonas nuk i ka ndodhur asnjë populli në botë! Deri më vitin 2006 e kanë pasur për nder të konsiderohen ashtu siç janë, sllavë! Faktet historike thonë se sllavët u dyndën në Ballkan aty kah shekulli VI, domethënë që, zbritën në një vend të banueshëm, ku ka pasur një vend, ku ka pasur civilizim! Faktet historike mësojnë se në këto troje kanë jetuar fiset ilire si dhe paraardhësit e tyre! Meqë faktet historike e pranojnë se pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve janë shqiptarët e sotshëm, të cilët, për gati gjysmë shekulli komunizëm në Maqedoninë e sotshme, nga maqedonasit sllavë po trajtoheshin si qytetarë të rendit të dytë! Po pse ky superioritet të mos vazhdojë edhe më tej! Keqtrajtimi ndaj shqiptarëve nuk u sanksionua asnjëherë, për më keq, ky keqtrajtim robërues u fal prej vetë shqiptarëve! Grekët nuk i falën, madje e ngritën peshë krejt dynjanë se maqedonasit po i kërkonin rrënjët e tyre në antikë! Ishin "të detyruar" në këtë aventurë, madje jo vetëm teorike por edhe praktike, duke ndërtuar imazhe nga antikiteti, sepse, si pastaj të argumentohej dhe dokumentohej "e vërteta" maqedonase e shtypur edhe nëpër libra shkollor se, shqiptarët janë barbarë, janë ardhacakë, janë cuba që zbritën nga malet para 120 viteve dhe dhunshëm i pushtuan tokat antike maqedonase! Gjenerata të tërë janë shkolluar me tekste të tilla! Shqiptarët edhe më tej heshtën, sepse prioritet të prioritetet e patën "fqinjësinë e mirë", "Ope Ballkanin", "Korridorin 8"! Grekët nuk i falën, madje i ndëshkuan duke i detyruar ta ndërrojnë edhe flamurin edhe emrin e shtetit! Si "popull i Aleksandrit të Maqedonisë", trimërinë e tyre e paskan treguar edhe në luftëra për çlirim nga Perandoria Otomane, dhe më vonë edhe nga nazizmi (por nuk përmendim asnjë luftë kundër mbretërisë serbe e cila i pati serbizuar në rrënjë)! Luftëtarët e tyre paskan qenë heronjtë bullgarë, heronjtë shqiptarë që paskan luftuar për kauzën maqedonase! Shqiptarët heshtën (pati reagime intelektuale, por jo strategji politike kombëtare), sepse prioritet e kishin "fqinjësinë e mirë", "Ope Ballkanin", Korridorin 8, së fundmi edhe atë 10D (Prilep-Manastir)! Problem na bëri Dardanus-i, pllakë e nxjerrë gjatë punimeve për të ngritur ndërtesa mbi truallin arkeologjik të SKUPIT! Maqedonasit nuk lejoni që pllaka të fotografohet, sikundër as edhe hapësira ku dikush po tenton të ndërtojë diçka! Patriotët me bateri u ngritën në këmbë duke premtuar se pllaka do të përfundojë aty ku e ka vendin, në Muzeun e Maqedonisë! Patriotët të tjerë me bateri nisën gëzueshëm të flasin se janë paraqitur plotë shqiptarë që ta blejnë atë truall të Skupit ku u gjet Dardanus-i dhe të mos ketë shans askush ta prekë më atë tokë shqiptare! VvNë fakt, historia shqiptare në Maqedoninë e Veriut fillon me këtë dokument arkeologjik! Tjetër fakt nuk ka! Gazetari hulumtues, Marin Mema, u fut nëpër institucionet nacionale muzeale dhe, askund nuk gjeti asnjë gjurmë që do të dëshmonte për autoktoninë e shqiptarëve, si pasardhës të ilirëve. Madje, edhe një helmë që paska qenë e vetnija e njohur si "Helmë Ilire" nuk ekziston më, sepse maqedonasit paskan zbuluar se ajo paska qenë "Helmë Maqedonase"! Këtë pari nuk paska pasur ilirë, por vetëm kolonë romakë, të cilët, nuk dihet se kë e kanë kolonizuar!

Politikat kulturore me hapa të gaforres

Për këto tri dekada të sistemit post-komunist, të cilin, politikat nacionale ballkanike mundohen ta quajnë "sistem demokratik", Maqedoninë e Veriut e karakterizuan dhjetëra zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare. Pas çdo afere korruptive, pas çdo aksioni të montuar politiko-polikor, pas çdo nevojë për të legjitimuar (përmes vjedhjes së votës!) politikat destruktive, pushteti ka organizuar zgjedhje të parakohshme duke e "rimarrë" verdiktin

e popullit për të vazhduar edhe më tej me nëpërkëmbjen e dinjitetit dhe me rrënimin e të gjitha parimeve të integritetit si vlerë e pacenueshme e sistemeve të mirëfillta demokratik. Në kontekstin politiko-kulturor këto zgjedhje të parakohshme, si metodë perfide e legjitimitit të pushtetit korruptiv dhe dhunues, më së shumti i dëmtuan shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, sepse vazhdimisht hartoheshin strategji nacionale (me politika nacionale) për zhvillim të kulturës dhe, gjithnjë është kërkuar "mirëkuptim" nga partitë shqiptare që bëheshin pjesë e koalicionimit qeveritar që, ta pranojnë "strategjinë" nacionale maqedonase, kurse me vendim qeveritar do të intervenohet për avancim dhe "buxhetim" të kulturës shqiptare! Natyrisht, këto premtime asnjëherë nuk realizoheshin, sepse, niste faza e nacionalizmit maqedonas në prag të zgjedhjeve të parakohshme. Premtimet e rreme u bënë parim për çdo nomenklaturë politike maqedonase, ndërsa "politik-bërësit" shqiptarë të vetmin dert e kishin zgjatjen e sefasë në pushtet! Fokusi partiak në sferën e politikave kulturore përqendrohej vetëm në "aktivitete kulturore" militantësh, pa kurrfarë vizioni afatgjatë dhe kryesisht për interesa të ngushta retrograde. Pas plotë tri dekadave, cilët subjekte partiake shqiptare sot mund të flasin për "strategjitë politike" që u ndërmoren për ta ruajtur dhe për ta shprehur fuqishëm identitetin kulturor shqiptar! Pa dyshim, kombi shqiptar e ka shumë të fuqishëm identitetin e vet kulturor, por shtrohet pyetja, sa është vepruar për ta ruajtur origjinalitetin e këtij identiteti ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut?! Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut asnjëherë nuk arritën që bashkërisht, të gjithë faktorët me relevancë, të organizonin debate, t'i tubonin subjektet kulturore, artistët, krijuesit, të shtroheshin të gjitha mendimet dhe propozime që do ta ndihmonin një strategji afatgjate kulturore e cila, do të ishte e paprekshme, pavarësisht ndërrimit të pushteteve! Debate të tilla nuk pati, sepse partitë tona, fatkeqësisht, nuk dëshirojnë korniza vendimesh në të mirë të kulturës e në asgjësim të orekseve për përfitime partiake dhe të militantëve partiakë! Shqiptarët sot do të duhej të kishin një "manifest kulturor" i cili do t'i kushtëzonte

të gjitha subjektet që ia mësojnë formimit të qeverisë! Shqiptarëve nuk u duhen ministri, nuk u duhet as "kryeministri", nuk u duhet as kryetar parlamenti e shteti, sepse, të gjitha këto funksione janë për "kukulla"! Sa e sa ministra shqiptarë deri më sot kanë qenë nëpër qeveritë maqedonase, e megjithatë kemi pasur "enciklopedi" antishqiptare të "institucioneve" nacionaliste maqedonase; sa tekste shkollorë janë botuar me përmbajtje armiqësore kundër shqiptarëve; sa e sa procese të montuara janë zhvilluar kundër shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, sa e sa aksione policore, me të plagosur e të vrarë, janë ndërmarrë nëpër vendbanime shqiptare, sa e sa përçmime institucionale janë shprehur publikisht kundër arsimit, kulturës dhe avancimit të shqiptarëve! Kjo, sepse, partitë shqiptare nuk janë "subjekte shqiptarësh" por janë subjekte qeveritare që hartojnë dhe zbatojnë strategji politike të qeverive maqedonase të miratuar në Parlament! Komuniteti i artistëve shqiptarë tashe tri dekada pret një rend në shfrytëzim të parave publike për kulturë dhe, po kaq dekada pret të ketë edhe një qasje të përbashkët në paratë publike për të gjithë aktorët e kulturës! Mendimi kritik kundër diskriminimit kulturor të shqiptarët me tepër është "protestë" individuale se sa që është brengë kombëtare për një strategji nacionale kulturore që do të ndihmonte dhe do të nxiste në hartimin e politikave kulturore në nivel kombëtar. Pa dyshim, subjektet politike shqiptare nuk do të pajtoheshin me këto qëndrime editoriale, megjithatë, si do t'u përgjigjeshin këtyre pyetjeve: Si bëhet konkursi vjetor i Ministrisë për Kulturë, cilët janë kriteret sipas të cilave vendoset dhe, kush vendos? Modeli ekzistues financiar, a i përmushë njësoj nevojat e të gjithë institucioneve, asociacioneve, aktorëve të ndryshëm në sferën e kulturës dhe, a mund të bëhet kjo ekskluzivisht vetëm përmes një konkursi vjetor? Sa institucione nacionale nga sfera e kulturës u duhen shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe sa herë e kanë kushtëzuar formimin e qeverisë me pranim të politika kulturore të parapaparë në "manifestin kulturor" të dakordësuar nga të gjithë subjektet kulturo-politike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut!

Probleme identiteti

MËKAT TË MOS I MËSOSH FËMIJËS GJUHËN SHQIPE

(Kur mediokret fjalën poezi e përdorin në kuptimin inferior të saj, si "broçkulla ose përralla")

Jerida KULLA

Njollën që mendojnë disa se do ta ketë fëmija, njolla e fillimeve të emigracionit, është "vepër e të rriturve"

e jo e fëmijëve, por edhe kjo njollë është zbehur shumë dhe s'ka si të jetë ndryshe. Shqiptari nuk mund të zhvleftësohet nga disa, që me pas mediat, këtë pakicë e bëjnë të tërë.

Në festa familjare, bisedat vijnë e shkojnë, sa në një fushë në tjetrën dhe jo rrallë nxitin si padashur debate që flasin për sjellje dhe qëndrime të ndryshme, edhe pse prob-

lemet janë pjesë e pandarë e jetës së tyre. Kështu ndodhi edhe në familjen Bregu, ku kishin ardhur dy djemtë nga emigracioni e festonin ditëlindjen e vajzës së djalit të madh, që

familjarisht janë në Itali. Djali tjetër është emigrant në Greqi, së bashku me gruan dhe djalin 6 vjeçar. Bora, vajza që kishte mbushur 7 vjeç e i festonin ditëlindjen, recitoi bukur dy vjersha, një në shqip dhe tjetrën në italisht. Të gjithë të kënaqur e duartrokitën, ndërsa gjyshja e përqafoi dhe e puthi, dikush shkrepse celularin, trokisnin gotat dhe uronin ditëlindjen e vajzës. Çaste të bukura gëzimi. Ndërkohë e ftuan djalin gjashtë vjeçar, që dhe ai të përshëndeste me ndonjë vjershë. Kaluan disa çaste e djali nuk po fillonte. Ai ishte pak i ndrojtur dhe futej rrallë në biseda. Po nuk ishte kjo arsyeja, ai dinte vetëm pak fjalë shqip. Ndërrhyri babi i tij, të shfajësonte djalin, po në fakt djali nuk kishte faj, fajin e kishte babi dhe mami që nuk i mësonin gjuhën shqipe, as vetë dhe as në kurset e Mësimit Plotësues të Gjuhës Shqipe. Djali i tyre dinte më shumë fjalë greqisht se shqip. Po i vëmë më shumë rëndësi të mësojë greqisht dhe të dalë shumë mirë në të gjithalëndët,

se shqipja nuk do t'i hyjë në punë, nuk do të kthehet në Shqipëri, mjaft i ka të mësojë greqisht dhe anglisht. Nëna e vet i preu fjalën: "Jo bir, është mëkat, mëkat i madh të lesh djalin të mos dijë gjuhën shqipe, të mos dijë djali të bisedojë me nënën në telefon dhe me shokët kur të vijë këtu". E vërtetë është që, në emigracion, janë pak ata që ngurojnë apo e vënë në diskutim të mësojë apo jo fëmija gjuhën shqipe, po veç ka dhe të bën përshtypje këmbëngulja për të mbrojtur këtë qëndrim. Veç mendësisë se gjuha shqipe nuk do t'i hyjë në punë, se ai do të qëndrojë në vendin ku është, bie fjala në Greqi, Itali apo gjetkë, duan të fshehin identitetin e vet dhe të fëmijës, se sipas tyre do të ketë më shumë vështirësi për të ecur, nuk do të vlerësohet ai që është, por do të injorohet, nënvleftësohet. Sa e sa shembuj ka dhe vetë këta janë njohur, që fëmijë shqiptarë, nëpër shkolla janë bërë edhe krenaria e shkollës, për aftësitë e tyre e rezultatet e shkëlqyera.

Njollën që mendojnë disa se do ta ketë fëmija, njolla e fillimeve të emigracionit, është "vepër e të rriturve" e jo e fëmijëve, por edhe kjo njollë është zbehur shumë dhe s'ka si të jetë ndryshe. Shqiptari nuk mund të zhvleftësohet nga disa, që me pas mediat, këtë pakicë e bëjnë të tërë. Qëndrime indiferente gjen edhe në raste që nuk të shkon mendja se mund të ndodhin. Dikush nga të pranishmit solli dhe një shembull të dy familjeve që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, veç që gratë janë amerikane e burrat shqiptarë, të katër me arsim të lartë e puna i lidh të jenë në Amerikë dhe në Shqipëri, kanë qëndrim të ndryshëm për mësimin e gjuhës shqipe nga fëmijët. Fëmijët e njëjës familje e dinë gjuhën shqipe si gjithë shqiptarët dhe e zotërojnë shumë mirë edhe anglishten, ndërsa fëmijët e familjes tjetër dinë vetëm anglisht dhe mendojnë se e ardhmja e shpejtë është Amerika, e nuk ka pse të ngarkohet fëmija me mësimin e gjuhës shqipe.

Emigracioni gjithnjë ka pasur rol dhe ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e vendit në përgjithësi, por edhe të shkollës e gjuhës shqipe. Kush vinte nga emigracioni, jo vetëm ndryshonte ekonominë, por edhe veten, çlirohej nga mjaft paragjykime e pengesa, dhe i pasuruar me kulturë dhe mendim përparimtar, ndaj befasohesh, kur njihesh me sjellje e qëndrime që tregojnë boshllëk të disa emigrantëve ndaj mësimin të gjuhës shqipe nga fëmijët e tyre. Problemi kërkon reflektim e përgjegjshmëri nga vetë emigrantët, kontribut nga shoqatat e tyre, përmirësim të ndjeshëm të punës së strukturave shtetërore për të ndihmuar me libra, bazë materiale e zgjidhjen e mjediseve për zhvillimin e mësimin të gjuhës shqipe e jo vetëm të saj. Është për t'u përshëndetur gatishmëria vullnetare e shumë e shumë mësuesve për të punuar me nxënësit. Mundësitë janë shumë më të mëdha nga sa bëhet realisht.



Intervistë me Shazim Mehmetin, shkrimtar

BËRJA LETËRSI ËSHTË NJË BURG I BUKUR!

Bërja art është një lloj vuajtje e ëmbël, një lloj vuajtje që ti e kërkon, një lloj vuajtje pa të cilën s'bën dot. Është një kërkim përtej reales. Është një lloj dëshirimi për të bërë nga asgjëja një fluturim zogu

Intervistoi: Avni HALIMI

Shazim Mehmeti (lindur më 10. 11. 1958 në Gostivar) është poet, autor, studiues dhe piktor. Deri më tani ka botuar këto vepra: "Drejtshimi i humbur", poezi, 1991, "Shkallmimi i shtëpisë", poezi, 1992, "Varre dhe lumë", poezi, 1993, "Kam frikë nga le-hjet", poezi, 1994, "S'e besoj parajsën tënde", poezi, 1995, "Tullaci dhe netët me hënë", tregime, 1995, "Baladë për sedrën", tregime, 1998, "Lumenj që fluturojnë", poezi, 1999, "Zogjshpirti", poezi, 2002, "Stinë e kafshës", poezi, 2004, "Tregime", tregime, 2006, "Lumenjtë e dritës", poezi, 2009, "Pellgu i mësipërm i lumit Vardar", studim, 2009, "Rrëfime nga anëtejana", poezi, 2010, "Ngrëhina kadareane e ankthit në shtetin totalitar", studim, 2010, "Jeta autentike dhe kulti i ngrehinës në prozën e Kadaresë", studim, 2011, "Nën pemën e natës", poezi, 2011, "Trandafili i bardhë (prej reje)", roman, 2012, "Dromcat e dritës", poezi, 2013, "Shkrel Mali", roman, 2019, "Verbëri e dritë", poezi, 2019, "Pikë e papikë", poezi, 2020, "Metafora e kohëpushtimit (Piramida)", studim, 2020, "Metafora e qëndresës kombëtare (Kështjella)", studim, 2021, "Metafora e flijimit (Ura me tri harqe)", studim, 2022, "Hënë kureshtarë", poezi, 2023 Ka realizuar

edhe këto ekspozita personale me piktura: 1. "Loja e dhembjes", 2003, 2. "Fragmente", 2005, 3. "Ekspozitë personale: 2008 "Ekspozitë personale në kuadër të MNL "Ditët e Naimit", 2008. Shazim Mehmeti është prezantuar në shumë antologji të poezisë e prozës. Është doktor i shkencave filologjike dhe mësimdhënës me thirrje PhD në Universitetin e Tetovës. Jeton në Gostivar.

HEJZA: Krijimtaria letrare e Shazim Mehmetit shtrihet në dy periudha, në atë komuniste dhe në të tashmen demokratike; Shazim Mehmeti si krijues u lind në periudhën e censurës dhe vetë-censurës dhe po plakët në periudhën e lirisë krijuese! Kur keni shkruar më lehtë: dje apo sot? Kur shpërthen më fuqishëm poeti: kur e ka shpirtin në mengene apo kur është i lirë në burgun e vet krijues!

SH. MEHMETI: Librin e parë e kam botuar në vitin 1991. Në fund të periudhës komuniste kam filluar seriozisht të shkruaj ndonjë varg dhe besoj se jam me fat që nuk kam filluar të shkruaj më herët. Jeta ime ka pasur një orientim tjetër, në një profesion që ka qenë teknik - inxhinieri ndërtime. Por, krimbi i dashurisë për letërsinë, ka qenë gjithnjë aty. Padrejtësimi sistemor e ka bërë të veten, me një ndikim të domosdoshëm dre-

jt reagimit shpirtëror. Për aq pak sa kam shkruar në fund të periudhës së komunizmit, kam arritur ta njoh edhe censurën edhe vetë-censurën. Por, kjo vetë-censura, nuk është diç që i hiqet krijuesit, kur del në një lloj "demokracie". Vetë-censura vjen e rritet, sa më i madh bëhet ndërgjegjësimi shkrimtaresk për fjalën e shkruar. Gjithë bota mund të të lejojë të shprehesh si të duash, e vetja jote s'të lejon. Është vetja jote ajo që të udhëheq në rrugën e krijimit. Procesi i shkrimit është individual dhe është vetë shkrimtari ai që përcakton ç'bën a ç'nuk bën. Besoj se lirinë e shkrimtarit nuk mund ta uzurpojnë sistemet, pavarësisht egërsisë që mund të kenë. Sa më shumë thellohem, sa më shumë plakem e ndërgjegjësohem për letërsinë, aq më vështirë vendos të shkruaj. Por, ka një gjë që dua ta them këtu: meditimi dhe bërja letërsi është një burg i bukur. Burgu që shkrimtari ia ngrit vetes. Burgu ku drita nuk i vjen nga jashtë, por nga brenda. Ajo dritë e bën shpërthimin, lumturimin e shkrimtarit. Kur ndodh ky shpërthim a lumturim, shkrimtari nuk njeh sisteme, nuk njeh rregulla, nuk njeh trysni të jashtme, as vetanake, por e bën, e derdh atë masë lumturimi, e nxjerr atë baltë nga lukthi, nga vetja, dhe po n'atë çast që e ka derdhur në letër, fillon të

ndihet bosh, fillon të ketë nevojë për një lumturim ardhës, për një baltë ardhëse. Në një tregim timin e kam përshkruar pikërisht këtë ndjesi.

HEJZA: Çka do të thotë të jesh krijues shqiptar në Maqedoninë e Veriut?

SH. MEHMETI: Të jesh krijues shqiptar në Maqedoninë e Veriut, është shumë më pak se të jesh një punëtor krahu. Ja pse: një punëtor krahu derdh djersë, dhe kur mbaron dita e punës, e merr mëditjen sipas kontratës me punëdhënësin, kurse krijuesi nuk e ka atë "luks". Veprimtaria krijuese e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, por jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, nuk shpërblehet materialisht, ose nëse shpërblehet, e njëjta bëhet vetëm simbolikisht, me një honorar që s'është gjë. Shkrimtarët shqiptarë në këtë vend, janë lënë (dhe e kanë lënë veten) në një gjendje amorfe, pa asfarë organizimi, që do t'u mundësonte t'i dalin zot vetes. Nuk funksionojnë si tërësi organizuese, ose vetëm bëjnë sikur funksionojnë. Nga ana tjetër, shteti nuk ka një trajtim a përkujdesje si për krijuesit e nacionalitetit maqedonas, për ç'gjë jepen mjete materiale të bollshme, jepen çmime vjetore, etj, etj



Krijuesit shqiptarë, rrallë e hiçnderohen, dekorohen me çmime nacionale në Maqedoninë e Veriut, dhe nëse ndodh diç e tillë, kjo ndodh jo për vlerën, për arritjet, por në bazë të ndonjë miqësie a jaranie ekzistuese me dikë që është i faktorizuar n'anën tjetër. Këtu unë përmenda anë, dhe kur përmend anë, kjo gjë flet më së miri për ndasinë apo dallimet, apo diskriminimin, që bëhen në këtë vend padrejtësisht. Duhet thënë po ashtu, se kjo gjë nuk ndodh vetëm në kulturë, por në gjithë sferat e jetës. Shikuar së jashtmi, Maqedonia e Veriut, edhe mund të duket si një vend ku kanë ndodhur barazitë nacionale, por realisht nuk është kështu. Është shumë më keq se në dukje, dhe ç'është më e keqja, kjo padrejtësi nuk na vjen vetëm nga struktura e faktorëve sistemorë jashtë-shqiptarë, por edhe nga mosdija, mosafiniteti, mospërcaktimi, moskëmbëngulësia, mosdashja e strukturave shqiptare, që në një mënyrë a në një tjetër, marrin pjesë në pushtete, qofshin ato qendrore apo lokale.

HEJZA: Cili është trajtimi institucional shtetëror e cili është ai i institucioneve kombëtare ndaj krijuesit shqiptar që jeton dhe vepron në Maqedoninë e Veriut?

SH. MEHMETI: Më duket se pak a shumë e thashë më sipër. Por, sado që të kesh thënë, nuk i ke thënë të gjitha. Mendoj se përfaqësimi i shqiptarëve në sistem e në pushtete, bëhet në mënyra joadekuate. Sadoqoftë i mirë e i ndershëm, një zyrtar shqiptar në Maqedoninë e Veriut, nëse është i padijshtë, nuk mund të bëjë mirë as për kulturën, as për asgjë tjetër. Nëse rastësisht ndodh të jetë i dijshtë, por nëse nuk është i përkushtuar, e i interesuar t'i bëjë mirë interesit shqiptar në RMV, rezultati del i njëjtë. Në pushtetet e RMV-së, si përfaqësues shqiptarë duhet dërguar vetëm individë që dinë dhe duan të qeverisin. Detyrë e qeverisësve shqiptarë, nuk është vetëm mbushja e barkut me

qebapë e qofte te Destani, por bërja punë të palodhshme, drejt barazimit të njëmendtë sistemor të shqiptarëve me maqedonasit. Nuk ka asnjë kuptim të jesh brenda sistemit, dhe të mos bësh punë për barazinë e kombit tënd dhe fëmijëve të tu.

HEJZA: Secili krijues pasi të "çlirohet" prej veprës së vet, pret reagimin e kritikës letrare. Pret debate të lira, jo të stisura prej miqve e prej lexuesve të rëndomtë. A i kemi ne këto "vegla vlerësimi" dhe, nëse jo, për kë shkruan shkrimtari?

SH. MEHMETI: Nuk i kemi këto vegla. Dhe besoj se s'do t'i kemi edhe për shumë kohë. S'do t'i kemi, sepse nuk ka një nismë për të filluar t'i kemi. Sistemet apo segmente të caktuara të sistemeve në kulturë, nuk ndërtohen pa filluar të ndërtohen. Kritika letrare duhet të jetë një mekanizëm vlerësues kredibil, i sistemuar, i besueshëm, i saktë, minimalisht subjektiv, apo hiç subjektiv në qoftë e mundur, jomiklues, johatërbërës. Kjo lloj kritike do bëhej në njëfarë mënyre edhe urë lidhëse mes krijimeve dhe lexuesve. Veç kësaj, kjo lloj kritike do shërbente edhe si pikë referimi për orientime më të sakta, për investime në fushën e krijimtarisë, kulturës. Nuk është mirë të finanohen nga buxhetet, gjysmëvlera e hiçvlera, e budallaki të tilla. Paraja publike duhet investuar për gjëra dobie, e jo për "krijime diletante", që të bëjnë të vjellësh sa fillon t'i shfletosh. Kritika e mirëfilltë mund të ndihmojë të bëhen disi këto lloj pas-trimesh, që janë të domosdoshme. Mendoj se ka një përgjigje, për pyetjen "pse shkruan shkrimtari" dhe këtë përgjigje, besoj se çdo shkrimtar mund ta japë në mënyrë të vet. Unë shkruaj sepse nuk mundem të mos shkruaj. Shkruaj sepse shkar-koj. Shkruaj sepse ashtu zbrazem, lehtësohem. Shkruaj sepse shkrimi më mundëson të them: për veten, për njeriun, për dritën që është edhe në thelb t'errësirës, për terrin

që është edhe në thelb të dritës, për asgjë që mund të jetë gjithçka, për gjithçkanë që mund të jetë asgjë...

HEJZA: Atmosfera krijuese ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut lë shumë për të dëshiruar! Cilat janë arsyet dhe shkak-tarët për këtë atmosferë aktuale e cila po ndikon në pjellshmërinë e fushës së antivlerave. Shumë botues, shumë autorë, vlera pak!

SH. MEHMETI: Atmosfera vërtet lë për të dëshiruar, por jo vetëm ndër shqiptarët e Maqedonisë. Lë për të dëshiruar kudo ku jemi ne. Por, po i lejoj vetes të jem më pak serioz, dhe të them se një oborr pa pak bërllok, mund të jetë vetëm një oborr pa njerëz, pa pemë, pa zogj në pemët. Kësi lloj oborresh ka edhe në vendet me sisteme të përparura kulturore. Por, atje është një fshesë që funksionon, herë pas here. Del ajo fshesë dhe e bën pastrimin e oborreve, e mbeten aty të lulojnë vlerat, trëndafilat, a ndonjë mimozë, a ndonjë pemë me ndonjë bilbil që është vërtet këndues. Pastrimi bëhet vetëm me sistem. Atje, shtëpitë botuese që botojnë jovlera vetvetiu shuhen.

HEJZA: Dikur orët letrare, si manifestime, kishin karakterin institucional, kurse antologjitë llogariteshin si panorama reprezentative e familjes së krijuesve kombëtar. Sot, orët letrare i kemi zbritur në çaste argëtimi e dëfrimi me meze e me raki, kurse antologjitë i kemi bërë tezgë biznesi me turli-mall të zbukuruar me "produkte plastike" sa për ta kamufluuar kalbësirën dhe mykun!

SH. MEHMETI: Për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut nuk ka pasur një "dikur" të mirë, as institucional. Ka qenë keq dhe vazhdon të jetë keq. Dikur, sistemi i merrte dy tre krijues shqiptarë të një fushe të caktuar, dhe ua jepte atyre ekskluzivitetin e krijuesve të arrirë. Dhe për dekada të tëra, të njëjtit e përfaqësonin atë segment të kulturës shqiptare në Maqedoni, pa menduar kush për vlerat ardhëse. Mendoj se kjo ka qenë edhe një nga mënyrat e heshtjes së vlerave shqiptare në ardhje. Sot bëhet e njëjta gjë, por me një formë disi më të sofistikuar, duke na lënë që me duart tona ta vrasim veten. Dhe ç'është më e keqja, se si më duket se ne kemi më shumë se duar, për ta vlarë veten, kulturën tonë. Madje, se si më duket se ne jemi mjeshtrit më të mirë në botë për ta dëmtuar veten. Sa për antologjitë, mendoj se para se të bëhen, duhen matur gjërat mirë. Antologjive që janë produkt i një personi i cili figuron edhe si botues personal, mund t'u lejohen gabime a lëshime, por antologjive që dalin si botime shtëpish botuese, e sidomos atyre që dalin si botime institutesh, nuk u lejohen lëshime a gabime. Për fat të keq, ka edhe këso dukurish.

HEJZA: Kahet e krijimtarisë letrare bashkëkohore shqiptare! Kah po shkonkjokrijimtarit! Apo këngaidentitetishqiptar, apo është në përpjekjet e pareshtura për ta arritur atë identitet që do t'i rrinte bukur etnisë shqiptare!

SH. MEHMETI: Nuk besoj se mund të jap një përgjigje të saktë për këtë pyetje. Nuk ka një sistem që e qarkullon librin në gjithë trojet shqip-

tare, as në diasporë, ku kemi vërtet krijues të mirë. Nuk arrij të kem një pasqyrë më të saktë për tendencat në kuptim të pyetjes së bërë. Por, mund të them se kam bindje se letërsia është mbietnike, është universale, pavarësisht se të njëjtën e bëjnë letrarë nga etni të ndryshme. Një gjë mendoj se është e sigurt: nuk ka gjë përtej modernitetit, që në të vërtetë është mendimi. Mendimi i thellë. Mendimi për viset dhe gjendjet, ku nuk arrin drita e zakonshme. Këto shpikjet me parashtesat "post", mendoj se janë të shpifura, kamuflime të kota, bërje sikur, a ku di çka.


HEJZA: A mund të krijohet ky identitet me një Kadare, me një Bardhyl Londo, me një Basri Çapriqi, me një Qerim Arifi, me një Teki Dërvishi, me një Abdylazis Islami, apo, secili rajon duhet të ketë dyzinë shkrimtarësh, para të cilëve, as që do të guxonin të frymojnë pseudo-krijuesit!

SH. MEHMETI: Letërsia shqipe, ka shumë më shumë se kaq, edhe si vlera, edhe si numra. Janë një numër i konsiderueshëm shkrimtarësh shqiptarë, që janë në majat e bukurisë letrare. U takon sistemeve tona (shqiptarët, fatkeqësisht, janë pjesë të ndarë në disa sisteme të ndryshme) që të gjejnë mënyrapërt'ia prezantuar vlerat që kanë. Sidomos, del e nevojshme një nismë që shteti Shqiptar, përmes mekanizmave që ka, të gjejë mënyra për t'ia dhënë botës majat letrare që ka, në gjithë hapësirën, e jo vetëm ato brenda kufijve gjeografik të Shqipërisë.

HEJZA: Si është e mundur që një shoqëri ta frymëzojë e ta përkrahë shumëfish më tepër pseudo-vlerën se sa vlerën! Apo mbase për faktin që nuk ka kapacitet për ta çmuar vlerën! Ose, thjesht, kjo ndodhë sepse nuk kemi vlera! Megjithatë, kemi intelektualë, kemi profesorë akademikë, kemi institucione nacionale, por ku është zëri i tyre! Apo gjithçka është në fazën e letargjisë ku kemi rënë qysh pas Rilindjes Kombëtare?

SH. MEHMETI: Shoqëria është shoqëri, me gjithë virtytet dhe të metat që ka. Shoqërisë i ofrohen vlerat apo antivlerat, gjysmë-vlerat, jovlerat, etj... Çështje është, kush ia ofron shoqërisë gjithë këto? Kush është në pozicion të përkrahë e të ofrojë? Këtu rrinë fshehur Çelësi i drejt dhe Çelësi i dallkaukëve. Këto Çelësa (që të dy), janë thelbi i problem-it. Paramendo një ministër kulture që nuk ka lidhje me kulturën. Paramendo një zëvendësimistër të tillë a një tjetër zyrtar i lartë që ka marrë përsipër të bëjë detyra për kulturën. Paramendo një kryetar komune që s'di asgjë për kulturën, dhe që s'ka së paku një këshilltar meritore për kulturën. Funksionarë të tillë fare lehtë mund të ndajnë mjete e favore edhe për një pëllitje. Funksionarë të tillë mund të dekorojnë për merita edhe një dem. Funksionarë të tillë, mund të promovojnë si vlera edhe bërlloqe. Fatkeqësisht, kjo dukuri nuk po pakohet, por, nga gjenerata në gjeneratë, po shtohet. Secili që vjen, vjen më i zi se parapraku.

HEJZA: Identiteti në fakt është rrëfim! Cili është rrëfimi i identitetin tonë kulturor! Çka po bëjmë ne si bartës të vlerave kulturore, për ta



pasur këtë rrëfim unikat! A ndërtohet ky rrëfim me "inxhinierë" që kulturën politike e kanë aq periferike sa politikën kulturore i konceptojnë si urthin në kërcellin e misrit?

SH. MEHMETI: Identiteti ynë i vërtetë kulturor është mes nesh. Por, është i mbuluar, i pushpërfaqur, i ngulfatur nga aktorë që me bollëk i përmenda më sipër. Është i heshtur, i vënë në një gjendje kome. Aktualisht nuk është në dukje, por është aty dhe besoj se një ditë do shpërfaqet e do dalë në dukje, me gjithë bukuritë që ka, realisht.

HEJZA: E kaluara, thonë, është bazë e identitetit! Nëse sot kemi një identitet të lënduar e të plagosur rëndë, çfarë të nesërme si bazë identiteti po u lëmë gjeneratave që do të vijnë?

SH. MEHMETI: Vërtet, e kaluara është bazë e identitetit. Por, veç në dukje, identiteti ynë mund të jetë i plagosur. Esencialisht, shqiptarët kanë identitet të konsoliduar. Krahasuar me popujt përreth nesh, ne besoj se jemi në avantazh, në këtë lloj kuptimi. Ne kemi nobelistë më shumë se çdo popull tjetër në Ballkan. Po të ndalemi te proza, fjala bie, ne e kemi ndoshta shkrimtarin më të botuar nëpër botë. Në pikturë, po ashtu. Në fushë të humanitetit, po ashtu. Në trashëgimi kulturore, gjithashtu. Veçantitë e kulturës sonë janë aq të dallueshme, aq të padiskutueshme. Në shkencë, gjithashtu i kemi dhënë botës personalitete për shumë respekt. Kombi ynë, vërtet ndodhet në një krizë

udhëheqjeje, por kjo gjë është diçka e kalueshme, e shërueshme. Asketë të kombit lindin përditë dhe këta asketë një ditë do jenë në dukje, do jenë në gjallje. Diçka të tillë, tashmë kemi filluar të shohim, pavarësisht vështirësive që u dalin përpara. Jam shumë optimist në këtë lloj kuptimi.

HEJZA: T'i kthehemi krijimtarisë suaj! Ju krijimtarinë e ushtroni edhe në penel! Një poet piktor! Ju edhe mund të flisni si për gjuhën e shkrim-it ashtu edhe për gjuhën e ngjyrave. Cilat janë të veçantat e cilat të përbashkëta e këtyre dy gjuhëve krijuese? Thonë që gjuha letrare është plumb, e gjuha e ngjyrave melhem!

SH. MEHMETI: Besuat a jo, po ju them se ka shumë pak dallime mes gjuhës së fjalëve dhe gjuhës së ngjyrave. Të dy gjuhët vijnë nga brendia, nga ajo magmë që ndizet së brendshmidheshpërthen. Por, asarti i fjalëve, as arti i ngjyrave nuk mund të bëhet vetëm me atë magmën që ndizet së brendshmi dhe shpërthen. Asaj magme, qoftë me fjalë, qoftë me ngjyra, duhet dhënë formë. Duhet pasur një finesë prekjeje, ledhatimi. Nuk bëhet lehtë arti, as ai letrar, as ai piktoror. Bëra art është një lloj vuajtje e ëmbël, një lloj vuajtje që ti e kërkon, një lloj vuajtje pa të cilën s'bën dot. Është një kërkim përtej reales. Është një lloj dëshirimi për të bërë nga asgjëja, një fluturim zogu.

HEJZA: Itakonigjeneratës krijuese që shënjon kufirin në mestë krijimtarisë letrare që po kërkonte lirinë krijuese, format, shprehjet përtej krijimtarisë

konvencionale (në poezi e pikturë, përtej krijimtarisë përshkruese) dhe asaj krijimtarie bashkëkohore që po lundronte si në det të hapur, pa ndonjë shkollë konkrete krijuese. Shkollat krijuese janë laboratore të patjetërsueshme për gjetjen si të helmuesit ashtu edhe të kundërhelmit në krijimtarinë! Cili është perceptimi ynë kombëtar mbi shkollat krijuese si institucione nacionale, ku si nëpër faltore gjunjëzohet dhe lutet politika?

SH. MEHMETI: Nuk besoj se kemi një perceptim kombëtar mbi shkollat krijuese si institucione nacionale. Nuk besoj edhe se politika gjunjëzohet e lutet para tyre si në faltore. Në të vërtetë, besoj se politika do duhej të mësonte shumë nga Njerëzit e Vërtetë të Kulturës e të Shkencës (këtë e nënvizoj), sidomos në kuptimin e praktikimit të një morali të pathyeshëm, në veprim e në shpalosje. Pa kulturën si dije, nuk mund të ketë politikë që shpie përpara, drejt rregullimit të jetës së njerëzve. Politika jonë është në këtë hall që është, vetëm nga shkak se ka bërë një të ashtuquajtur Përrjashtim masiv nga vetja të Njerëzve të Vërtetë të Kulturës e të Shkencës. Në vend të tyre ka marrë brenda vetes dhe i ka ngarkuar me detyra të rëndësishme antipodet e Njerëzvetë Vërtetë. Kjo gjendje, ky lloj veprimi duhet ndërprerë sa më parë.

HEJZA: Poezia e juaj dëfton për përkushtimin krijues, për angazhimin vetëmohues në hulumtimin dhe gjetjen e shprehjeve poetike origjinale të shtresuara nëpër palë shpirti. Ky ekzaminim mistik

natyrisht që dhemb, që trishton, që të çon në delir, prej nga kthimi në vete shënon aktin e lumturisë. Apo, ju si krijues produktiv, tashmë jeni mësuar me dhembjen, trishtimin dhe nuk ju bën përshtypje çasti i lumturisë, i asaj lumturie që ndjehet sapo të hidhen hapat e para pas ngritjes nga shtrati i lëngimit! Shkrimtari pas përfundimit të veprës del dhe ngritet si nga anestezia totale, apo!

SH. MEHMETI: Do kisha dashur shumë të jetë kështu si e thoni ju në fillim të kësaj pyetjeje. Por, besoj se asnjë krijues serioz nuk arrin të jetë i kënaqur me veten. Krijimi është si të gjeturit në një fushë sporti, në një garë, por ku garimi nuk bëhet me të tjerë, por bëhet e zhvillohet me veten tënde. Në këtë lloj garimi, gjithnjë del fituese brendia jote e pakënaqur. Shkrimtari, sado qoftë me përvojë, mbetet gjithnjë një fëmijë që i gëzohet lodrës që e ka bërë vet. Pas çdo krijimi ndjehet një kënaqësi të bërjes, që më përzihet disi me pakënaqësinë e bërë më mirë e më mirë. Për shkrim pashmangshme të dëshirimit për të tarin, fatkeqësi e madhe është ndjesia e të qenit i kufizuar në mendim e imagjinatë. Besoj senjëndjesiekëtitillë, është përcaktuese në këtë lloj zanati.

HEJZA: Projekti letrar i radhës?

SH. MEHMETI: Një libër me tregime dhenjë tjetër me poezi, që tashmë janë shkruar dhe presin botimin, dhe një roman që më lëviz në mendje qe disa vjet, dhe që pret të ulem ta bëj fjalë.

Bashkimi kulturor, mision i (pa)mundshëm

PSE TË SUNDËHEMI NGA BANALITETI!

Sot, në fushën e internetit të gjithë "shkruajnë" e dalin në televizor dhe "shesin" mend, flasin pa menduar, nënvleftësojnë, ngulfatin letërsinë nacionale, duke u "marrë" me letërsinë e shekujve të kaluar nëpër botë

Puntorie Muça ZIBA

E dimë se dituria lulëzon bashkë me letërsinë, prandaj misionarët letrar duhet ta shpëtojnë nga shkatërrimi këtë epokë krijuese. Letërsia shqiptare nuk duhet të ketë kufi gjeografik. Ajo ka qenë dhe duhet të jetë një letërsi me halle, probleme dhe shqetësime të përbashkëta të të gjithë krijuesve autokton. Për të bashkuar shpirtin kulturor, duhet në të gjitha anët e banuara me shqiptarë të luftohet diletantizmi, smira, injoranca... Sot, në fushën e internetit të gjithë "shkruajnë" e dalin në televizor dhe "shesin" mend, flasin pa menduar, nënvleftësojnë, ngulfatin letërsinë nacionale, duke u "marrë" me letërsinë e shekujve të kaluar nëpër botë. Pështirosesh duke i dëgjuar disa lexues jo të mirëfilltë që më shumë kapen për kopertina sesa për brendinë e romaneve ose veprave të zhanreve tjera, si ato poetike dhe dramatike. Të shtyrë nga snobizmi gjoja se:

"Jam lexues i madh nëse deklaro hem si "lexues" i " Zonjës Bovari" etj. Pastaj, pa pasur bezdi se i dëgjojnë lexuesit dhe studiuesit serioz të letërsisë botërore dhe nacionale, fillojnë tregojnë përralla me mbretër. Në mediumet vizuale dikush ta fut frikën në palcë. Pas kësaj që po e shkruaj, më ndjek pyetja se ku fillon e keqja e kulturës kombëtare. Aty ku më së shumti duhet t'i kushtohet rëndësi bashkimit kulturor dhe letërsisë së mirëfilltë, u jepet mundësia të futen në programet kulturore disa njerëz që marrin rolin e ndërmjetësuesit, duke ua imponuar lexuesve disa emra shkrimtarësh të njohur e të panjohur botërorë. Ata me një dinakëri të çuditshme neglizhojnë dhe e turpërojnë letërsinë cilësore nacionale. Për të qa e për të qesh kjo punë. Nuk e di kur do të fillojmë ne shqiptarët të merremi më shumë me veten. Përse duam aq shumë ta vrasim veten e t'u bëjmë elozhe të tjerëve. Po ua kujtoj qëndrimin konformist

të politikave kulturore në Shqipëri, Maqedoni e Kosovë, jo seriozitetin e shumicës që japin dezinformata, që ngatërrojnë lexuesin dhe krijuesin në rrugën drejt bashkimit kulturor të trojeve tona. Disa nga brezi i ri, haptas shkëpusin kontaktin me letërsinë që krijohet në këtë periudhë kohore. Kjo të ngjall tmerr. E dimë se dituria lulëzon bashkë me letërsinë, prandaj misionarët letrar duhet ta shpëtojnë nga shkatërrimi këtë epokë krijuese. Letërsia shqiptare nuk duhet të ketë kufi gjeografik. Ajo ka qenë dhe duhet të jetë një letërsi me halle, probleme dhe shqetësime të përbashkëta të të gjithë krijuesve autokton. Për të bashkuar shpirtin kulturor, duhet në të gjitha anët e banuara me shqiptarë të luftohet diletantizmi, smira, injoranca... Sot, në fushën e internetit të gjithë "shkruajnë" e dalin në televizor dhe "shesin" mend, flasin pa menduar, nënvleftësojnë, ngulfatin letërsinë nacionale, duke u "marrë" me

letërsinë e shekujve të kaluar nëpër botë. Pështirosesh duke i dëgjuar disa lexues jo të mirëfilltë që më shumë kapen për kopertina sesa për brendinë e romaneve ose veprave të zhanreve tjera, si ato poetike dhe dramatike. Të shtyrë nga snobizmi gjoja se: "Jam lexues i madh nëse deklaro hem si "lexues" i " Zonjës Bovari" etj. Pastaj, pa pasur bezdi se i dëgjojnë lexuesit dhe studiuesit serioz të letërsisë botërore dhe nacionale, fillojnë tregojnë përralla me mbretër. Në mediumet vizuale dikush ta fut frikën në palcë. Pas kësaj që po e shkruaj, më ndjek pyetja se ku fillon e keqja e kulturës kombëtare. Aty ku më së shumti duhet t'i kushtohet rëndësi bashkimit kulturor dhe letërsisë së mirëfilltë, u jepet mundësia të futen në programet kulturore disa njerëz që marrin rolin e ndërmjetësuesit, duke ua imponuar lexuesve disa emra shkrimtarësh të njohur e të panjohur botërorë. Ata me një dinakëri të çuditshme neglizhojnë

dhe e turpërojnë letërsinë cilësore nacionale. Për të qa e për të qesh kjo punë. Nuk e di kur do të fillojmë ne shqiptarët të merremi më shumë me veten. Përse duam aq shumë ta vrasim veten e t'ubëjmë elozhet tjerëve. Po ua kujtoj qëndrimin konformist të politikave kulturore në Shqipëri, Maqedoni e Kosovë, jo seriozitetin e shumicës që japin dezinformata, që ngatërrojnë lexuesin dhe

krijuesin në rrugën drejt bashkimit kulturor të trojeve tona. Disa nga brezi i ri, haptas shkëpusin kontaktin me letërsinë që krijohet në këtë periudhë kohore. Kjo të ngjall tmerr. Edhe pse qysh në fillim të tranzicionit, bashkë me bashkimin ekonomik filloi edhe bashkimi kulturor, ai sot po zbehet më shumë se kurrë. Politikat nacionale kulturore duhet të formojnë strategji kombëtare për

bashkimin kulturor. Libra leximi të përbashkëta, lektura shkollore të përbashkëta nga autor bashkëkohor për shkollat nëntëvjeçare dhe për shkollat e mesme. Edhe pse i domoshëm si ajri që e thithim, shpeshmë duket më i rëndë se shkrepit e malit ky projekt. Mendoj se gjithçka duhet të nis nga politikat kulturore, nga institucionet arsimore e kulturore, nga shoqatat serioze të shkrimtarëve dhe

nga disa asociacione tjera, me qëllim që, për një kohë jo shumë afatgjate, gjithçka të vjen në vend të vet. Ne jemi një komb me të njëjtën kulturë, prandaj nuk duhet të sundohemi nga banaliteti, nuk duhet t'i harrojmë të vdekurit nën bli që lanë pas vetes vepra cilësore letrare e shkencore dhe të gjallët që përpëliten flatra-këputur për t'i lënë kombit perla e për ta mbajtur gjallë shpirtin kombëtar.

Retro

MBI IDENTITETIN

Shënimi më karakteristik në Albumin e Shtëpisë së Hajnrih Bëlit ishte i Agim Çavdërbashës. Mbante datën 26 (e shtunë) mars 1995, shkruar në orën 15.00. Me gjasë, një ditë para se të largohej nga Langenbroich. Nuk ishte tekst lavdëruar. Përmes emrave që i kishte shënuar aty, kishte lënë një mesazh

Nga Ali PODRIMJA

1.

Se ç'është thotë të kesh shtet, e pashë në bibliotekën "Humanisti" në Selesat të Alzasit (Francë), ku kishte dokumente nga shek. VII, të ruajtura e të sistemuara, të kohës kur zbritën fqinjët tanë nga Karpatet. Ç'është më interesant, pashë aty dhe certifikata të kurorëzimit, të lindjes e të vdekjes të vendësve nga shek. XV. Mësim ky si ruhet identiteti edhe pse në këtë hapësirë kishin ndodhur luftëra të mëdha në mes gjermanëve dhe francezëve. Me habi e kisha shikuar kustosin. Pasi kishte kuptuar shqetësimin tim, kishte luajtur vetëm kokën. Edhe pse gjendesha në një tempull zoti, kisha sharë. Ç'kisha hequr të zotit e ullirit me certifikatat e mia, të fëmijëve e familjes. Me plotë gabime e defekte m'i kishin lëshuar. E kisha të qartë pse ndodhte një gjë e tillë. Regjimi serb bënte luftë speciale ndaj çdo shqiptari edhe përmes një dokumenti të rëndomtë. Asnjë dokument të mos jetë në rregull

dhe plaçkitja të ndodhë në mënyrën serbe. Turr e vrap pas identitetit që ndrydhej, përdhunosej e nxirrej margjinave ose pas grilave. Vandalizëm i paparë ndodhi edhe në vendin e shqipeve në vitin 1997. Rrënim i arkivave, i muzeve, i institucioneve kulturore me rëndësi kombëtare, bënë të dyshosh se aty patën dorë edhe fqinjët tanë. Si u bë të rrënohet çdo gjë, që ka të bëjë me identitetin e një populli. Dhe, prapë nga fillimi, më të varfër e më të nënçmuar. Duke parë këtë asgjësim të vetvetes, nuk mund të mos pajtohesh se ngjashëm ndodhi rrënimi i Ilirisë; se atë vetë ilirët e zhdukën, të mbështetur ndoshta dhe nga faktorët e jashtëm. Pra, ç'zezë na ndjek? Bëhet çmos të na fshijnë edhe për së gjalli! Faji është yni... Një vandalizëm i tillë, kam përshtypjen se nuk ndodh as në Afrikë. Por ja, ndodhka në vendin e shqipeve, ku nuk ka shtet as pushtet, siç thotë një mik imi poet. Vërtet, ç'ndodh me ne? Bulshitë plotë i kemi atdheadashuri e nuk dimë të ngrisim as të mbrojmë një arkiv, një bibliotekë, një institucion me rëndësi kombëtare. Na

humbasin dokumente e dëshmi elementare të identitetit tonë, se sillemi me vendin si me brek femre. Na i formojnë emrat, datëlindjet; na falsifikojnë shumë gjëra, ashtu si u teket. Nëse lejojmë prapë të na shkëlin aty ku është më e dhembshme, pse atëherë mashtrojmë veten me gjithfarë përrallash? Nuk është e thënë të kemi vetëm shtet, por atë ta mbajmë e ta forcojmë si i ka hije një populli të qytetëruar. Është turp të na përsëritet në hyrje të mileniumit të tretë balada e Urës së Shenjtë: prish e ndërto, ndërto e prish deri në asgjësim...

2.

Shënimi më karakteristik në Albumin e Shtëpisë së Hajnrih Bëlit ishte i Agim Çavdërbashës. Mbante datën 26 (e shtunë) mars 1995, shkruar në orën 15.00. Me gjasë, një ditë para se të largohej nga Langenbroich. Nuk ishte tekst lavdëruar. Përmes emrave që i kishte shënuar aty, kishte lënë një mesazh. Për mua ishte i qartë. Tjetërkush mund ta konsiderojë ndryshe. Në tërë faqen ishin rendi-

tur emra, që tregonin për formimin, karakterin e synimet e krijuesit. Shënimi fillon me Drilon, Rrita e përfundon me Butrint (Sh.). Emrat ishin burimor dhe vërehej se krijuesi mbështeste identitetin. Tentimi i tij thoshte shumë për të si krijues e njeri. Hedh dritë, po ashtu, mbi veprën e tij e sidomos mbi skulpturat e punuara nga guri-mermeri, që kanë një bukuri e abstraksion të veçantë. Dhembjen njerëzore e kisha hetuar edhe në një vizatim të pagëzuar "Gratë e Lybeniqit". Në luftën e fundit, nga barbaria serbe Lybeniqi u bë shkumb. Ra aty gati e tërë familja e mikut tim të ndjerë Gani Bobit. Mirëpo mesazhin që e kishte lënë skulptori, duhet forcuar e pasuruar dhe duhet mbrojtur me dinjitet nga shpërbërjet e mëdha brenda e jashtë nesh, që ndodh nganjëherë edhe nga pakujdesia jonë. Shenjën kombëtare nuk bën ta konsiderojmë si cohë të hedhur para këmbëve të dajave...

(VEPRA, vëllimi IX, ASHAK, Prishtinë, 2013)



Një interpretim i fotos së rrallë

NDEZJA E CIGARES

Shkrepja fotografike është realizuar në vitin e largët 1956, gjatë kohës kur në fshatin e ri po xhirohej filmi dokumentar "Pranvera e nëntë" nga Kinostudioja "Shqipëria e Re", kushtuar kooperativës "Asim Zeneli" dhe sukseseve të saj ekonomiko-shoqërore

Qerim VRIONI

Në vitin 1942 Shqipëria ishte e pushuar nga Italia dhe Departamenti i Shtetit nuk e njihte më Konicën si përfaqësues diplomatik të vendit të tij. Jeta e Faik Konicës në Uashington ishte modeste. Paguante qiranë e apartamentit, rreth 80 dollarë në muaj, pastaj stenografen dhe sekretaren Charlotte Graham, e cila punonte për të prej 12 vitesh, si dhe shërbyesit, Hattie Williams me burrin e saj. Kohët e fundit kishte marrë para borxh nga disa miq, diçka më pak se njëmijë dollarë. Jetonte si një aristokrat i rënë nga vakti, sepse, ndërsa merrte hua për të shtyrë pagesën e qirasë, në garderobën e tij kishte ndonja dhjetë kostume shik, një numër palltosh, plot kapele e këpucë si dhe një koleksion të bukur veshjesh zyrtare. Ishte e hënë, ora 5 pasdite e datës 14 dhjetor, kur Faiku pësoi hemorragji cerebrale. Hattie, që i kishte shërbyer prej vitesh, e gjeti të rrëzuar në banjë dhe e ndihmoi të shkonte në shtrat. Faiku kërkoi të telefonohej sekretarja dhe ajo arriti pas 30 minutash. Charlotte ishte një grua e përpiktë dhe e sjellshme dhe Faiku i besonte ashtu si vetes së tij. I tha se kishte një dhimbje të fortë në sy dhe Charlotte propozoi të thërrisnin mjekun, Robert Oden. Megjithë kundërshtimet e Faikut, mjeku u thirr. Dr. Oden, ndër më të njohurit e Uashingtonit dhe mik i vjetër i Faikut, e kuronte nga hipertensioni kronik prej 14 vjetësh. Dr. Oden i mati tensionin. Aparati tregonte 250/140 dhe mjeku tha se Faiku ishte në rrezik prandaj duhet të merrej një infermiere ose të dërgohej në spital. Charlotte vendosi ta kalonte natën në apartament. Vonë në mëbrmje Faiku e thirri nja dy herë, pastaj kërkoi ujë. Para mesnate, kur Charlotte kishte filluar t'i shkruante një letërtë shoqit, i cili shërbente në Forcën Ajrore, vuri re se Faiku kishte vështirësi në frymëmarrje por nuk dukej dhe aq keq. Fliste përçar, "there is no answer", thoshte në anglisht, "përgjigja nuk po vjen". Sekretarjashkoi të marrë një sygjumë në divanin e dhomës së ndënjës dhe u zgjua në 5 të mëngjesit. Ai dukej se flinte i pabeddisur, i shtrirë në kurriz me krahu e majtë nën kokë. Nga ora 8, Charlotte shkoi ta shohë përsëri. Ai nuk kishte lëvizur fare dhe sytë i kishte paksa të hapur dhe të përhumur. I telefonoi Dr. Odenit, i cili e udhëzoi t'i prekte dorën. Ajo ishte e ftohtë dhe e sertë. E kuptoi se Faiku ishte shuar. Ishte data 15 dhjetor 1942. Dr. Oden i tha se do të vintasapote mbarontenjë operacion. U vendos që trupi të dërgohej në shtëpinë e funeraleve Hysong aty pranë. Gjërat kishin ndodhur



shpejt dhe Charlotte ishte e hutuar. Dr. Oden pyeti për familjen e të ndjerit, nëse sekretarja e dinte se ku ndodheshin njerëzit e tij. Pyeti për gjendjen financiare të Faikut, pasi duhej një garanci për shërbimin funeral. Charlotte i tha se Faiku kishte 15 dollarë e 54 cent në apartament, por priste një pagesë prej 2,100 dollarësh, që ministri i Oborrit, Martini, kishte nisur me kabllogram nga Londra. Pasdite, në telefon u paraqit Wesley Jones, zyrtar i sektorit të çështjeve evropiane, të cilit Charlotte i tregoi me hollësi se ç'kishte ndodhur. Folën për arkivat e legatës shqiptare dhe ajo i tregoi se ato, bashkë me vulat, i ishin dorëzuar me kohë ambasadës italiane. Në apartament, i tha, nuk ka asnjë objekt zyrtar të qeverisë shqiptare dhe të gjitha dokumentet e sendet e tjera janë pronë e tij personale. Certifikatën e vdekjes së Faikut me logon District of Columbia e firmosi Dr. Oden. Pasi shënoi vendlindjen e të ndjerit, Konitza, Albania, shkroi datën e lindjes, 15 prill 1876 dhe të vdekjes, 15 dhjetor 1942. Disa nga gazetat e mëdha të Amerikës i kushtuan vdekjes së Faik Konicës nga një kolonë modeste. Meqenëse ai kishte tre vjet e ca që ishte shkëputur nga qarqet diplomatike, harresa kishte bërë punën

e saj prandaj një pjesë e mirë e fakteve rreth të ndjerit ishin të pasakta. Një gazetë lokale e ngatërronte me të vëllanë, Mehmetin. Në New York Times ai përmendej më tepër si dramaturg dhe pastaj flitej për atë historinë e tij të çuditëshme me Ann Corion. Megjithatë, disa nga të vërtetat e njohura thuheshin. Washington Post-i përmendte, për shembull, "aftësinë e tij të shkëlqyer të të shprehurit" dhe "sësin e mrekullueshëm të humorit". Askushnështypinamerikannukekutoi Faikun më bukur sesa kritikui Sekretarit Hull, Drew Pearson në rubrikën The Washington Merry-go-Round: "Një diplomat i vjetër dhe i vetmuar vdiq thuajse pa u vënë re në Uashington. Ka ndodhur që edhe ndezja e cigares (apo llullës dhe pipës) një të panjohuri, të bëhet shkas për njohje, madje dhe për lidhje miqësore, pra fija e hollë e shkrepës, përpos cigares ka ndezur dhe zjarrin e miqësisë midis dy njerëzve. Ky nuk është rasti i fotos tonë që po e titullojmë thjeshtë "Ndezja e cigares". Veçse, çastet e ndezjes së cigares edhe këtu, si rëndom, kanë një farë qetësie dhe përzemërsie. Nga hulumtimet e deritanishme është gjetur se dy burrat e fotos janë barinj nga Progonati (Kurvelesh), të zbritur në fushën e Dropullit (Gjirokastër) rreth vitit 1948, me

rastin e krijimit nga pushteti i kohës, të Kooperativës blegtorale "Asim Zeneli". Arsyeja e kësaj nisme ishte për të ndihmuar popullatën e zonës malore të Kurveleshit për një jetë më të mirë. Burimet e saj njerëzore do të ishin blegtorë (bashkë me familjet e tyre) nga tri fshatra të krahinës, Progonati, Lekdushi dhe Golemi, të njohura për mbarështimin e bagëtive. Në foto shihet bariu Musto Gugaj, me fytyrë të paqetë dhe brucë të zezë, i cili pasi ka ndezur llullën e tij, i afron qetësisht shkrepësën e ndezur kolegut të tij, Abaz Haxhiajt. Ky duket shumë i përqendruar, mbulon flakën e saj me duar për të mos u fikur e duke thithur thellë cigaren (ndoshta e dredhur vet me letër gazete). Në ndryshim nga Musto Guga, Abaz Haxhiaj mban hedhur supeve një pallto të madhe qyteti. (e dhënë përkohësisht ndoshta nga fotografi). Në një nga ato çaste ata edhe janë fotografuar. Shkrepja fotografike pa dyshim është realizuar në vitin e largët 1956, gjatë kohës kur në fshatin e ri po xhirohej filmi dokumentar "Pranvera e nëntë" nga Kinostudioja "Shqipëria e Re" kushtuar kooperativës "Asim Zeneli" dhe sukseseve të saj ekonomiko-shoqërore. Regjisor dhe skenarist i filmit ishte kineasti Endri Keko, teksti i shkruar nga poeti Llazari Siliqi, drejtor fotografie (operator) Jani Nano dhe piktor Petraq Lubonja. Fotoja mund të jetë një shkrepje-çasti (snapshot), pra në padijeninë e personave, thënë ndryshe, vjedhurazi, por po ashtu, e realizuar edhe sipas porosisë së fotografit, për të përsëritur, veprimin e kryer nga ata, pak çaste më herët (siç ka ndodhur me disa foto-ikona në fotografinë botërore dhe shqiptare si "Iwo Jima" e Joe Rosenthal dhe "Dorëzimi armëve" e Kel Marubit). Gjithashtu, fotoja ndoshta është fryt i stampimit në letrën fotografike të një kuadri (sekuenca) nga dokumentari (por e pa përfshirë montazhin përfundimtar të tij) në celuloid dhe e përzgjedhur me mjaft shije, me gjasë nga drejtori i fotografisë apo nga piktori i filmit. Këto e të tjera, të gjitha të marra me mend, kanë çuar në realizimin e kësaj fotoje në dukje rutinë. Fatkeqësisht ende nuk dihet (të paktën prej meje) edhe emri i autorit të fotos. Siç u cek më lartë, ka të ngjarë të jetë ndonjë pjesëtar i grupit të xhirimit të filmit, që ka pasur me vete një aparat fotografik, por sidomos shtysën dhe sqimën e brendshme të artistit për të përjetësuar një pamje mjaft të veçantë. Megjithatë, kushdoqoftë e kudoqoftë, në tokë a në qiell, ai duhet përgëzuar ngrohtësisht për këtë imazh të rrallë. Gjithsesi, koha, vendi, shkaku i realizimit të fotos, emrat e personave, autori i saj, lloji i aparatit dhe filmit, janë vektorë, disa të saktë e të vërtetë, të tjerë të

të hamendësuar, kanë rëndësinë e tyre, por rezultatja, vet fotojambetet më e rëndësishme dhe i zbeh disi ato. Plani i parë i fotos janë katër duart e dy barinjve, ato përbëjnë dhe qendrën optike të fotos, aty zhvillohet edhe subjekti i saj, ndezja e cigares, pra, në një farë mënyre dhe qendrën kuptimore të saj. Veçse punctum (sipas Barthes) i fotos mendojmë se është koka e Abaz Haxhiajt. Aty ngelet për disa çaste vështrimi i shikuesit, shkëputet prej tij e kthehet sërish. Mad-

je, fotoja do të ishte pa fushë manjetike nëse nuk do të përfshihej në të portreti i Abazit, për këtë mjafton ta mbulojmë me një letër të bardhë atë. Marrja (fotografimi) nga poshtë vijës së horizontit i jep fotos edhe farë karakteri monumental, sepse kështu ajo shihet ashtu siç shikohen përgjithësisht shtatorete nga poshtë-lartë. Kështu fotoja merr edhe ngjyra gjithë-kohore, pra fotoja mund të vendoset në çdo kohë, pavarësisht veshjeve që përcaktojnë ven-

din. Gjithsesi, për kumtet shoqërore dhe psikologjik, frymën që përcjell fotoja, si dhe portretet e dy barinjve (sidomos e Abaz Haxhiajt), ajo vragon mbresa të pashlyeshme tek shikuesit. Po ashtu, për karakterin, të themi monumental, fotoja ndoshta mund të frymëzojë dhe t'i shërbejë edhe ndonjë skulptori për krijimin e një skulpture parku me temë miqësinë e thjeshtë dhe të pastër. Fatkeqësisht, foton e kemi vetëm në versionin digjital, pra jo në letër,

sepse ashtu do të ndihmonte më shumë për të dalluar ndonjë detaj, që mund të hapte ndonjë shteg të ri për leximin e saj. Në fund, duhet të përmend se këtë foto ma ka dërguar për ta publikuar dhe shkruar diçka mbi të, miku im, poeti Petrit Ruka. Kjo ka ndodhur më se dy vite më herët. Disa muaj më pas ai u nda nga jeta. Le të jenë këto rreshta edhe si një homazh për poetin e ndërë, i cili mbetet shkaku i publikimit të fotos dhe të disa rreshtave kushtuar asaj. (fjala)

Përjetime

FATOS ARAPI, DASHURITË ME EMRIN TANJA...

E shikoja Fatosin që nxirrte nga çanta e vogël ku mbante dhe dietën tonë mjerane prej pesë dollarësh në ditë, një copë letër dhe telefononte nga telefonat e rrugës

Bardhyl LONDO

Në vitin 1987 më ra rasti të shkoj në Bullgari me poetin tonë të madh e të paharruar Fatos Arapi në një takim shkrimtarësh ballkanikë. Fatosi kishte studiuar atje dhe Tanjën që e kishte dashurë që nuk kishte shprehur asnjëherë edhe pas prishjes së marrëdhënieve. Emrin e saj e përmendte shpesh në poezi: Dashuritë me emrin Tanja, tragjeditë me emrin Tanja. Bullgarët na pritën aq mirë sa na quajtën dallëndyshet e para, se pas shumë vitesh shkonin për herë të parë shkrimtarë shqiptarë atje. Pas drekave e darkave që vazhdonin me orë e shikoja Fatosin që nxirrte nga çanta e vogël ku mbante dhe dietën

tonë mjerane prej pesë dollarësh në ditë, një copë letër dhe telefononte nga telefonat e rrugës. Pas dy ditësh e pyes: A e ke takuar Tanjën? Jo, më thotë, ku ta takoj? E marr në telefon, s'më del njeri në shtëpi. Edhe pas dyzet e ca vjetësh, ai ruante ende numrin e saj në telefon. A e mban mend shtëpinë e pyeta. Si jo, tha. Hajde shkojmë bashkë, i thashë. Jo, se të marr në qafë dhe ty. O Fatos, i thashë, pse beson njeri se ke ardhur në Sofje dhe nuk e ke takuar Tanjën kur ti emrin e saj e ke në shumë poezi? Pastaj nuk është fare njerëzore të mos e takosh. Ungjitet në katine dytë të një shtëpie dykatëshe. Ziles i rashë unë. Doli një plakë me të zeza si plakat tona të jug-

ut. Fytyra ime nuk i thoshte gjë. Kur pa Fatosin prapa meje, "oh Fatosi", klithi dhe iu hodh në qafë. Hajdeni brenda, tha. Kundër dëshirës sime, Fatosi nuk pranoi. Mirë tha, Tanja është në punë, vjen pas një ore. Do t'i them të vijë tek hoteli ku rrini. Pas një ore Tanja erdhi. Ebukur, shtatgjatë, bionde, sykaltër. Pas ndarjes me Fatosin, ajo kishte pasur një tragjedi më të madhe. Ishte martuar, divorcuar, ish-burri punonte në ambasadën bullgare në Budapest dhe vinte çdo verë merrte djalin katërbëdhjetë vjeçar e mbante disa ditë në Budapest. Në një aksident automobilistik djali vdes. Tragjedia e Tanjës ishte e shumëfishtë. Nuk rri më dot në këtë vend, më tha, do iki në Kanada.

Dhe vërtetë më ra rasti të shkoja pas ca kohe në Sofje, e kërkova dhe më thanë që kishte ikur në Kanada. Ditën e fundit që ikëm nga Sofja dolëm të blinim ndonjë gjë për të afërmit. Unë doja të blija një palë çizme për gruan time të ndërë, që atëherë nuk gjendeshin në Tiranë. Tanja këmbënguli të m'i dhuronte. Natyrisht që nuk pranova. Rrugës duke u kthyer në hotel i thashë Tanjas: Sot u munduam si Krishti. Pse, më tha. Se u munduam për të tjerët. Në mes të bulevardit të Sofjes, ajo më hodhi duart në qafë dhe më puthi. Ktheva sytë nga Fatosi dhe e pashë që po qeshte me të madhe. Dhe me vjen mirë takujtojkështu, sepse gjithë jetën e kam parë veç me sytë që i lotonin.

Në fokus

LETËRSIA BASHKËKOHORE DHE TRANS-HUMANIZMI

Francis Fukujama e përfshiu trans-humanizmin në revistën Foreign Policy si një nga idetë më të rrezikshme në botë. Nga ana tjetër, ithtarët e trans-humanizmit pohojnë se lëvizja shton ndjeshëm mundësinë për mbijetesë dhe përparim të vazhdueshëm të racës njerëzore. Mark Walker, për shembull, me vetë titullin e veprës së tij parashikon pozicionin sipas të cilit është trans-humanizmi ai që e shpëton racën njerëzore nga shfarosja.

Nga Metin IZETI

Gjatë shekullit të 21-të, trans-humanizmi u profilizua si një nga lëvizjet më të rëndësishme ose, të paktën, më të diskutueshmet bashkëkohore, gjë që duket qartë nga vlerësimet konfliktuale të lartpërmendura. Përqendrimi trans-humanist në zhvillimin teknologjik dhe, veçanërisht lidhja intime mid-

is njeriut dhe teknologjisë, shpjegon edhe më qartë qëndrimet e tilla. Letërsia luan një rol kompleks në këto diskutime. Nga njëra anë, si ithtarët dhe kundërshtarët e trans-humanizmit i referohen letërsisë në përpunimin e argumenteve të tyre, por nga ana tjetër, ky përdorim i letërsisë është shpesh teleologjik dhe sipërfaqësor. Prandaj, është në të njëjtën kohë e mundur të thuhet

se letërsia luan një rol të spikatur në diskutimet për trans-humanizmin, por gjithashtu se reflektimi mbi letërsinë përfaqëson një pikë qorre brenda këtyre diskutimeve.

Formulë për ikje nga plakja

Nga këndvështrimi i letërsisë, vihet në pikëpyetje kapaciteti i saj për të kontribuar në zgjidhjen e proble-

meve konkrete të botës moderne. Kjo kështu, pasi këto probleme merren parasysh se janë të natyrës teknologjike dhe se letërsia nuk ka punë aty. Ideja trans-humaniste e shfrytëzon letërsinë si një zbulim që pasuron përpjekjet për të promovuar trans-humanizmin. Fokusi gjithsesi se është i përqendruar në letërsinë anglofone dhe kjo nuk është vetëm pasojë e një dëshire arbitrare për



të ngushtuar arkivin studiuës, por përshkak se ata janë edhe më masive, por edhe më të pranishme me temat trans-humaniste. Edhe pse është shumë e vështirë të përgjithësohet, dhe përjashtime sigurisht që ekzistojnë, trans-humanizmi përgjithësisht klasifikohet si një filozofi analitike që i përket botës anglofone. Lidhja midis trans-humanizmit dhe këtyre kombeve, veçanërisht amerikanëve, nuk është vetëm pasojë e një situatë të veçantë akademike, por ajo mund të lidhet edhe me një kulturë të projektuar. Intuitivisht, duket e arsyeshme të supozohet se kultura amerikane, me fokusin e saj në të ardhmen, është veçanërisht e përshtatshme për zhvillimin e mendimit trans-humanist, i cili duket se është në gjendje të tërheqë avokatë shumë më lehtë në një klimë të tillë sesa në një kulturë tjetër që ka traditë. Supozimi kryesor i një përgjithësimi bindës të këtij lloji përfshin gjithashtu konsideratat sociologjike të kulturës amerikane, gjë që nuk është objekt i këtij punimi. Prandaj, pika fillestare këtu është vetëm një supozim intuitiv i përcaktuar relativisht fleksibël. Për shembull, duhet mbajtur parasysh se Tiffany Romain beson se kriteknologjia (metodë specifike për shmangien e plakjes) është e lidhur me shoqërinë amerikane më shumë se me çdo shoqëri tjetër. Si synim për disa kërkime të ardhshme, është e mundur të parashtrahet pyetja nëse miti i Adamit amerikan shpjegon të paktën një pjesë të hapjes së kulturës amerikane ndaj trans-humanizmit. Edhe nëse e gjithë hipoteza për pajtueshmërinë e ndjeshmërisë kulturore amerikane nga njëra anë dhe ndjeshmërisë trans-humaniste nga ana tjetër ka performansa në rritje, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ky lloj kërkimi është i realizueshëm. Prandaj, përqendrimi në

letërsinë anglofone nuk është një përpjekje për të krijuar një përgjithësim rreth atij korpusi letrar, por një verifikim i vlerës së përdorimit të modelit analitik që do të propozohet dhe supozimeve teorike që mundësojnë atë model. Literatura anglofone përmban tekste mbi të cilat padyshim është e mundur të kryhet një analizë e tillë, edhe nëse këto tekste nuk janë grupi më i përshtatshëm që mund të trajtohet në këtë mënyrë. Fakti që letërsia studiohet në një kontekst akademik pa ndonjë argument shtesë, dëshmon për rëndësinë e saj në kulturën njerëzore dhe, në një nivel edhe më themelor, për faktin se letërsia lexohet gjithmonë në një kontekst shoqëror. Prandaj, mund të pyesim se si letërsia, si dhe studimi akademik i letërsisë, pozicionohen brenda momentit bashkëkohor dhe si përshtaten në pritje të së ardhmes?

Imagjinata që i mungon teknologjisë

Institucionalizimi aktual akademik i praktikave të ndryshme në të cilat letërsia luan një rol të rëndësishëm nuk garanton ruajtjen e përzetshme të një statusi të tillë. Duhet pranuar fakti se teknologjia luan një rol të domosdoshëm në botën moderne dhe se ky rol ndoshta do të bëhet edhe më i theksuar në të ardhmen se sot. Nga kjo vjen supozimi i mëtejshëm se studimi i teknologjisë në letërsi është një terren pjellor për analizë që mund të japë njohuri të vlefshme për gjendjen aktuale të njerëzimit. Lewis përkufizon Adamit amerikan si një imazh i një personazhi rrënjësisht të ri, heroit të një aventure të re, një individ i emancipuar nga e kaluara i paprekur ose i pandotur nga trashëgimia e përbashkët e familjes dhe racës, pa prejardhje; individ

që qëndron i vetëm, i vetë-mjaftueshëm, i gatshëm të përballet me çdo gjë që e pret duke përdorur aftësitë e tij të lindura dhe unike dhe të drejtojnë veten në drejtimin e duhur, sugjeron zakonet që duhen krijuar në skenën e re amerikane. [...] Para tij hapet bota dhe historia. Dhe ai është një lloj krijuesi, një poet i përsosur që krijon vetë gjuhën duke u dhënë emra elementëve të skenës që e rrethon. Intuitivisht, është shumë e qartë se aspiratat trans-humaniste përfshihen lehtësisht në mitin e një modeli të tillë. Një analizë më e plotë do të ishte e përqendruar në kontekstin nëse dhe në çfarë mënyre letërsia si e tillë dhe studimi akademik i letërsisë mund të ndihmojnë në kuptimin e fenomenit të teknologjisë dhe kështu, së bashku me disiplinat e tjera shkencore, të vazhdojnë të luajnë rolin e një praktike të rëndësishme në arritjen e një praktike më të thellë, më të pastër dhe më të madhe të njohurive gjithëpërfshirëse për botën. Është gjithashtu e mundur të shtrohet pyetja pse korpusi letrar i lartpërmendur trajtohet nga këndvështrimi i trans-humanizmit, dhe jo një teknologjie spekulative më të gjerë dhe më të kuptuar, sepse në raste studimore konkrete, në pjesën më të madhe, në ndërveprimin e disa teknologjive studiohet bota imagjinare dhe jo një botë faktike trans-humaniste. Trans-humanizmi e vendos teknologjinë në një kornizë të përcaktuar filozofike dhe kështu shton një nivel tjetër interpretues në të menduarit për zbatimin e mundshëm të ardhshëm të kësaj teknologjie në botën empirike në kundërshtim me parimet e përvojës së përgjithshme. Trans-humanizmi përmban një imagjinatë filozofike që vetë teknologjia nuk e ka. Zhvillimi, për shembull, i nanoteknologjisë i ndarë nga trans-humanizmi

nuk nënkupton domosdoshmërisht përdorimin e nanoteknologjisë për të ndryshuar rrënjësisht gjendjen njerëzore. Kjo imagjinatë filozofike e trans-humanizmit, e cila nis nga aspirata për të përdorur teknologjinë për të bërë të pavdekshëm njeriun ka implikime dukshëm më të thella për të ardhmen e njerëzimit sesa vetë teknologjia. Kështu, trans-humanizmi i shton teknologjisë një kuptim që nuk e ka në vetvete dhe fokusi i kësaj pune është pikërisht në konstelacionin filozofik trans-humanist të përdorimit të teknologjisë dhe pranimin të disa vlerave themelore që ka potencialin të ndikojë ndjeshëm në zhvillimin e ardhshëm të racës njerëzore. Tashmë është e mundur të inkorporohet studimi i teknologjisë në letërsi në një qëllim të tillë, por trans-humanizmi imponon më drejtpërdrejt zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë në gjendjen njerëzore dhe të ardhmen e kuptuar, sipas tyre, të njerëzimit. Trans-humanizmi është natyrshëm i orientuar drejt së ardhmes, është imagjinare futuriste dhe shumica e mundësive teknike për të cilat mendojnë trans-humanistët nuk janë të disponueshme në të tashmen. Dhe një analizë e plotë e dëshirueshmërisë së një teknologjie të re në vetvete përfshin një lloj të menduarit për të ardhmen dhe trans-humanizmi drejton të menduarit për të ardhmen në kuadër të bedemeve mendore të imagjinuara. Sfondi epistemologjik i transhumanizmit është shumë i papërrputshëm me kuadrin teorik nga i cili është zhvilluar letërsia trans-humaniste përfundimtare. Trans-humanizmi si ide imagjinare dhe jashtë kornizave të përvojës etike njerëzore po i takon letërsisë, por për të përrallëzuar gjendjen dhe jo për të prezantuar të vërtetën. E vër-

teta e saj duhet të zbulohet në mendimin filozofik dhe empirik të tij, që për fat të keq është shumë i cekët. Filozofia analitike dhe ajo kontinentale, me pikat e tyre fillestare dhe metodat teorike relativisht të ndara, padyshim që kanë role të rëndësishme për të kontribuar në të menduarit për një gamë shumë të gjerë problemesh të ndryshme dhe vendosja e çdo lloj marrëdhënie hierarkike midis tyre është jo vetëm e panevojshme, por edhe e padëshirueshme. Për shkak të natyrës së temave që janë në qendër të një leximi trans-humanist të letërsisë, filozofia e shkencës është jashtëzakonisht e rëndësishme si pjesë e kornizës në të cilën zhvillohet trans-humanizmi. Për shembull romani *Brave New World* nga Aldous Huxley, botuar në 1932 është një ilustrim i mirë. Ndryshe nga veprat e tjera letrare, të cilat janë të gjitha dukshëm më të reja se romani i Huxley-t dhe më pak të vërejtura në diskutimet teorike, *Wonderful New World* është një vend letrar i vazhdueshëm, jo vetëm kur bëhet fjalë për letërsinë që lidhet me trans-humanizmin, por edhe për letërsinë shumë më të gjerë të shekullit 20, apo edhe letërsisë në përgjithësi. Është thelbësore të kuptohet se romani i Huxley-t mund të shihet si një kritikë e përgjithshme e trans-humanizmit, gjithashtu edhe se ai mund të jetë udhëzues në të menduarit për trans-humanizmin dhe se ai i referohet në mënyrë kritike një pjesë të caktuar të filozofisë trans-humaniste. Tregimi i shkurtër *Flowers for Algernon* nga Daniel Keyes, i cili u botua në 1959 dhe u zgjerua në një roman në 1966 gjithashtu është një ilustrim tjetër. Si tregimi ashtu edhe romani janë botuar para shfaqjes së lëvizjes trans-humaniste, kështu që ata nuk merren drejtpërdrejt me, por motivi i rritjes mjekësore të aftësive psikike është jashtëzakonisht i rëndësishëm për trans-humanizmin. Mënyra se si shoqëria e trajton personazhin kryesor të romanit është veçanërisht interesante dhe e rëndësishme nga një këndvështrim trans-humanist. Në këtë mënyrë romani parashikon disa tema të rëndësishme që lidhen me trans-humanizmin, dhe qëndrimi shoqëror ndaj individit të përmirësuar nuk është e vetmja temë e tillë, sepse romani tregon edhe mekanizma të ndryshëm brenda komunitetit shkencor, qëllimi i vetëm i të cilëve nuk është avancimi i nivelit të përgjithshëm njerëzor, por edhe më tepër. Romani *The Transhumanist Wager* i vitit 2013 është gjithashtu një roman që e punon temën e trans-humanizmit. Vetë titulli tregon rolin qendror të trans-humanizmit në roman dhe autori Zoltan Istvan është një figurë e shquar politike amerikane e njohur për pikëpamjet e tij trans-humaniste. Romani është shkruar jashtëzakonisht në mënyrë jokonsistente, gjë që vërtetohet pa mëdyshje gjatë leximit, dhe për shumicën e analizave letrare do të ishte i padobishëm për shkak të kësaj. Është veçanërisht interesante që ky është një roman i shkruar nga një këndvështrim trans-humanist, por një lexim serioz i të cilit e portretizon trans-humanizmin në një dritë vërtet negative. Romani i Richard Powers, *Generosity: An Enhancement*, botuar në vitin 2009 prek drejtpërdrejt trans-humanizmin në

personazhin e shkencëtarit Thomas Kurton, por në një mënyrë dukshëm më të sofistikuar dhe më të thellë se *Transshumanist Wager*. Inxhinieria gjenetike është një temë e rëndësishme e romanit të Powers-it dhe kjo teknikë nuk është interesante vetëm në spekulimet trans-humaniste për të ardhmen, por edhe në një kontekst social aktual dukshëm më të gjerë. Krahas kësaj, romani problematizon rolin e tregimit dhe të letërsisë në botë dhe me këtë e pasqyron vendosjen e kufijve imagjinare në kundërshtim me urtinë perenniale. Ai gjithashtu prezanton në një funksion më relevant çështjen ekonomike të zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, e cila është e pashmangshme në konsideratat konkrete trans-humaniste. Kjo gradualisht kalon në dy romanet e ardhshme në të cilat tema ekonomike është dukshëm më domethënëse. I pari nga këto romane është *Zero K* nga Don DeLillo. Romani i DeLillos, i botuar në vitin 2016, trajton kronikën dhe paralelisht me këtë zhvillim teknologjik, romani i DeLillos nxjerr në pah edhe përshkrimin e plakjes. Sipas romanit *Zero K* është një dëshmi e frikës së njeriut nga vdekja. Krikonika është vendosur në një hapësirë fikcionale shumë konkrete që nuk është vend utopik për të cilin fantazojnë trans-humanistët, dhe vëmendje e veçantë i është tërhequr ekonomisë si një faktor i spikatur në realizimin e një opsioni më serioz të kronikës, si dhe një burim i mundshëm demarkacioni midis atyre kush mund dhe ata që nuk mund të marrin pjesë në përfitimet që rrjedhin nga zhvillimi i teknologjisë së re. Ekziston një tension i rëndësishëm midis zhvillimeve të tilla të mundshme në botën reale dhe idealit trans-humanist të disponueshmërisë së gjerë të teknikave të përmirësimit njerëzor.

Portretizimi letrar i trans-humanizmit në një dritë negative

Romani *Down and Out in the Magic Kingdom*, një roman i shkurtër nga Cory Doctorow botuar në 2003 është një roman tjetër në të cilin trans-humanizmi përmendet drejtpërdrejt dhe që përshkruan një botë futuriste shumë të përparuar që mund të jetë afër aspiratave trans-humaniste në shumë mënyra, por kjo nuk është e mundshme për shkak të logjikës kapitaliste që ka nënshtruar përparimin teknologjik. Në këtë kontekst, spikat veçanërisht monedha imagjinare whuffie, e cila ndryshon paranë dhe mundëson një depërtim edhe më intim të logjikës së kapitalit në personalitetin e njeriut. Domethënë, në roman theksohet teknika e ndërfaqes që lidh mendjen me kompjuterin dhe ngarkimi i kopjeve rezervë të mendjes në rast vdekjeje, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme nga këndvështrimi trans-humanist. Gjithashtu edhe filozofi trans-humanist Nick Bostrom ka dy romane të shkurtra *Fabula e dragoit-tiranit* e vitit 2005 dhe *Fabula e papërfunduar e harabelave* botuar në vitin 2014 dhe këto përralla dhe fabula janë veçanërisht interesante sepse janë botuar si pjesë e punimeve shkencore, ndaj vendosen në kontekstin më të gjerë të filozofisë së Bostromit. *Fabula e dragoit* trajton idealin trans-humanist për t'i dhënë fund plakjes, dhe fabula e harabelave merret me problemin e inteligjencës artificiale të avancuar. Megjithëse Bostrom padyshim është dashamirës ndaj pozicionit trans-humanist, siç është evidente në fabulën e dragoit, fabula e harabelave tregon gjithashtu rëndësinë e kujdesit dhe përgjegjësisë në zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë së përparuar. Bazuar në këto vepra letrare, duket se letërsia përgjithësisht e portretizon trans-humanizmin në një dritë negative. Nga ky korpus letrar mund të lexohet padyshim njëfarë mospëlqimi ndaj trans-humanizmit. Më e rëndësishmja është përqendrimi në faktin i cili tregon dështimin për të pritur një zgjidhje teknologjike për të gjitha problemet me të cilat përballlet njerëzimi. Globalizimi dhe diktatet e një ekonomie materialiste kanë krijuar një sistem që promovon lakminë, arrogancën dhe luftën për jetë lëndore të pafundme. Për shumicën e njerëzve, kënaqësia materiale është qëllimi i vetëm dhe mënyra e jetesës që ata vlerësojnë. Konsumatorët e sotëm janë thjesht gllabërues që pranojnë me kënaqësi çdo gjë që bindet nga makineria e sofistikuar propagandistike e mediave dhe fushatave publike apo private. Në vend të epokës së dijes dhe inteligjencës, që parashikonin mendimtarët, ne kemi hyrë në epokën e degradimit dhe budallallëkut. Tregon vetëm se diçka nuk është në rregull me konceptimin tonë për përparimin që kemi mësuar dhe admiruar. Njerëzit e zakonshëm kanë ende një mit për shkencën dhe besojnë se shkencë është objektive dhe racionale. Shkencë ka tradhtuar shpresat e njerëzimit dhe është politizuar dhe komercializuar, shërbëtore e interesave dhe qëllimeve të korporatave të mëdha. Përparimi nuk ishte vërtet përparim. Ky ishte përparim në secularizimin. Humanizmi u zhvillua si një humanizëm laik dhe ateist. Zoti u shpall i vdekur dhe bashkë me të gjithë çka e shenjtë, fetare, unike dhe ezoterike u bë e padëshirueshme ose e panevojshme. Arsyeja u bë matësi dhe kriteri i vetëm. Shkencë dhe teknologjia janë të ndara nga spiritualiteti. Feja, mitologjia, misticizmi, metafizika, gjithçka që është trashëgimi shpirtërore e njeriut, u internua dhe

që mund të jetë afër aspiratave trans-humaniste në shumë mënyra, por kjo nuk është e mundshme për shkak të logjikës kapitaliste që ka nënshtruar përparimin teknologjik. Në këtë kontekst, spikat veçanërisht monedha imagjinare whuffie, e cila ndryshon paranë dhe mundëson një depërtim edhe më intim të logjikës së kapitalit në personalitetin e njeriut. Domethënë, në roman theksohet teknika e ndërfaqes që lidh mendjen me kompjuterin dhe ngarkimi i kopjeve rezervë të mendjes në rast vdekjeje, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme nga këndvështrimi trans-humanist. Gjithashtu edhe filozofi trans-humanist Nick Bostrom ka dy romane të shkurtra *Fabula e dragoit-tiranit* e vitit 2005 dhe *Fabula e papërfunduar e harabelave* botuar në vitin 2014 dhe këto përralla dhe fabula janë veçanërisht interesante sepse janë botuar si pjesë e punimeve shkencore, ndaj vendosen në kontekstin më të gjerë të filozofisë së Bostromit. *Fabula e dragoit* trajton idealin trans-humanist për t'i dhënë fund plakjes, dhe fabula e harabelave merret me problemin e inteligjencës artificiale të avancuar. Megjithëse Bostrom padyshim është dashamirës ndaj pozicionit trans-humanist, siç është evidente në fabulën e dragoit, fabula e harabelave tregon gjithashtu rëndësinë e kujdesit dhe përgjegjësisë në zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë së përparuar. Bazuar në këto vepra letrare, duket se letërsia përgjithësisht e portretizon trans-humanizmin në një dritë negative. Nga ky korpus letrar mund të lexohet padyshim njëfarë mospëlqimi ndaj trans-humanizmit. Më e rëndësishmja është përqendrimi në faktin i cili tregon dështimin për të pritur një zgjidhje teknologjike për të gjitha problemet me të cilat përballlet njerëzimi. Globalizimi dhe diktatet e një ekonomie materialiste kanë krijuar një sistem që promovon lakminë, arrogancën dhe luftën për jetë lëndore të pafundme. Për shumicën e njerëzve, kënaqësia materiale është qëllimi i vetëm dhe mënyra e jetesës që ata vlerësojnë. Konsumatorët e sotëm janë thjesht gllabërues që pranojnë me kënaqësi çdo gjë që bindet nga makineria e sofistikuar propagandistike e mediave dhe fushatave publike apo private. Në vend të epokës së dijes dhe inteligjencës, që parashikonin mendimtarët, ne kemi hyrë në epokën e degradimit dhe budallallëkut. Tregon vetëm se diçka nuk është në rregull me konceptimin tonë për përparimin që kemi mësuar dhe admiruar. Njerëzit e zakonshëm kanë ende një mit për shkencën dhe besojnë se shkencë është objektive dhe racionale. Shkencë ka tradhtuar shpresat e njerëzimit dhe është politizuar dhe komercializuar, shërbëtore e interesave dhe qëllimeve të korporatave të mëdha. Përparimi nuk ishte vërtet përparim. Ky ishte përparim në secularizimin. Humanizmi u zhvillua si një humanizëm laik dhe ateist. Zoti u shpall i vdekur dhe bashkë me të gjithë çka e shenjtë, fetare, unike dhe ezoterike u bë e padëshirueshme ose e panevojshme. Arsyeja u bë matësi dhe kriteri i vetëm. Shkencë dhe teknologjia janë të ndara nga spiritualiteti. Feja, mitologjia, misticizmi, metafizika, gjithçka që është trashëgimi shpirtërore e njeriut, u internua dhe



u ekspozua në përbuzje. Përparimi i vërtetë njerëzor mund të arrihet vetëm nëse i kthehemi sintezës së arsyes dhe dashurisë, mendjes dhe zemrës. Humanizmi duhet të bëhet një humanizëm integral dhe holistik, nëpërmjet unifikimit të Miteve dhe Logosit. Ne duhet të kremtojmë holizmin, një qasje integrale ndaj realitetit, që e sheh njeriun dhe botën si një tërësi unike dhe të lidhur.

Imponimi i një ideologjie pa alternativë

Trans-humanizmi në kuptimin modern është një ideologji, filozofi dhe lëvizje që mbron transformimin teknologjik të njeriut me qëllim të përsosjes dhe përmirësimit të qenies njerëzore, forcimit të aftësive të tij dhe kalimit në një formë të re të qenies së gjallë, e cila do të jetë një lloj "njeri i përmirësuar". Në fazën e parë, trans-humanistët duan të krijojnë të ashtuquajturat transman, dhe në fazën përfundimtare do të krijohet një formë krejtësisht e re e qenies - e ashtuquajtura postnjerëzore - e cila do të përfaqësojë një lloj hibridi të njeriut dhe makinës inteligjente, një përzierje organiko-teknologjike që do të ketë mundësi dhe aftësi shumë më tepër se ato që zotëron njeriu i sotëm dhe do të jetë në gjendje të jetojë pafundësisht. Trans-humanizmi bazohet në teknologji të reja që përbëjnë thelbin e Revolucionit të Katërt Industrial. E zakonshme për këto teknologji të reja (inteligjenca artificiale, nanoteknologjia, Interneti i Gjërave dhe rrjeti 5G-6G, realiteti virtual, realiteti i shtuar, neuroshkencat, bioteknologjitë, robotika, inxhinieria gjenetike, etj.) është se ato po përjetojnë një zgjerim të paparë dhe po rriten me shpejtësi në një shkallë eksponenciale, e cila e vështirëson monitorimin, analizën dhe kontrollin e tyre, ata janë në gjendje të ndryshojnë rrënjësisht biologjinë e njeriut, funksionimin dhe sjelljen e tij, si dhe të rrisin dhe përmirësojnë aftësitë psikologjike.

Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe integrohen në sinteza komplekse teknologjike dhe mund të bëhen të pavarurandikiminjerëzor. Të gjitha këto janë karakteristika që teknologjitë e mëparshme nuk i posedonin. Prandaj, trans-humanistët vendosin shpresa të mëdha në fuqinë e këtyre teknologjive dhe parashikojnë që në të ardhmen shumë të afërt (më së shumti dy dekada, dhe ndoshta më pak) një shpërthim i tillë i rritjes dhe zhvillimit të teknologjive do ta çojë shoqërinë deri në pikën e ashtuquajtur superinteligjenca. Është kjo pika e singularitetit teknologjik. Pas kësaj pike, dhe nuk jemi aq larg prej saj, sipas pritshmërive të trans-humanistëve, niveli i inteligjencës së përgjithshme të të gjitha gjërave, objekteve dhe "organizmave" në të cilat është integruar inteligjenca artificiale, në kombinim me teknologjitë e tjera, do të tejkalojë dhe të zëvendësojë të gjitha aftësitë e njeriut, duke përfshirë edhe funksionet më të larta psikike, si të menduarit, arsytimi, vendimmarrja, ndjenja, intuita, njohja etj. As që mund ta imagjinojmë se si do të duket shoqëria njerëzore atëherë. Megjithatë, është e sigurt se fatkeqësitë, pandemitë, luftërat e pakuptimta për masën, e përshpejtojnë lëvizjen e njerëzimit drejt pikës së singularitetit dhe krijojnë kushtet për krijimin e një Rendi të Ri Botëror në formën e një shoqërie unike, globale, hiper-rrjetore dhe të kontrolluar që mund ta quajmë Rendi i Ri Global Trans-humanist. Kjo ide trans-humaniste shkatërroi ekonominë siç e njohim ne dhe la pasoja shkatërruese në të gjitha sferat dhe fushat Trans-humanizmi në kuptimin modern është një ideologji, filozofi dhe lëvizje që mbron transformimin teknologjik të njeriut me qëllim të përsosjes dhe përmirësimit të qenies njerëzore, forcimit të aftësive të tij dhe kalimit në një formë të re të qenies së gjallë, e cila do të jetë një lloj "njeri i përmirësuar". Në fazën e parë, trans-humanistët duan të krijojnë të ashtuquajturat transman, dhe në fazën përfundimtare do të krijohet një formë krejtësisht e re e qenies - e

ashtuquajtura postnjerëzore - e cila do të përfaqësojë një lloj hibridi të njeriut dhe makinës inteligjente, një përzierje organiko-teknologjike që do të ketë mundësi dhe aftësi shumë më tepër se ato që zotëron njeriu i sotëm dhe do të jetë në gjendje të jetojë pafundësisht. Trans-humanizmi bazohet në teknologji të reja që përbëjnë thelbin e Revolucionit të Katërt Industrial. E zakonshme për këto teknologji të reja (inteligjenca artificiale, nanoteknologjia, Interneti i Gjërave dhe rrjeti 5G-6G, realiteti virtual, realiteti i shtuar, neuroshkencat, bioteknologjitë, robotika, inxhinieria gjenetike, etj.) është se ato po përjetojnë një zgjerim të paparë dhe po rriten me shpejtësi në një shkallë eksponenciale, e cila e vështirëson monitorimin, analizën dhe kontrollin e tyre, ata janë në gjendje të ndryshojnë rrënjësisht biologjinë e njeriut, funksionimin dhe sjelljen e tij, si dhe të rrisin dhe përmirësojnë aftësitë psikologjike. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe integrohen në sinteza komplekse teknologjike dhe mund të bëhen të pavarura nga ndikimi njerëzor. Të gjitha këto janë karakteristika që teknologjitë e mëparshme nuk i posedonin. Prandaj, trans-humanistët vendosin shpresa të mëdha në fuqinë e këtyre teknologjive dhe parashikojnë që në të ardhmen shumë të afërt (më së shumti dy dekada, dhe ndoshta më pak) një shpërthim i tillë i rritjes dhe zhvillimit të teknologjive do ta çojë shoqërinë deri në pikën e ashtuquajtur superinteligjenca. Është kjo pika e singularitetit teknologjik. Pas kësaj pike, dhe nuk jemi aq larg prej saj, sipas pritshmërive të trans-humanistëve, niveli i inteligjencës së përgjithshme të të gjitha gjërave, objekteve dhe "organizmave" në të cilat është integruar inteligjenca artificiale, në kombinim me teknologjitë e tjera, do të tejkalojë dhe të zëvendësojë të gjitha aftësitë e njeriut, duke përfshirë edhe funksionet më të larta psikike, si të menduarit, arsytimi, vendimmarrja, ndjenja, intuita, njohja etj. As që mund ta imagjinojmë se si do të duket

shoqëria njerëzore atëherë. Megjithatë, është e sigurt se fatkeqësitë, pandemitë, luftërat e pakuptimta për masën, e përshpejtojnë lëvizjen e njerëzimit drejt pikës së singularitetit dhe krijojnë kushtet për krijimin e një Rendi të Ri Botëror në formën e një shoqërie unike, globale, hiper-rrjetore dhe të kontrolluar që mund ta quajmë Rendi i Ri Global Trans-humanist. Kjo ide trans-humaniste shkatërroi ekonominë siç e njohim ne dhe la pasoja shkatërruese në të gjitha sferat dhe fusha e shoqërisë, përfshirë kulturën dhe brenda saj letërsinë, artin dhe krijimtarinë në përgjithësi. Trans-humanizmi na imponohet si një ideologji superiore pa alternativë, në krahët e teknologjive joshëse, dixhitalizimit, të inkurajuar nga një fushatë e madhe mediatike dhe e promovuar në industrinë e filmit, videojërave dhe argëtimit. Trans-humanistët kryesorë, të cilët janë në krye të korporatave më të mëdha, organizatave globale dhe në qendra të tjera globale të pushtetit, flasin dhe shkruajnë vazhdimisht për avantazhet e inteligjencës artificiale, robotëve, nanoteknologjisë, bioteknologjisë dhe promovojnë krijimin e kiborgëve, përmes metodave të ndryshme dhe teknikave (implantimi i një çipi, injektimi i nano grimcave ose nano robotëve në trup, lidhja e trurit me një kompjuter, vaksinat e reja mRNA që përmbajnë material gjenetik, etj.). E keqja është se ne jemi të rrethuar nga një fushatë agresive trans-humanizmi dhe jemi të detyruar, nga mënyra të ndryshme delikate detyrimi, të pranojmë pikëpamjen dhe teknologjitë trans-humaniste pa analiza dhe reflektim kritik dhe pa një kuptim gjithëpërfshirës të rreziqeve dhe efekteve të këqija që mund të ketë mbi njerëzit. Kjo është arsyeja pse ne kemi një luftë të madhe përpara... Para nesh është një luftë e madhe për lirinë e njeriut, për njerëzimin dhe për shpirtin, për një njeri të harmonisë dhe paqes, një njeri që do të rivendosë hyjninë e shtypur, të mërguar dhe të harruar, një njeri në kontakt dhe unitet me Zotin.

Në shiritin e kohës

FËMIJËRIA JONË NË FILMAT SHQIPTARË

Nuk është gabim t'i shohin këta filma edhe fëmijët tanë, edhe fëmijët e fëmijëve tanë, për të na kuptuar sadopak, e për të na dashur e respektuar pak më tepër

Alma ZENELLARI

Unë i dua filmat shqiptarë. Vazhdoj t'i shoh me të njëjtën dashuri, me të njëjtën kureshtje si atëherë kur i pashë për herë të parë në fëmijëri. Disa mund të më quajnë jashtë mode, disa edhe mund të më thumbojnë me ndonjë batutë. E, megjithatë, unë nuk e humbas kurrë interesin ndaj tyre. I dua fil-

mat, sidomos ato për fëmijë. Emocionohem, prekem e shpesh herë edhe lotoj. Është një ndjesi e habitshme kjo. Mbase tek unë ka akoma doza të tepërta naiviteti. Dua mënyrën si janë realizuar, përmbajtjen e tyre dhe pse shumë herë skematike, e megjithatë mbeten për mua tepër të dashur, tepër edukativë. Vlerësoj lojën e papërsëritshme të aktorëve duke veçuar lojën e mreku-

lueshme të aktorëve të vegjël, pafajësinë dhe shkathtësinë e tyre. Më habit lehtësia e përshtatjes së artistëve të vegjël me të rriturit. Si arrijnë të kombinojnë kaq lirisht shikimin, fjalën, lëvizjet, gjestet e mimikës? Por, më shumë dua mënyrën se si shqiptohet fjala dhe si zbrit ajo tek unë, thjesht e paqte, e ngrohtë, e ëmbël, e drejtpërdrejtë dhe e singertë. Shikoj filmin "Beni ecën vet", rebe-

limin e tij mbi lodrat plastike pa jetë. Më magjeps "Mimoza llastica" me dëshirën e saj të papërmbajtur për të qenë në qendër të vëmendjes. "Në shtëpinë tonë", Miri i vogël që kërkon të duket i rritur në sy të motrës, duke bërë ndonjë spiunllëk te prindërit. Shoku ynë Tili me një tjetër këndvështrim. Ai të fut në mjediset e shkollës, të çliron kujtesën duke të risjellë



emrat e shokëve shoqeve, të cilët nuk kishin ndonjë ndryshim të madh nga ti. Ne ishim të gjithë njësoj gati me të njëjtën fëmijëri. Po "Shpella e piratëve", "Një gjeneral kapet rob"? A s'kemi luajtur mijëra herë ashtu e kur duhej të ktheheshim në shtëpi i kemi tërhequr këmbët zvarrë nga inati. Sepse ndiheshim akoma të pangopur me lojërat tona, ndiheshim të rrëmbyer e plot zell nga historitë që shpiknim dhe i harronim të nesërmen. Zërat tanë bashkoheshin e bëheshin aq të fortë sa ngrinin në këmbë pallatet. Po filmi "Qyteti më i bukur në botë", fëmijë që luajnë, qeshin, kërkajnë të jenë si të rriturit, t'u ngjajnë atyre. A nuk të duket sikur je edhe ti mes atyre vogëlushëve që thërrasin gëzueshëm, edukatore, edukatore ... A nuk janë njëri më i bukur se tjetri, njëri më tërheqës se tjetri. Më duket se edhe fjalët s'i gjej dot për të treguar impaktin e thellë, që kanë lënë këta filma. Duket sikur regjisori apo skenaristi janë bërë bashkë e kanë trokitur butë paqesisht në portat e fëmijërisë time. Kanë ndjekur me kujdes hapat e mi dhe janë entuziazmuar nga dëlirë-

sia, nga natyrshmëria dhe nga naiviteti fëmijëror. Duket sikur më kanë kapur për dore, kanë ecur bashkë me mua nëpër ato vende, në ato fusha, në ato rrugë ku fëmijëria ime ka qenë e gjallë, e zhurmshe me aq e bukur, e magjishme. E papërsëritshme! Më i spikatur është Beni ecën vet. A nuk e gjeni shpesh herë veten tuaj tek ky film i sjellë kaq natyrshëm në skenën shqiptare? Ai duket sikur është shkruar për mua, për ty, për të gjithë ne fëmijët, që mezi prisnim pushimet e verës për të shkuar në fshat te gjyshërit. Beni befasohet nga madhështia e pyllit që e ka ndeshur vetëm në përralla. Befasohet nga dhelpra dinake e shtrirë në oborrin e shtëpisë. Ai s'është fajtor pse e njeh dinakërinë e saj vetëm në përralla. Befasohet nga fjalët lëmenjgruri, kooperativë. Ai nuk e di ç'është jehona, ç'janë kaçkat. Pyet në mënyrën më naive, por të singertë "dhen apo dele janë këto"? A nuk jam habitur edhe unë kështu? Po ju a nuk keni bërë pyetje të tilla që sot duken qesharake? Po e tillë ishte bota jonë fëmijërore. Edhe unë jam çuditur nga të panjohurat e fshatit, sepse edhe unë vija



nga një qytet i vogël. Jeta në fshat kishte bukurinë dhe magjinë e vet. Edhe unë kam luajtur buzë një përroi të vogël, që kalonte pranë shtëpisë së gjyshes sime. Kam mbushur ujë të freskët nga pusi i fshatit. As unë nuk e dija çfarë ishte një pus. Shpesh më thoshin të mos shkoja të mbushja ujë atje, sepse isha e vogël. Kjo më rriste kureshtjen më tepër dhe kur shihja që gratë e fshatit ishin larguar me kova e shtamba mbi krye, shkoja fshehtas dhe shihja me minuta të tëra ujin që pluskonte poshtë në thellësi të pusit. Pastaj shikoja çikrikun dhe litarin e mbështjellë pas tij dhe kovën që kumbonte kur lëshohej poshtë. Edhe unë kam vrapuar nëpër lëndina duke u mahnitur pas çdo insekti, pas çdo fluturë e karkaleci. Kam ndjerë erën e barit të njomë. Kam shkuar fshehtas në kodrat e mbjel-la me duhan, madje edhe në koshat ku futej duhani më ka zënë gjumi. Sa kujtime të tjera të bukura më kalonin nëpër mend kur e shoh këtë film. Më duket sikur dje, vrapoja bashkë me fëmijët më të rritur të fshatit, në fushat me pambuk. Sa qindra herë kam vrapuar nëpër plisa

duke rendur nga frika e qenve çoban. Jemi fshehur mes dhenve duke u bërë lojëra atyre që na thërrisnin. Shpesh kujtoj si na ulte në shesh mbi një rrugicë, te zja ime, dhe na thoshte "kush shkon pesë vargje me duhando t'i blej te zja sandale". Po për mua kjo ishte një sfidë e vërtetë. O zot sa herë janë shpuar gishtat e mi të vegjël, duke shkuar fletët e duhanit një nga një në gjilpërë. Sa herë i kam fshirë lotët që mos të m'i shihnin moshatarët me të cilët zura miqësi në fshat. Ata ishin gjithmonë të gatshëm për të më gjuajtur me fjalë, sepse përpara tyre unë isha vajza llasticë që vinte nga qyteti. Ndaj qaja në fshehtësi. Edhe unë si Beni kam luajtur me kumbulla e çefteli. Kam ngrënë kumbulla thartuqe, kam pikturuar fytyrën me lëngun e kuq të manave të shijshëm. Kam ndjekur patat në fushë. Kam ngacmuar folenë e bletëve. Kam këputur kallinj gruri duke i fërkuar në duar. U kam fryrë halave dhe kam ngrënë farat e zbuluara të grurit. Dhe pse e vogël kam provuar të mbjellë kubbikë me zarzavate të ndryshme. Kam provuar si të prashisja tokën

me kujdes pa e dëmtuar bimën që sapo kishte ngritur krye mbi tokë. Jam mërzitur, kam qarë me orë të tëra kur shihja flugat e ngritura mbi pëllëmbët e duarve, sepse parvarësisht gjithçkaje doja të dukeshat e rritur. Megjithatë, po aq kam qeshur e jam përkëdhelur nga të gjithë si një llasticë çamarroke. Jam larë në lumë, kam hipur nëpër pemë duke kënduar e kacavjerrë këmbëzbathur. Edhe unë pra kam bërë prapësi. Emocionohem edhe kur shoh filmin "Djali elastik", djalin që donte të bëhej akrobat. Ai vërtet më bën të derdh lotë sepse edhe unë dikur veproja me aq lehtësi si ai duke bërë sparkatën, unazën, urën. Bëja ushtrime të vështira akrobatike duke ëndërruar të isha në të ardhmen ose një balerinë ose një akrobate. Një ëndërr që për fat të keq mbeti në sirtar dhe nga ata sirtarët që u humbet edhe çelësi. Kur shikoj këta filma të bukur e kam të vështirë të mos ngërthehem para televizorit. Përmallohem, sepse shoh atje veten time me dy bishtaleca imcakë të zbukuruar me fjongo të bardha, me pantallona të kuqe e me një çelës nën bluzë, duke zbritur

shkallët e pallatit, duke kërkuar me emra shoqet, duke luajtur syllambylla apo me pafta. Këta filma janë e do të mbeten dëshmia e gjallë e realitetit tonë, dhe i bashkëmoshtarëve të mi, një realitet që nuk arriti të fokusohet siç duhej edhe në një fotografi të thjeshtë bardhë e zi, sepse atëherë edhe fotograf nuk kishte... Në këta filma edukativë është fokusuar fëmijëria ime e bukur dhe pse e varfër. E gjallë intensive, e pangopur me lojëra, e lidhur aq fort me natyrën, me njeri tjetrin e për më tepër me prindërit tanë që lodheshin për ne, për të na dhënë gjithçka sidomos për të na dhënë një fëmijëri të pastër, të sinqertë pa dritëhije. Të pasur me lojëra, të çliruar nga ankthet dhe frikët. Një fëmijëri të shëndetshme! Ndaj nuk është gabim t'i shohin këta filma edhe fëmijët tanë, edhe fëmijët e fëmijëve tanë, për të na kuptuar sadopak, e për të na dashur e respektuar pak më tepër. Për të na kuptuar, se në jetën tonë të vështirë, e vetmja pasuri, e vetmja gjë e bukur dhe e çmuar ishte fëmijëria.



Në shiritin e kohës

ÇFARË SHKRUANTE KOLI- LIQI PËR MIGJENIN?

Migjeni krijoi një prozë moderne të klasit të parë, duke e tejkaluar krahinizmin provincial. Proza e Migjenit plotëson poezinë e tij, e cila bëri një epokë të vërtetë

Moikom ZEÇO

Në vitet '30-të, Koliqi ishte më i madh i prozës moderne. Dy librat e tij qenë të nivelit evropian. Koliqi qe gjithash-

tu edhe poet, publicist, përkthyes. Ai botonte gazetën "Illyria", ku u tubuan emrat e intelektualëve më të shquar të kohës. Autoriteti i Koliqit spikaste kudo,

Ndërkohë fletoret italiane të Barit në Itali botonin të përkthyerat e meditimet e tij. Migjeni nisi të botojë proza dhe poezi që herët në gazetën "Illyria".

Në Shkodër, në këtë lak kohor, jetonin e krijonin Fishta e Mjeda, një binom kulturor i veçantë. Koliqi u paraqiti me pretendime të vërteta në estetikën e trajtimet moderne të artit, duke për-

përpunuar vektorin perëndimor artistik. I katërti po përgatitej, në dukje qetësisht, por me shpërthime gjerniale të brendshme. Pra, Migjeni do të shkruante krejt ndryshe dhe do të dëshmonte një koncept të ri universal. Koliqi ishte i pari, që e kuptoi Migjenin. Ndoshta marrëdhëniet e tyre vetjake mund të kenë pasur dhe kontradikta. Kjo nuk ka shumë rëndësi. Ata nuk ishin dhe nuk kishte pse të ishin artistë identikë. Shihni prozat koliqiane dhe prozat migjeniane. Kanë stilema, ekzotikë lokale, fjalë, antroponime të afërta. Objekt krijues kanë jetën shkodrane, gjithsesi janë në nivele krejt të ndryshme konceptuale. Midis motiveve tematike la lidhje, ashtu siç ka edhe antonime, që burojnë nga qëndrime sociale. Forca e Koliqit nuk është jehonë e verdizmit italian, ajo është tipike për elitën merkantiliste qytetare shkodrane, pa zbritur deri në botën infernale. Në aspektin kompozicional, në të ka një ndikim të Pirandelos. Mitet veriore, legjendarizimi estetik, i përcjellë jo pa një ironi tepër të hollë, provincializmi i përfaqësuar në mënyrë pak baroke (rokoko), shija tepër e gjetur dhe e kultivuar e gjuhës, njohja në parim e një tragjikeje shekullore (e filtruar edhe sipas një matrice subkoshiente frejdiane), autonomia zhanriste e tregimeve, gjë që nuk ishte parë kurrë më parë me kaq cilësi, e bëjnë prozën e Koliqit tepër interesante e një nga kulmet e prozës shqiptare në çdo kohë. Proza e Migjenit guxonte ndershmërisht të fliste nga pozicioni i njohur dostojevskian. Bota infernale ishte e vetmja alibi e një parajse imagjinative, ose i vetmi realitet i një parajse alibike që nuk ekziston. I zhveshur krejtësisht nga mitizimet, i mbrujtur me një revoltë kozmike niçiane, ateist, me një prapavijë kuptimore humaniste dhe iluministe, Migjeni krijoi një prozë moderne të klasit të parë, duke e tejkaluar krahinizmin provincial. Proza e Migjenit plotëson poezinë e tij, e cila bëri një epokë të vërtetë. Shën Antonit, oshënarit egjiptian të shekullit IV, krijuesit të novatorizmit kristian botëror, Djalli iu shfaq në formë zoologjike të një derri. Migjeni krijon metaforën ekzistenciale të dilemës hamletiane, midis Sokratit të vuajtur dhe Derrit të kënaqur. Skicat e tij filozofike kanë një botë të nëndheshme sociale, ndërsa nuk kanë pothuaj qiell. Ose më saktë, në horizonte Migjeni kërkon jo Krishtin, se sa një Njeri të Ri, sipas klithmës sfiduese e të paduruar të Niçes. Koliqi, duke i botuar krijimet e Migjenit, endjensenë letërsinë e kohës po ravijëzohen tiparet e një shkrimtari të fuqishëm. Madje, Koliqi nuk ngurron ta përhëndesë. Në "Illyria" më shtator 1934, pra katër vjet përpara se të vdiste Migjeni, në shkrimin "Në lulishten letrare", Koliqi shkruan disa rreshta, që do të jenë zanafilla e tërë shkrimeve eseistike që u shkruan më vonë për Migjenin deri më sot. Në shkrim thuhet: "Ma shumë gjethë se lule në kopështet e letrave të reja t'ona". Gjethet që ernat e vjeshtës këpusin errëxojnë dhe ngrehin rrëshqanë tue shtuem grumbullin e dushkut. Por edhe ndonji lule çelë e papritur, premtim pranverash të përtardhme. Nji prej këtyre asht vjersha "Të lindet njeriu"... e Migjenit. Edhe në disa shkrime ma të përparshme të këtij të riu kemi vre-

jtë një frymë të thellë poetike. I prirun kah dhimba për çfaqjet ma të mjerueme të jetës, shpirti i tij ndërsehet e shpërthen në një klithëm neverije e kundërshtim. Në vjershën e përmëndunsensibiliteti i tij njerëzuer derdhet në trajta ma të gjana e ma ngushëlluese dhe kërkon para-lajmuesin e njëj epoke ma të ndritun e ma bujare. Vargjet i dalin të ngadalëshme e me një rythëm bibliik: Të lindet nji Njeri!

Të mkambi nji Kohë të Re!

Të krijojë nji Epope!

Ndër lahuta t'ona të këndohet

Jeta e Re!

Ky këngëtar djalosh, me zemër të ndrydhun në nji përsheptim shoqonore, mund të na falë-kur t'a gjejë kthjelltin e trajtës e zotnimitin e landës - nji kangë shpërblyese dashunije njerëzore".

Kjo skicë e Koliqit, qe, si të thuash, profetike. Migjeni u formësua në një mënyrë aq të papritur e të çuditshme në letërsinë shqipe, sa që origjinaliteti i artit të tij ekzistencial është i pazëvendësueshëm në çdo kohë. Kështu, Migjeni u paralajmërua jo rastësisht nga Koliqi. Brenda materies së artit të fjalës shqipe, të dy talentet lidheshin më shumë se sa ndaheshin me njëri-tjetrin. Së fundi, diçka ngashënime në rubrikën "Posta" të gazetës "Illyria" për Migjenin. Në numrin e 12 tetorit 1935 lexojmë: "Migjeni-Shkodër: - Qortimin e dëshiroi vetë Drejtori i fletores s'onë. Mendimin e mirë t'onin mbi shkrimet e Juaja e kemi çfaqë botnisht. Mos u veni vesh fjalëve, gjykoni veprat. Falenderojmë për shkrime të dërgueme; presim të tjera".

Kemi të bëjmë me një pakënaqësi të Migjenit ndaj gazetës. Në numrin e 28 shtatorit është botuar tek "Illyria" proza: "A do qymyr, Zotni?". Çfarë korrigjimi (qortimi) është bërë në këtë shkrim që e ka prekur Migjenin? Shënimi e shpjegon qartë, se këtë e ka ndërmarrë vetë Koliqi. Ne nuk e dimë tekstin e letrës protestuese të Migjenit. Po mund të rindërtojmë dy motive: motivin e reagimit ndaj korrigjimit, që ka të bëjë me lirinë e publikimit, të shtypit të lirë dhe motivin e një mungese të respektit ndaj tij. Në përgjigje nënvizohet, se: "Mendimin e mirë tonin mbi shkrime Jueja e kemi çfaqë botnisht. Mos u veni vesh fjalëve, gjykoni veprat". Ç'fjalëve u ka vënë vesh Migjeni? Padyshim, kjo ka të bëjë substancialisht me letrën e Migjenit dërguar redaksisë. Më pas, mundësia e një moskuptimi më parimor merr fund, se në numrin e 16 nëntorit 1935 në "Posta" të gazetës lexojmë: "Migjeni-Shkodër: - Muerëm dhe falenderojmë. Veproni ashtu si ta mendoni ma mirë. Presim shkrime të tjera për faqen e Juej. Mos harroni rasën e 28 Nantorit për ndonjë copë prozë". Në numrin e "Illyrisë" të 28 Nëntorit, Migjenit i botohet poezia e famshme, soneti: "Kanga e rinisë". Në numrat e mëparshëm "Illyria" përsëri boton shkrime të Migjenit e marrëdhëniet jo vetëm janë korrekte, por edhe i bëhet dy herë reklama-lajmërimë, dalje së shpejti nga shtypi të kryeveprës poetike "Vargje të lira".



Të huajt për ne

GJUHA SHQIPE DHE TË KONCEPTUARIT KULTUROR

Antropologët e etnologët e huaj, vështrimin dhe interesimin e kishin të përqendruar jo vetëm te të mësuarit e frazave të thjeshta gjuhësore, por edhe te të kuptuarit dhe domethënies së vërtetë të fjalëve

Bukurie MUSTAFA

Fjalët në gjuhën shqipe përveç kuptimit themelor, bartin edhe ngarke-sa kuptimore, të cilat plotësohen kur vendosen brenda konteksti kulturor, që është e rëndësishme për konkretizimin dhe përdorimin e drejtë në të folme. Kjo gjë është e dukshme te të huajt, të cilët bëjnë përpjekje që përveç fjalëve dhe shprehjeve të reja që mësojnë, të kuptojnë dhe kontekstin kulturor. Pjesa më e madhe e tyre janë antropologë, etnologë e gjuhëtarë të huaj, që vijnë nga mjediset tjera kulturore dhe kërkojnë të kuptojnë gjuhën shqipe brenda kontekstit kulturor, gjë që u ndihmon atyre që lehtë ta mësojnë shqipen dhe ta flasin drejtë gjuhën. Shumë prej tyre, të vendosur nëpër familje shqiptare për një periudhë të gjatë kohore, kanë pasur mundësinë që të jenë të përfshirë në jetën e tyre reale dhe drejtpërdrejt t'i vërejnë vlerat e kulturës dhe mentalitetit vendas. Ata nuk kanë qenë vetëm vrojtues pasiv, por kanë qenë bashkëbisedues aktiv edhe atë me cilin do pjesëtar të kësaj shoqërie, duke respektuar normat e sjelljes dhe të komunikimit, si dhe duke u përshtatur në mjedisin e ri kulturor. Në rrethana të këtilla, antropologët

e etnologët e huaj, vështrimin dhe interesimin e kishin të përqendruar jo vetëm te të mësuarit e frazave të thjeshta gjuhësore, por edhe te të kuptuarit dhe domethënies së vërtetë të fjalëve. Që në fillim, ata ishin të vetëdijshëm që gjuha do të jetë e pakuptimtë dhe e vështirë për ta, po që se nuk e kuptojnë të konceptuarit mendor e kulturor të një kolektivi të tërë, siç janë shqiptarët. Të huajt qartas i perceptojnë konceptet kulturore, të cilat ne si folës të lindur të gjuhës amtare, sikur nuk i vërejmë. Për antropologun e etnologun norvegjeze Berit Bacer, e cila ka qëndruar në Isniq të Kosovës, diku nga vitet e 70-ta, të mësuarit e "kodeve kuptimore" brenda një kolektivi, si i quan ajo, është proces i ngadalshëm, dhe është një mjeshtri apo është "arti i interpretimit të të folurit verbal dhe joverbale i mësuar nga i huaji që t'i vëresh dhe t'i kuptosh ato". Në librin e saj "Behind stone walls", Baceri thotë: "Shpesh kjo bëhet përmes cenimit të vlerave të shoqërisë. Pas një kohe kuptimi i saktë i një "shumë mirë" të rezervuar u kuptua. Do të thotë po aq shpesh "shumë keq". Për të thyer kodin nuk është e lehtë, pasi ata që e njohin dhe atë nuk e shohin atë si kod por si gjuhë të drejtpërdrejtë, që e kanë trajnuar atë që nga fëmijëria".

Një antropologe tjetër amerikane Janet Reineck në librin me titull "Një amerikane në Kosovë 1981-1997", po ashtu në hollësi përshkruan kontaktin me shqiptarët e Kosovës dhe thotë: Pavarësisht këtyre sfidave, më pëlqente të mësoja shqip! Më dukej gjuhë tejet magjepsëse dhe melodike, me shprehje të bukura që zbukuronin gjuhën e përditshme, si p.sh. Ju bëftë mirë; Zoti ju dhashtë bereqet; Ju lumshin duart; Ju lumshin këmbët; Tungjatjeta! Reineck arrin ta kuptoj kontekstin e përdorimit dhe kuptimin e shprehjes "Shnosh", që e mendon si një shprehje e mrekullueshme që meriton të përmendet: "Kur dikujt i ndodh diçka e keqe, përgjigja është "Shnosh", që do të thotë: të ka ndodhur një gjë e keqe, por të paktën ke shëndetin! Kur ju vjedhin pasaportën, kur e humbni një telefonatë nga shtëpia, kur dikujt i ikën treni, kur diçka shkon keq...Shnosh! Nuk ka shprehje të tillë në anglisht dhe e kam vërejtur që është shprehje shumë e dobishme në shumë situata. Unë ende e përdorë atë gjatë gjithë kohës. Dikush më pat thënë se një gjuhë e njihni vërtetë atëherë kur mund të luteni, të bëni dashuri, të shani dhe të tregoni një shaka të mirë në atë gjuhë. E gjithë kjo erdhi gradualisht". Por duhet pasur parasysh

që në komunikimin e përditshëm të folësve shqiptarë, një shprehje e tillë mund të përdoret edhe me kuptim të ndryshuar, si formë shakaje. Edhe Edit Durhami, e cila ka humtuar Shqipërinë e Epërme, si e quan ajo, vëren shprehje që përdoren në të folur, e që kanë të bëjnë me veprime të caktuara dhe që i bëjnë përshtypje asaj. Ajo thotë: "Në Shqipëri, kur nisesh për udhë të përcjellin të gjithë ato urime shumë të ndërlikuar, si p.sh.: Të qoftë rruga e mbarë! Të ruajt zoti! Arrifsh shëndoshë e mirë! etj. etj". Dhe vazhdon: "Dikush më tha se asnjë gjuhë tjetër s'ka aq shumë fjalë të bukura sa shqipja për t'i thënë udhën e mbarë dikujt". Edhe pse shkon e shoqëruar me përkthyes, arrin mjaft mirë të kuptojë aspektin kulturor dhe mental të shqiptarëve. Kur flet për sistemin fisnor të jetës së shqiptarëve e ilustron me shembull konkret dhe thotë: "Kur pyet dikë se i e ka emrin, ai të përgjigjet se është akëçili nga Hoti apo Shala". Po ashtu, Durhami vlerëson kuptimin jo të drejtpërdrejtë në gjuhën shqipe dhe thotë: "Shqiptarët përdorin shumë rrotulla në të folur, si p.sh. "Shkoi me kalë, u kthye me gomar" (d.m.th. doli me duar zbratur për atë që vajti)". Robert Elsie, si studiues i folklorit dhe i kulturës shqiptare, po ashtu e merr



kontekstin kulturor për të shpjeguar disa çështje më intime. Elsi lidhur me fjalën "dashuri" te shqiptarët, thotë: "Në shumë martesë, me kalimin e kohës, ishte e natyrshme që të lindnin afritë dhe lidhjet emocionale e seksuale", por dashuria dhe ngrohtësia e ndjenjave nuk kanë qenë ato elemente që i bënin dhe i mbanin më këmbë martesat. Ka udhëtarë të huaj që nganjëherë kanë shtruar pyetjen nëse shqiptarët e kanë konceptin e dashurisë apo jo. Gjatë udhëtimit të

tij në Malësinë e Veriut, Karl Steinmetz-i erdhi në përfundim se "shqiptarët nuk e njohin dashurinë në kuptimin që ne kemi për këtë fjalë. Madje as gjuha e tyre nuk e ka fjalën e duhur për dashuri dhe dashuroj – për këtë të dytën ata përdorin me dasht, me kuptimin "kam nevojë, 'më duhet' (1904). Baroni Franc Nopça (1877-1933) nënkuptonte të njëjtën gjë: "Duke u nisur nga fakti se nusja dhe dhëndri as nuk e njohin njëri-tjetrin kur martohen. Madje,

dashuria praktikisht nuk njihet në malësitë e Shqipërisë dhe, për këtë arsye, në shqip nuk ekziston folja "të dashuroj". Ajo perifrazohet me foljen me dasht 'pëlqej' ose me lyp, 'kërkoj'. Lidhja e gjuhës dhe kulturës nuk mund të mohohet në vendosjen a përcaktimin e kuptimit të një shprehjeje dhe kjo është mënyra e të mësuarit e një gjuhe të huaje, në këtë rast edhe njohjes së gjuhës shqipe, e cila ka edhe dallime të caktuara nëpër rajone të ndryshme edhe pse

baza e trashëgimisë kulturore, asaj shpirtërore e materiale, botëkuptimi e të tjera janë të njëjta. Vënia në dukje nga të huajt, rreth asaj që Baceri e quan "kod", e që ne e trajtojmë si gjuhë që tërthorazi e thotë kuptimin, tregon për shprehjet kundërthënëse në mes formës dhe përmbajtjes dhe vetëm këta që e njohin këtë gjuhë dhe rrethanat, e kuptojnë shprehjen se a është afirmative apo kundërshtuese, a është përçmuese a ironike etj., e që janë të rëndësishme në komunikim.

Interpretime

POEZI QË RRJEDH NGA FRYMËZIMI E SHKËNDIJA

(Rreth poezisë "KAMBANË NË QAFË!" të Agim Vincës)

Sulejman MEHAZI

Arti i mirëfilltë poetik është takim i përsosur gjërash të dhuruara. Kjo dhuratë poetike i takon poetit të përkryer dhe të pandalur, Agim Vincës, sidomos, nga Revista letrare, Fjalë e valë, nr 23, SHSHM "Jakup Ceraja" Mitrovicë, 2012, numër tematik, i tre jubileve të rëndësishme të jetës së Agim Vincës, 65-vjetori i lindjes, 40-vjetori i fillimit të punës në Universitet dhe 40-vjetori i botimit të librit të tij të parë "Feniksi". Vlen të përmendim se në këtë vështrim jemi përqendruar për poezinë parafjalë "Kambanë në qafë!", që është domethënia e gjithë asaj çfarë është shkruar në këtë libër jubilar të

Agim Vincës. E çfarë shpreh poeti me kambanën e tij të varur në qafë? Ai shpreh të gjitha sekretet e tij poetike, jetësore, letrare, individuale, shoqërore, sociale, ekonomike, e kombëtare; shpreh thelbin e vetshpirtëror e psikologjik, sodit me vetëdije të lartë poetike realitetin e vërtetë jetësor. Kjo e vërtetë është shprehur me këto vargje: "Kur mora pusullën me vulë e nënshkrim!" / Tani jam i lirë, plotësisht i lirë, të dashur miq! / I kam gjashtëdhjetë e pesë dimra e beharë mbi kurriz / dhe shtatëdhjetë e pesë euro ne xhep! / Tash e tutje mbi jetën e poetit do të mbesin të vulosura shumë vepra poetike e shkencore, por asnjëra prej tyre nuk është më e vlefshme se kambana e varur në qafë, sepse për poetin Agim

Vinca kjo pusullë e vulosur me nënshkrim është njëfarë çlirimi poetik "Të shkruaj kujtime për veten dhe të tjerët, / të vajtoj për ëndrrat dhe iluzionet djaloshare...." Retiçencë poetike feniksiane. Poeti tash e tutje "Mund të dalë në Gërmi çdo mëngjes, të pi kafe te vila Lira për vetëm pesëdhjetë centë;" "Kambanë në qafë!" e poetit është e varur me 65 dimra sesa behare dhe vetëm me shtatëdhjetë e pesë euro pension në xhep. Absurde! Gjerësia dhe madhësia e kambanës së Agim Vincës është e mbushur me përplot vlera poetike, kritike, intelektuale; është e mbushur me studimet historike – letrare; me shkrime publicistike; me kronologjinë e jetës dhe veprimtarisë së tij; Kambana në qafë e tij është e lidhur me "Feniksin" që

"metaforizon qenien shqiptare, e cila rilind pas shumë shekujsh të mbetjes së saj në harresë nën të huajt" "Vargjet e ringjalljes", fq.19. Në kambanën e tij në qafë është e varur "dashuria dhe dhembja për nënën, është e varur bukuria e "Drinit e të liqenit që kotet në qetësi" kur qielli puthet me valë" Bukuria e thjeshtësisë, fq.27., e varur biografia e tij që është e lidhur me tokën e vendlindjes së tij; vargu i tij nuk gjezdis në qiell, sepse vetëm me truallin ka pirë gjak. Zëri i kambanës së Agim Vincës varur në qafë është i mbushur me shenjat e kumtimit që si platforma të zeza zbukurojnë vendlindjen, gjuhën shqipe dhe kombin tonë të përvuajtur me shekuj. "Madhështor është përfytyrimi poetik i Osman Kicës, i



i cili porsikreshnik legjendar, hidhet“ mal më mal e shkëmb më shkëmb/ e ha barutin me dhëmbë”. Poezia e Agim Vincës ndonjëherë rrjedh nga frymëzimi e ndonjëherë rrjedh nga shkëndija, nga drita që feks menjëherë. Frymëzimi poetik i poetit herë vjen nëpërmjet teknikave shprehëse, e herë pa mjete si të ndritura nga dielli përvëlues i liqenit të Ohrit. Frymëzimi poetik drejtpërsëdrejti i hy lexuesit në zemër, por ndonjëherë poezia përfaqësohet edhe nga vet zemra e poetit. Pra, pa menduar fare, befasisht vjen një kuptimësi e caktuar në zemrën e lexuesit. Në raste të tjera vjen si lajm metafizik, ose si një bisedë hyjnore e ndërtuar me ndjenja, arsye e intuitë. Sintagmën “Kambanë në qafë!” poeti e kupton si përgjegjësi, profesionale, jetësore, intelektuale, poetike, publicistike e shkencore; e kupton dhuratë melodike e poetike që i paraqitet poetit pa dëshirën e tij, befasisht, për poetin do të jetë përkthyes e së panjohurës, kjo kambanë poetike ka kuptimin e nuhatjes, ndjesisë bazuar nga përgatitja intelektuale, teorike, studimore e shkencore të Agim Vincës. Poezia “Kambanë në qafë!” e Agim Vincës, e këtij mjeshtri

të fjalës së bukur poetike, qoftë nga aspekti frymëzues, qoftë nga aspekti përmbajtësor është i mbështetur në realitetin e tij subjektiv, është shprehje frymëzuese e së vërtetës jetësore, janë fjalë që djegin lexuesin dhe përplot me kuptime. “Kambanë në qafë!” është poezi e MERITOKRACISË poetike e estetike të Agim Vincës. Ai nuk na mëson neve vetëm artin poetik, por edhe shkencën poetike, nuk shpreh vetëm artin kombëtar, por edhe shkencën kombëtare; nuk shpreh artin e përkuljes intelektuale, por artin e reagimit; nuk shpreh vetëm popullin e robëruar shqiptar, por edhe popullin e pandalur shqiptar; nuk shpreh vetëm periudhat historike letrare, por edhe orët dhe minutat e poezisë. Ai nuk flet vetëm për demokracinë partiake shqiptare, por edhe për turmokracinë partiake shqiptare. Kambanë në qafë e Agim Vincës është vibracion poetik i akorduar menjëzë ekstrem të ekzistencës. Vargjet e poezisë janë transformime ndjenjash në gjuhën poetike, kurse përvoja poetike e poetit është mjet i kësaj melodie të kambanës së tij. Poeti flet për ndjenjat e tij poetike që i ka nxjerrë nga mahnitja e transit të tij kuptimor, që më pas i ka sublim-

uar në poezi. Agim Vinca thellësisht e pranon se poezinë e ka mësuar prej dashurisë kombëtare. Për shkak kësaj dashurie vdiqën edhe shumë më të rinj se Agim Vinca: “Migjeni nuk e pati këtë fat. Për të kjo qe një ëndërr e largët./ Për moshën e kam fjalën./ As Naimi jo. I mori para kohe që të dy tebeceja./ Luigjin plumbi, Bilalini thika./ Jusufin prita në Untergruppenbah vetë i tretë.../ Enigmë e një vrasje të trefishtë!” Majakovskin, Lorkën, Hikmetin, Bajronin, etj, Dhe Plaku i Makit, De Rada nderroi jetë thotë Agim Vinca “me një cironkë në xhep” Në vargjet përmbyllëse të poezisë “Kambanë në qafë!” Agim Vinca nën trysninë e transit dhe ekzistencës poetike ndien një ngushtim poetik, duke na bërë me dije se edhe poezia sikurse proza është e pamjaftueshme për të shprehur atë që do ai vet; “A s’është për t’u lakmuar kjo?!” Mund ta shkruaj testamentin si Dhimitër Pasko/e t’u lë porosi gruas dhe fëmijëve: “/Atdheu është atdhe edhe kur të vret! / Pardon, kur të nxjerr në pension! / Me shtatëdhjetë e pesë euro në muaj/për bukë, ujë, qumësht, ilaçe, qefin a plaf...” Që sipas shenjave të?! (pikëpyetjes dhe pikë çuditëses) poeti gjendet në ud-

hëkryqin poetic, sepse, në njërin anë përdor arsyetimin e tij intelektual, me anë të pikëpyetjes, kurse në anën tjetër, habinë, emocionin, përjetimin poetik, me anë të pikë çuditëses. Këtë e bën me qëllim për t’i dhënë forcë emocionit poetik, jo me fjalë, por me heshtje kuptimore shpirtërore; në këtë gjendje të frymëzimit poetik Kambana e tij shndërrohet në protestë testamenti poetike. “Dhe titullin kumbues Profesor Doktor

Varur si kambanë në qafë!

Si kambanë në qafë!

Kambanë në qafë!

Në qafë!

Ah!

Pra, poeti kur është në këtë gjendje të frymëzimit poetik i dorëzohet pasthirmës “Ah”; në këtë shkrirje poezia ngritet në gjendje më të lartë dhe e humb fillin. Sepse sipas vargjeve të fundit: “Si kambanë në qafë/Kambanë në qafë!/Në qafë! Ah! Poeti Agim Vinca shkronjat, zërin dhe fjalët i copëton duke i përplasur njëra me tjetrën për të biseduar vetëm me pasthirmën protestuese, emocionale, Ah!. E ç’është Ah-ja? Çlirimi poetik dhe zëri i kambanës poetike të Agim Vincës.

Botime

NJË ROMAN KUMTESH

(Rreth veprës VITO të Bashkim Hoxhës)

Agim BAJRAMI

Ajo që të bën të përjetosh njëherësh dy gjendje të ndryshme në këtë roman të Bashkim Hoxhës, është jo vetëm subjekti intrigues, por edhe auto-alegoria e jetës së protagonistëve, të cilën ata nuk ia besojnë askujt tjetër, përveç vetvetes. Edhe përkundër spontanitetit të saj, një veprim i tillë është kaq spontan dhe mjeshteror, sa narratorit s’i mbetet të bëjë tjetër gjë përveç rolit të regjistruarit. Vëzhgues dhe hulumtues i kujdesshëm gjer ne detaje, ai është i vetëdijshëm se duke pasqyruar protagonistë të tillë, është duke pasqyruar njëherësh edhe fragmente të një kohe cinike, kur jetën dhe vdekjen mund t’i merrje fare mirë si zëdhënëse të njëra tjetrës. Është ky shkak që gjatë shfletimit të jetës së tyre të ndihesh i pushtuar nga i njëjti ajër dhe makth ekzistencialist si ai që i ka munduar gjatë gjithë kohës edhe jetët e personazheve që je duke lexuar. Veprimi i heroinës së romanit me të njëjtin emër, Vito, ka një funksion të dyfishtë (çka është edhe mjeti intrigues i kësaj veprë). Të vajojë jetën e të tjerëve, duke vajtuar njëkohësisht edhe mjerimin e jetës tënde. Në këtë kontekst kjo vepër i ka të gjitha të shkruara në një të vetme, makthin ekzistencialist, rebelimin, por mbi të gjitha ironinë dhe sarkazmin, ndaj fajtorëve të veshur me pushtet dhe paprekshmëri, veprime mjaft sinjifikative këto në një shoqëri ku shpresa ka lindur e vdekur. Në një kuptim më të gjerë “Vito” është një roman kumtesh, ku

më mbizotëruesi prej tyre është: Ka njerëz për të cilët jeta ka ngjyrë të zeze, ndërsa për individë që bëjnë sikur jetojnë, vdekja mund të ketë edhe ngjyrë të bardhë. Shtatë plaka, katër pleq dhe një vajzë, që lexon libra, përbëjnë një simbolikë interesante, ku komikja dhe tragjikja shtyjnë pareshur njëra tjetrën, duke i dhënë narrativës romaneske intensitetin dhe energjinë e nevojshme. Personazhet që lëvizin në të njëjtën lidhur ngushtë mes tyre dhe në një farë mase ata plotësojnë njeri tjetrin me parimin e enëve komunikuese Vito dhe Niko, Qanija dhe Roza, Vito përbëjnë një tipologji interesante qoftë me botën e tyre të brendshme, ashtu dhe me veçantitë e tyre karakteriale. Pasuria dhe larmia e dukshme e frazeologjizmave dhe shprehjeve gjuhësore të tyre apo sentencat filozofike për përvojat dhe kuptimin e jetës, përveçse mjet identifikimi, janë në një farë mënyre edhe mjete artistike për të shprehur sa më fuqishëm revoltën dhe pakënaqësitë e tyre ndaj shoqërive të mbyllura dhe aspak tolerante, siç ishte shoqëria dhe sistemi diktatorial në vendin tonë. Është kyti-par që i bën më origjinal jo vetëm këta personazhe, por edhe krejt prozën e gjatë të Bashkim Hoxhës, në raport me krijuesit e tjerë bashkëkohorë. Jo më kot gjatë njohjes me historitë e çuditshme të tyre lexuesi model ndihet si i pushtuar nga ideja se: Të gjithë njerëzit jetojnë të njëjtën histori, por të ndryshëm na bëjnë rrethanat dhe mënyrës së lëvizimit në trajektorë të jetës. Në pasqyrimin e personazhit kaq kompleks siç është Vito, kemi

një bashkëveprim të ndërsjellët mes zërit dhe figurës. Nëse në momente të zakonshme zëri plotëson figurën, në momente të tjerë ndodh e kundërta. Në kohën kur ajo filloi detyrën e saj si vajtojçë dhe zuri të qante një të ri, figura nisi të kryente funksionet e saj plotësuese “Të gjithë arrinin prej zërit të saj të shikonin sytë, duart, trupin që grisej dhe ato copëza letre që treteshin në erë. Që nga faqja e parë dhe gjer tek e fundit, qëllimi parësor i veprës është zbulimi i sekretit të qenies dhe alegoria e fundit të saj. Vita arrin ta realizojë këtë nëpërmjet vajttojçës rivale Qanije. Konkluzionet e saj filozofike rreth individit të pavarur dhe prishjes së ekuilibrave të tij me turmën, janë kaq tragjike dhe tronditëse. Kombinimi i jetëve në lojën e ruletës së madhe, edhe pse në pamje të parë, nuk kanë asgjë të përbashkët me njeri tjetrin, në fund i bashkon fakti se në finale të gjithë, duam s’duam, ndajmë të njëjtin fat. Esenca e narrativës së këtij autori është ekuilibri mes raporteve të së dukshmes dhe së padukshmes, si dhe shumëkuptimshmëria e shprehjeve, që nëse do të përdorja një citim nga John Foss: “Më shumë se informim janë kuptime më vete”. Kjo ndodh ngaqë autori nuk shkel dy apo më shumë herë në të njëjtin shteg, duke ia kursyer kësajsoj lexuesit të tij përshkrimet e gjata dhe të lodhshme. Me fraza të prera dhe pothuajse telegrafike, ai e çon atë, pa e sorollatur shumë në thelbin e rrëfimit. Dialogët e personazheve, të pasur, të thellë dhe plot ngjyresa filozofike janë asete të vyer. Për shembull:

“mos ia bëj shtëpinë kazermë byr-azerit tim” (nga biseda e Nikos me Vitën). Ose “mua nuk më është tharë ende trëndafil, që më solle para ca ditësh. E mbaj në një kavanoz, që ka pasur turshi kastravecësh”. Kësaj proze i mjafton një regjistër fjalësh dhe shprehjesh të caktuara frazeologjike, për të pasqyruar më së miri gjendje të caktuara jetësore, por më së shumti edhe filozofi të caktuara për individë dhe rrethana historike. Vetëm në kapitullin e nëntë mund të hasësh një duzinë prej tyre. Ja disa: “Serioziteti u takon murgjve dhe filozofëve. Jeta nuk është festë, festa zgjat një ditë, fishekzjarrët shuhen dhe harrohen etj. Po kështu edhe përdorimi efikas i alegorisë. Kjo është një armë me të cilën autori depërton gjer në skutat më të thella të personazheve të tij, duke i zhburrëruar dhe bërë gesharakë ata. Një alegori të tillë Milan Kundera e rreshton në dhjetë tiparet esenciale, drejt të cilave duhet të priret romani i sotëm. Jam shumë i bindur se interesi i lexuesit dhe kritikës ndaj romaneve të fundit si “Duartrokitësit”, “Kronikat e mjegullës”, “Asnjëherë të martën”, “Dimri i librave” nuk dot të kishte qenë kaq i dukshëm, pa praninë e saj të fuqishme. Nëse në planin moral mjeti alegorik i shkatërron dhe shpërfytyron personazhe të caktuar, në planin artistik ai arrin të krijojë me ta modelin estetik të së keqes, çka është edhe një dëshmi e pjekurisë dhe forcës artistike të këtij autori. Si zgjatim të kësaj alegorie mund të merren edhe refleksionet antidiktaturë, të

cilët edhe pse zënë një numër të kufizuar faqesh, flasin shumë. "Turma e zhurmshme, që përplaste hapat me zhurmë, e përfshiu atë brenda vetes. Simoni ecte me ritëm tjetër. Ata e futën brenda vetes, që Simoni të ecte me ta me një hap. Por, Simoni donte të dilte dhe turma e shkeli me çizmet e saj dhe e la të vdekur. Të njëjtin emocion provon edhe te momenti i martesës së fantazuar të Nikos me Rozën, të cilën autori e sendër-

ton me pluhurin mitik të baladës së fjalës së dhënë dhe valsit të vdekjes. E prirë nga filozofia se asnjë individ nuk mund ta ndërtojë individualitetin e tij në kushte depersonalizuese, individët e këtij romani mundohen t'i zgjidhin në mënyrën e tyre format e mbijetesës. Ata perfeksionojnë artin e komunikimit dhe qëndresës së heshtur me kundërshtarët dhe të keqen e madhe. Mbyllen brenda kullës së alegorisë, nisin t'i marrin

jetët e tyre me shaka, ashtu siç nisin të marrin edhe vdekjen. Nëse do t'i hyjmë thellë thellë një veprimi të tillë kemi të bëjmë me një lloj rebelimi të pashpallur ndaj kultit të së keqes, përballë të cilit ishin gjunjëzuar shumica. "Ti përgatit vdekjen i thotë Niko Vitos, ndërsa unë po përgatis dasmën". Kjo është arsyeja pse midis Nikos dhe Vitos ekziston gjithmonë një urë e padukshme simpatie dhe një kod i heshtur mirëkuptimi. Per-

sonazhe të tillë i mundon pengu, se edhe pse në moshë të madhe, akoma nuk kanë mundur ta gjejnë shkakun e ardhjes së tyre në jetë dhe pse -të e shumta të saj. Me gjithë vramendjet dhe përsiatjet e tyre të shumta, ata e ndjejnë se më pak se gjithçka kuptimi i tyre për jetën është dhe mbetet absurd. Ajo çka mbetet për t'u shijuar më pas, s'është gjë tjetër, përveç shijes së athët që të lë zhgënjimi.



Interpretime

EPTIMI I ELEMENTEVE LIRIKE

Koha poetike e Alidës është një frut i pjekur. Është si një portokall që kur çel lulet e bardha dhe duket si "vello" magjike, ku edhe shpirti qetohet nëpërmjet vargjeve

Emrije KROSI

Përsëri me një cikël poetik të ri "Post scriptum", doktoresha - poete Ailda Mëngjesi, na befason me një poezi ku përditësia herë bardhë/zi, herë me dritë/hije, por me shumë ngjyra, përsëri ...përsëri na përpin, me atë fshehtësinë dhe fisnikërinë e saj të ndjenjës së fisme të shkrim-it, përmes zhgënjimeve dhe shqetësimeve, jo vetëm si poete, por edhe si njeri. Ajo di si t'i përshkruajë ato ndjesi, duke përplotësuar edhe madhëruar aftësinë e saj krijuese,

pas librit të saj të parë "Pothuajse". Koha poetike e Alidës është një frut i pjekur. Është si një portokall që kur çel lulet e bardha dhe duket si "vello" magjike, ku edhe shpirti qetohet nëpërmjet vargjeve: kam ëndërruar gjithnjë të shkruaj/një këngë që të mbështjellështratelodhura/të planetit/biliona vitet nën lëkurë/shkelur miliona vite me këmbë nga poezia "Homo Sapiens". Ajo po kërkon pikërisht njeriun. Njeriun e pafajshëm. Njeriun Homo Sapiens. Po kërkon origjinën tonë. Njeriun që akoma beson te parajsa e përjetshme, para

se të njohë "pemën e të mirës dhe të keqes". Ajo noton, rrjedh, valëzohet, rrëshqet si uji në gravitetin e vargjeve që dallgëzohet herë si oqeani herë si deti Adriatik, herë si orteku dhe herë si Ajzbergu, që nga ferr-parajsa, deri te vjeshtat, që nga e enjtja deri te dimri, që nga nokturni deri te ezertikja, që nga mungesa e një telegrami deri te loja boshe e shkurtit, që nga alteregoja deri te përsiatja. Ajo udhëton me interkontinentalin përmes kapriçeve të motit, në kërkim të një syri fëmije, sepse për dashurinë do të ndërmarrë udhëtime të trënd-

filta deri atje, ku të kërkon për të përkorën. Por, a ekziston e përkora? Poezia shpërfaq elemente si: a) të kohës si njejtim poetik dhe kohës reale njerëzore, b) të mallit dhe mungesës nëpërmjet elipsave dhe reticensave, c) të teprisë dhe mungesës nga mbingopja me neverinë dhe absurdin, d) të takimit mes dashurisë dhe lirikës, e) të eptimit të së bukurës dhe dlijësisë femrore, f) të problematikës përditësore në një shoqëri surreale dhe virtuale, dhe g) të elementeve gjuhësore me metafora dhe elemente semantiko-stilistikore.

Përmes leximit, ajo kërkon jo më vet-veten, sepse ajo e ka gjetur atë. Por, po kërkon një lexues tjetër: atë lexues që gjen paqen e humbur të vetes, nga rrokopuja absurde e jetëve tona. Ajo e fton njeriun-lexues, të mbledhë copërat e shpërbërjes nga kalbëzimi ynëmodern. Përtëqenë "uni" ose "unë", në të gjithë vorbullën miliardëshe të globit, a thua se toka rrotullohet ndaj secilit prej nesh? Apo rrotullohet vetëm rreth vetes tonë (vetvetes)! Në këtë rrafsh horizontal poetja udhëton nëpër kozmosin poetik, me një stil të qetë dhe të shtruar, për ta bërë lexuesin e ri dhe të vjetër, të besojë tek magjia e fjalës së bukur dhe poezisë së mirë, kur ajo dredhet kaq e çlirët. Ailda vërtetë beson se poezia e mirë ekziston. Lexojeni dhe besojeni edhe ju. Paplotmëri dhe të papërkryer ka, por perfektshmëria nuk ekziston. Të përplotmëruar dhe të përkryer e bëjmë ne: marrëdhënia lexues-poet!

Botime të veçanta

15 NËNA RRËFEJNË 15 DHIMBJE KRENARIE

(Rreth librit "Ato gdhendin dhimbjen" të autores Alketa Gashi Fazliu)


Zymer KUQAJ

15 nënashqiptare të Kosovës, janë ato që gdhendin dhimbjen më rrëfimet e tyre para gazetares, poetes dhe shkrimtares Alketa Gashi Fazliu. 15 nëna shpalosin dhimbjen dhe mallin për bijtë dhe bijat e tyre që gdhenden lirinë e Kosovës më jetët e tyre të njoma. 15 nëna nga mijëra nëna tjera kosovare shpërfaqin zemrat dhe shpirtrat e tyre të pastër, por të lënduar para autores së librit të A. G. Fazliut me titull "Ato gdhendin dhimbjen". Janë këto 15 nëna të djemve dhe vajzave të Kosovës që u rreshtuan në radhët e UÇK-së për të dëshmuar lavdinë e tyre, që kjo lavdi të jep frytin e vet më emrin, liria e Kosovës. Tregimet e nënave në këtë libër janë të lirshme dhe të natyrshme. Nënata flasin më zemrën e tyre të lënduar duke u shprehur lirshëm më gjuhën e përditshme. Fazliu i shkruan këto tregime ashtu siç i dëgjon, pa kurrfarë korrekturë

gjuhësore, pa zbulime dhe pa stërmadhime. Autorja nuk e bën këtë pa qëllim. A mund të bëhet përmirësimi gjuhësor i një nëne që flet më fundin e shpirtit të vet? A ka kush që mund të zbulojë më shumë tregimin se sa nënat kur flasin për fëmijët e vet, heronj të Kosovës? A ka diçka më madhore dhe më sublime se jeta e njeriut për lirinë e popullit që i takon? Janë këto arsye që autorja na sjellë "15 rrëfime nënash zemërshpuara" krejt autentike dhe pa kurrfarë censure. Në 15 rrëfimet e nënave pasqyrohet koha e luftës së fundit në Kosovë. Vuajtjet e kësaj kohe nën okupimin serb dhe lëndimin e zemrave të nënave me shkrimin e emrave të bijve dhe bijave të tyre në al-tarin e lirisë. Janë rrëfime të nënave krenare në kohën lirisë. Krenaria e nënave në lirinë e Kosovës, ka edhe mungesën dhe dhimbjen e madhe për fëmijët e tyre që sakrifikuat jetën për këtë liri që e gëzojmë sot.

Rrëfimet e nënave janë të ndryshme, por është ngjashmëria që dominon në rrëfimet e tyre. Të ngjashme janë dashuria e pakufishme e nënave për fëmijët e tyre dhe zbrazëtia që ata kanë lënë në zemrat e tyre. E përbashkëta tjetër e madhe është frika dhe ngurrimi i tyre që fëmijët e tyre të bëhen pjesë e luftës. E përbashkëta madhështore është kur nënat kuptojnë vendosmërinë e fëmijëve të tyre, i urojnë më gjuhën e nënave. Me hajr u koftë rruga që keni nis. Zoti qoftë më ju. U kthefshi faqebardhë. Përkundër asaj që dihej dhe paralajmërimeve për nënat se kjo rrugë ka edhe sakrificat e veta, zemrat e nënave nuk mund të paramendojnë më të keqen për bijtë dhe bijat e tyre. Ato, megjithatë shpresonin në kthimin e tyre faqebardhë. 15 rrëfimet e nënave është vështirë të përshkruhen në mënyrë të veçantë. Është vështirë dhe e padrejtë të përmendet një emër nëse nuk

i veçon edhe 14-të të tjerë. Është e përbashkëta veçanti e rrëfimeve të tyre në këtë libër. Libri nuk do të përfundonte më bukur se sa më heroin e fundit të personazheve të këtij libri. E bukura në historinë e shqiptarëve e ka pashmangshëm edhe dhimbjen. Libri përfundon më këtë fjali. "Nuk ishte i martuar, por trashëgim ka lënë lirinë e Kosovës". E përbashkëta e 15 heronjve që vjen ngarrëfime të 15 nënave, është se ata/ ato trashëgim kanë lënë (gdhend) lirinë e Kosovës, bashkë më lotin dhe dhimbjen e nënave zemërshpuara. Libri i Alketa Gashi Fazliut "Ato gdhendin dhimbjen", është një vepër që përshkruan luftën dhe sakrificën e popullit tonë për liri. Autorja kryen një obligim qytetar dhe kombëtar karshi qëndresës tonë për liri. Pjesë e kësaj qëndrese janë edhe nënat shqiptare të Kosovës. Ajo e kryen



Tregim

VARRI I ÇUDITSHËM


Teodor KEKO

Në varreza filloi të binte muzgu dhe andej nga thellësia, djathtas, gjithmonë duke ecur diagonal hyrjes kryesore, flakariti një rozë ende e lehtë dhe Llani u kujtua për qiririn e pandezur në xhep, mirëpo as u kthye në kupën e dheut ta ndizte atë qiri e as e futi dorën në xhep ta nxirrte. Priti një herë të ndahej nga roja i parcelës C. Nuk e njihte njeriun përballë e s'donte të acarohet me të për punë zakonesh fetare e bestytnish, aq më tepër, që s'po e cyste e nxitonte gjë ta ndizte me vrap qiririn, se kujtesa nuk po i nxirrte ndonjë rregull, që thoshte se qiriri s'ta ndrit shpirtin, në u ndezte natën e jo në muzg. Si të ndahem me këtë, po e ndez, e ndau mendjen Llani, pastaj futi dorën në xhep e nxori në vend të qiririt paketën e cigareve, i ra fundit të saj me ca goditje të gishtit të madh dhe ia zgjati tjetrit cigaret pa i prekur filtrat me gishtërinj. Mbase ishte manjak pas pastërtisë roja dhe pse t'ia bënte ters e zeher nderin. -Urdhëro!-i tha me dorë të vendosur në zemër. Atëherë e vuri re se rojtari ishte si xhind e shenjt bashkë, i shkëlqenin sytë, a thua i kishte bebëzat prej fosfori, dhe ta shihte ftohtë, me një mosbesim dijetari mes rrugaçësh. Rojtari e mori cigaren dhe, tek po bëhej gati ta ndizte, e pyeti Llanin, që e futi paketën në xhep pa marrë një cigare për vete, se pse s'e ndezi dhe ai. -Këtu brenda mureve nuk e ndez dot, -iu përgjigj Llani, -s'ma pranon shpirti. Matanë portës, po, -i tha. Fjalët e ndërruan rojtarin. Andej djathtas, nën kodër, flakët e qirinjtë tani ngrohnin qiellin dhe varret dukeshin si pemët me perëndim në shpinë. Pastaj edhe ai vetë ngjau në atë sfond dridhës flakësh si monument i errët, pak i kërrusur, a thua mbronte tokën me strehën që i krijonte gjoksi. -Mirë e ke, -i tha Llanit me një ton të vendosur. -Është gjynah, po unë e ndiej se më falet. Të vdekurit e kanë lidhur

jetën me mua dhe më kanë pranuar me të mirat dhe të këqijat që kam. Pastaj, ai që të mërzi nuk të detyron të mos ngushëllohesh. Mua më ka vvarë zoti tani që, kur shoh gur, them "ti do të bëhesh pllakë varri"... Dukej se atë e vriste ndërgegjja sa herë e ndizte cigaren brenda në varreza dhe mundohej t'ia mbushte mendjen vetes me çdo formë e mënyrë që ai, vetëm ai, të kuptohemi, nuk po bënte mëkat dhe Llani nuk e gërvishti me plagën e kurorëzuar tashmë, vetëm i tha shpërfillshëm: -Më duket se e paske një inat me ne të gjallët! Tjetri u shtrembërua dhe iu dobësua pak drita e syve me flakën e çakmakut. -Unë me të gjallët inat?! -bëri me një shpërfillje tipike për atë mashkullin e ndershëm e të ofenduar në palcë, që kërcen i indinjuar e bërtet: "unë të bëj pazar me atë qelbësirë!" Ja, kështu u shpreh edhe ai, po Llani nuk e mori vesh tamam nëse rojtari i përçmoi të gjallët, apo pyetjen e tij. I hodhi një vështrim vetëtimthi vetes për të parë sa pis ishte brenda, atje te shpirti, ku merrte ngjyrë çdo vepër e sjellje e tij, po hoqi dorë nga ajo punë. Ç'ta prishte gjakun kot! -Po ç'e mirë të ka sjellë këtë? -e pyeti rojtari, pastaj, tek pa çudinë tjetër tepër të lexueshme në portret të Llanit për atë "ç'e mirë në varreza?", shtoi se e mira më e madhe është të nderosh të vdekurin. -Ata as shohin, as dëgjojnë, -bëri duke hapur dorën e djathtë drejt varreve të errëta tashmë, -domethënë, e bën nderin se je njeri që di të nderosh e jo se ta lyp interesit. Kurse sytë i ndritnin edhe më. Duket, po bie nata tamam, mendoj turbull Llani, kurse me gojë tha shkoqur: -Duam të ndërtojmë një varr dhe më ka dërguar mua shtëpia të interesohem... Ku e njeh Krenarin ti, trishtoi me vete Llani, çfarë drite ishte, si sytë e tu e kaluar një mijë herë, pastaj u përmend nga pyetja e ftohtë e tjetrit, se ç'moshë kishte i vdekuri, dhe iu përgjigj gati po aq ftohtë: -7 vjeç! Nuk dëshironte të fliste me këtë shpirt-

kazmë për engjëllin e vogël, për Krenarin e mrekullshëm që iu dilte për natë në ëndërr, sepse do ta fyente kujtimin e tij deri ku s'mbante më. E ku kishte ndjenja ky bari varresh? Gur i qenë bërë me kohë dhe, po t'ia ngulje sytë, si varr të dukej me atë flakën në supe. Mirëpo s'i hyri inati plotësisht, sepse e shtangu të gjithin e ia ndaloi gjithçka në mes zëri i lagur nga një ngashërim i brendshëm i rojtarit: -Nuk i bëhet varr atij, o njeri! -Pse? -u habit Llani dhe u drodh nga ideja se tjetri duhet të qe përlotur, përderisa sytë nuk i shkëlqenin më si pak çaste më parë. -Po nuk i takon tokës ai, është fëmijë, -shpjegoi tjetri zëulët, gjithë ashtu i ngashëryer e i trishtuar. - Ai është i pastër, -shtoi pastaj më qetësisht, -dhe pastërtia i takon qiellit, se bëhet diell e ajër e jetë! Llani nuk u lidh krejtësisht nga kjo logjikë, rrinte e shihte si debil flakën e qirinjtë në supet e rojtarit, pastaj kundronte Krenarin, ylberin mahnitës, pastaj dhe diellin dhe mësuesin e materializmit në shkollë, që thoshte se sendet përbëhen nga materia, dhe befas filloi të besonte vërtet se këto mrekulli, si dielli dhe oksigjeni, ylberi dhe bora nuk mund të krijohen nga materiale ordinere e të rëndomta, që përbëjnë, fjala vjen, spinaqin, ose karrocën e plehrave. -Po si t'ia bëjmë, sipas teje? -e pyeti Llani, -ta lemë pa varr? Ai s'ishte cigan! Ra një heshtje e rëndë, dukej që tjetri nuk dëshironte të përgjigjej, ose u ndodh ngushtë nga pyetja e drejtpërdrejtë e që s'pranonte asnjë lloj kompromisi, dhe u kollit më shumë nga mëdyshja, sesa nevoja e trupit. Llani ia ndjeu një marrje fryme të plotë e të thellë dhe tha me vete se rojtari tani do t'i përgjigjej, pastaj e pa menjëherë si u drodh e u derdh në shpatullat e tjetrit ajo flakë qirinjtë, që dukej sikur ai e thithi brenda gjoksit me atë frymëmarrje. -Ja si them unë, -foli më në fund rojtari. Tani ishte tamam natë. -Njeriu u mësua prej kohësh t'i bëj varr edhe

të mirit, edhe të keqit. E di sa të poshtër prehen këtu, se po ndot gojën me të ikurit, që s'shahen? Plot! Ama, të gjithë kanë varre! Njerëzit e dinë këtë, se vetëm budallenj nuk janë. Kështu që i kapi zakoni i ndërtimit të varrit si lamtumirë e fundit me të vdekurit, dhe, me t'ia ndërtuar banesën e fundit, nuk shkelin më në varreza. Është hesap kjo punë: e do varrin, merre! Tani, ti në punën tënde, unë në punën time. Me një fjalë, ku jemi parë bashkë! Ju çunit bëjini jo një varr, po një monument! Unë them, të mos e harroni, se ka qenë i pastër, i pamolepsur nga pislleqet!... Dhe Llani e porositi varrin të madh e të rëndë, aq sa të vinte keq kur mendoje se mund t'ia shkallmonte arkivolin dhe eshtrat Krenarit të vogël, nëj varr i çuditshëm, prej graniti të hirtë, vetëm pllakën ia porositi prej mermeri të zi dhe në atë natë kërkoi të shkruheshin me shkronja të arta ato fjalë që e bënë varrin të çuditshëm në atë vend ku s'ekziston çudia, siç është varreza publike, dhe që e kthyen varrin në vend pelegrinazhi, eliksir ngushëllimi për çdo humbje tragjike: "Këtu prehet Krenar Halimi, 1981-1988, ka qenë i pastër, i pamolepsur nga pislleqet". Ky varr i kushtoi Llanit 1250 lekë, po të kihet parasysh se 780 lekë iu faturua komplet varri, kurse me 470 Llanit iu desh të qeraste dy herë drejtorin e ndërmarjes së riparimeve, për ta marrë përsëri në punë mjeshtrin varrbërës, i cili u pushua në vend nga puna për shkrimin pa pikë përgjegjësie të atyre fjalëve ofenduese për ne njerëzit, në pllakën e varrit. Në të vërtetë, ai edhe mund ta hidhte lumin pa u lagur, sikur të pranonte propozimin e drejtorit të funeraleve për prishjen e shkronjave të pllakës, po nuk e bëri këtë. Vetëm tundi kokën dhe tha: -Unë nuk kam gënjer, ai i pastër ishte! Në qoftë pis ndonjëheri nga ne, qoftë me shëndet, e atë djalin ta lërë të qetë në botën e vet!



Poezi : Nehas SOPAJ

PA NANË

Nanë,
kur ti shkove me u ba tokë,
unë kafshë u bana,
nji ujk që po hante veten dalëngadalë.

Nanë,
kur ti nji dite shkove me u ba qiell,
unë lotë u bana,
nji pikëz uji që dielli e pinte ngadalë e nuk sosej.

O kur ti, Nana ime,
nji dite shkove me u ba muzikë,
muzikë e sferave,
për mue perënduen dielli, hana e gjithë yjet.

E unë kujtoj çka tha Hyji:
prej toke ju bamë
dhe në tokë do t'ju kthejmë nji ditë!
I lumi o i lumi ai që do të rilind!

NANA. ORA E NDALUR

Pak para se të vdiste, Nana shikoi orën në mur,
priti e priti
kur do të vdiste,
por të gjithë zogjtë e botës
ranë përtokë.

Toka u bë hí,
e era - Hera,
ose nusja pa duvak,
që desh t'ia mbathte përtej kohës,
méjti...

Unë, i përzura me duar të gjitha yjet nga qielli.
Nana shikoi orën në mur,
muri u lëkund:

"Mbahu Nano"!

KATËR VITE MË VONË

Katër vite pas vdekjes,
në kopshtin tim
prej parajse erdh Nana.
Vetë.

Këmbë.
Me flokë të lidhura gërshet.

Qe shndërruar në letër të bardhë.
E kishin nxirë të gjithë kalemxinjtë tanë.
E unë,
në pjesën time të ëndrrës, që akoma
vazhdoj të thahem, të terem, të zvogëlohem,
të bëhem mi,
para hirit të saj, pa zë, zura të qaj, të shkrehem.

Por ata, vëllezërit e mij siamezë,
kufomat e gjalla,
pa shikoj si po trashen në çdo kohë.
Shih si po majmen, kolmen.

Kopshtit tim po i bie erë
kutërbimesh,
kalbjesh.

VETMIA

Njëzet minuta para se ta jepte frymën e fundit,
Nana shikoi orën në mur
vetë Nana,
vetë.
Një jetë të tërë, vetë.
Vetë - vetmia,
Së pari e lëshoi një pikë loti,
pastaj shkoi e u bë fletë duhani.
Pastaj,
me sy të lëmekur,
u shndërrua në letër të bardhë
të cilën e nxijmë ne të tjerët. Përgjithmonë.

Tani unë në tërë pjesën time të jetës -
thahem, terem, zvogëlohem,
bëhem mi,
e Nana vetë, vetë - zjarri i vatrës sonë.
vetë Nana,
shndërrohet në kuptimin

të cilit akoma s'ia kemi gjetur emrin e vërtetë.

NANA KALON KOPSHTIT ME PEMË

Edhe pse ka vite që ka vdekur,
Nana kalon kopshtit me pemë, karshi meje,
unë e ndal frymën dhe s'pipëtim
duke ia kërkuar
fytirën.

Ajo është rrufë me flokë të lidhura gërshet
dhe unë s'guxoj t'ia kërkoj sytë. S'guxoj sepse
sytë e të vdekurit mund ta ngrijnë në vend të gjallin.
Këta sy,
sy mamuthi që hedhin zjarr,
uranium nga rruazat e nëntokës,
kërpudhë atomike,
po pra, këta sy janë mu ajo vetë!

Ajo s'është më ndër të gjallët, por në vend të tyre,
do rruaza të vogla e të zeza, si rrush i hidhët,
ndanë një kaçubeje me sy gëlojnë
mëllagave prej zogjësh!

E unë, e unë,
në herbarium shoh një kanjushë si fluturon sipri
me zanat hemafrodite të Sambapatisë
së Santana-s,
hardhisë të cilës
i kanë rënë rrushtë përtokë
me fletat e gjelbërta e të skuqura flakë,
vjeshtës që ia ha breshka
shermenin e fundit.

Ajo,
Nana jonë,
një ditë do të na çlirojë nga ëndrrat të gjithëve...

Një ditë
ajo do të na gjejë
në një fletë fluture, në këtë kerubin,
në këtë herbarium,
i cili rri mbyllur
në bodrum
me merimanga e mëllaga.

Shkoqitje

ROBERT MUSIL PËR ALEKSANDËR MOISIUN



Ai nuk luan një Hamlet që e vret mendjen shumë, as një udhëzues të metafizikës, as edhe një 'Unë' të përçarë, apo jo? Por thjesht një njeri fisnik, që do të bëhej hero, nëse fati që i ka rënë mbi shpinë nuk do të qe tepër i rëndë për rininë e tij.

Zimo KRUTAJ

Ai e do mëmën e duhet ta përbuzë, ai ndjen neveri për njerkun, por për këtë nuk mund ta vrasë menjëherë! Skena e fantazmës natyrshëm bëhet si një zë i brendshëm. Te takimi me shokët e tij të studimit bëhet për një çast më i ri. E gjithë kjo ka shkëlqimin e një temperamenti të madh e të errët që vihet re tek ky Hamlet. Ai nuk përpiqet (të jetë), ai është... Ekzistenca e aktorit të madh është: të ngjitet nëpërmjet shembujve... prandaj arti aktorial zbrazet kaq lehtë, imitim pas imitimesh, pashpirt, dinamik, armik ndaj artit. Ai duhet të gjallërohet nga aktorë si Moisiu, të cilët dinë të lexojnë partiturën. Krijimtaria e Aleksandër Moisiut është e përmasave të tilla që, padyshim, do të shërbejë si pikë referimi për kritikët e studiuesit e artit në kohë të ndryshme. Dimensionet evropiane e botërore të artit të tij aktorial, gjenia e tij krijuese, personaliteti artistik, dhuntitë e rralla e teknika e përkryer e interpretimit, mahnitën e ngjallën admirimin e bashkëkohësve e vijojnë të jenë edhe sot e gjithë ditën, objekt studimi. Në këtë fushë, për të njohur e për të

kuptuar më mirë thelbin e cilësitë e pashoqe interpretative të këtij mjeshtri të skenës, është përherë e dobishme e me interes të shihen, të studiohen e të sillen për artdashësit shqiptarë, mendimet, gjykimet e vlerësimet e njerëzve të shquar të kohës për aktorin e madh... e të nxirren përfundime prej tyre. Janë vërtet, jo vetëm të shumtë, por edhe nga më të njohurit e më të afirmuarit, personalitetet e artit e kulturës botërore që kanë shkruar për Moisiun. Mes tyre spikat kulturologë, shkrimtarë, dramaturgë, regjisorë, kritikë teatri e aktorë. Mjafton të veçojmë emrat e Stefan Cvajgut, Tomas Manit, Maks Brodit, Rainhardit, Stainslavskit, Hauptmanit, Pirandelos, Basermanit apo Viktor Eftimiut e Shaljapinit. Krahas tyre do të renditet edhe emri i shkrimtarit të shquar austriak Robert Musil, mjaft i njohur në Evropë e në botë. Vepra e tij për nga idetë, problematika e niveli artistik përqaset me krijimtarinë e Xhojsit, Prustit e Kafkës. Vetëm kjo do të mjaftonte që ky shkrimtar të mbetej i panjohur e i ndaluar për lexuesin shqiptar për dekada me radhë. Së fundmi, edhe në shqip, janë botuar libra me tregime e novela të këtij prozatori të shquar.

Robert Musil: shkrimtari dhe romani i tij

Robert Musil u lind më 6 nëntor 1880 në Klagenfurt - Corinzia, Austri. Pas një fëmijërie të vetmuar, studioi në një kolegji ushtarak, më tej ndoqi inxhinierinë mekanike e më vonë kurset e filozofisë e të psikologjisë në Berlin, ku edhe u diplomua. I apasionuar pas letërsisë e filozofisë, u formua si shkrimtar i ardhshëm nën ndikimin e Niçes, Emersonit, Meterlinkut, D'Anuncios, Jakobsenit, Dostojevskit e Oskar Uajlldit. Përpara viteve '20-të, nis krijimtarinë, shkruan edhe sprova që e bënë të njohur, për t'iu kushtuar më pas, tërësisht letërsisë. Me ardhjen e Hitlerit në fuqi ikën nga Berlina, kthehet në Vjenë e, pas pushtimit gjerman, shkon në Zvicër, ku qëndron deri në fund të jetës. Më 15 prill 1942 Robert Musil vdes papritur nga hemorragjia cerebrale, teksa gjendej në tryezën e punës. Ky shkrimtar ka bërë emër në letërsinë botërore me kryeveprën e tij "Njeriu pa vlera" (ose "Njeriu pa cilësi") roman epope me dy vëllime e katërmëdhjetë kapituj postumë, e cila, si shumë kryevepra të disa shkrimtarëve të mëdhenj, mbeti e

pambaruar. Robert Musil, si shkrimtar progresist trajton dhe shpallor në veprën e tij, me një originalitet të spikatur, krizën shoqërore dhe shpirtërore të njeriut dhe të epokës së shekullit XX. Ndër veprat e tjera më të rëndësishme të tij përmenden novelat "Joshja e Veronikës së heshtur" e "Tri gra", drama "Fanatikët" e komedia "Vincenci dhe mikësja e njerëzve të rëndësishëm". Sipas shumë studiuesve e historianëve të letërsisë, Robert Musil është padyshim shkrimtari më i rëndësishëm austriak i shekullit të njëzetë. Veçanërisht me romanin e sipërpërmendur, ai diti të shprehë kuptimin më intim e më të thellë të epokës e të shpirtit që e frymëzonte. Shënojmë se në Austrinë e fillimshkullit të kaluar, zhvilluan krijimtarinë e veprimtarinë e tyre përfaqësues të mëdhenj të kulturës evropiane e botërore. Aty jetuan, punuan e krijuan Hofmanstal, Karl Kraus, Zigmund Frojd, Stefan Cvajg, Oskar Kokoshka, Gustav Mahler, Arnold Shënberg etj, etj. Emri e vepra e Robert Musilit, qëndron denjësisht pranë tyre dhe është e lidhur ngushtë me Vjenën, kryeqendrën evropiane të kulturës e artit. Vjena është dhe skena ku zhvillohen ngjarjet e romanit të tij të famshëm.

Musili dhe Moisiu

Shkrimet kritike të Robert Musilit për Moisiun janë rizbulime të viteve të fundit me rastin e botimit të plotë të veprave të këtij shkrimtari. Në qershor dhe në tetor të vitit 1921, Aleksandër Moisiu ka dhënë një cikël shfaqjesh në Folksteatër (Teatri Popullor), i dyti për nga rëndësia pas Burgteatrit në Vjenë. Ky teatër është drejtuar nga një prej regjisorëve më të mëdhenj të teatrit të shekullit të njëzetë, Maks Rajnhard dhe shfaqjet ishin po të repertorit të Rajnhardit. Në atë kohë, Berlini dhe Vjena ishin dy kryeqendrat e skenave ku interpretonte Moisiu. Për këtë cikël shfaqjesh, Robert Musil, bën një seri shkrimesh kritike në titullin e përbashkët "Moisi-Epilog" dhe si nëntitull "Shfaqja turne e Moisiut në Teatrin Popullor". Këto shkrime kanë për objekt studimi dhe analize interpretimin e Moisiut në rolet e Hamletit, Otellos e Romeos në tragjeditë homonime të Shekspirit, rolin e Carincenit të "Dhe drita ndriçon në errësirë" e Tolstoit, si dhe figurën e Dantonit të "Vdekja e Dantonit" e Byhnerit. Artikujt kritikë të Musilit për Moisiun janë shembuj të një analize të mprehtë, të gjykimit racional, të njohjes së thellë, të koncentrimit të mendimit e sintezës përgjithësuese, të dhëna me gjuhë artistike të denjë për penën e një shkrimtari të madh. Nga ana tjetër, ato dëshmojnë për epërsinë e padiskutueshme të artit të Moisiut, që tashmë kishte pushtuar skenat e Evropës dhe ishte bërë një fenomen artistik. Pikërisht të tillë, si një fenomen artistik e trajton Moisiun, Robert Musili. Veçanërisht në përfundimet që nxjerr e vlerësimet që bën lidhur me rolet shekspiriane të luajtura nga artisti i madh.

Moisiu si ...Hamlet, Romeo, Otello

Për interpretimin e Hamletit nga Moisiu, Musili shkruan: "Ai nuk luan një Hamlet që e vret mendjen shumë, as një udhëzues të metafizikës, as edhe një 'Unë' të përçarë, apo jo? Por, thjesht një njeri fisnik, që do të bëhej hero, nëse fati që i ka rënë mbi shpinë nuk do të qe tepër i rëndë për rininë e tij. Ai e do mëmën e duhet ta përbuzë, ai ndjen neveri për njeriun, por për këtë nuk mund ta vrasë menjëherë! Skena e fantazmës natyrshëm bëhet si një zë i brendshëm. Te takimi me shokët e tij të studimit bëhet për një çast më i ri. E gjithë kjo ka shkëlqimin e një temperamentit të madh e të errët që vihet re tek ky Hamlet. Ai nuk përpiqet (të jetë), ai është... Ekzistenca e aktorit të madh është: të ngjitet nëpërmjet shembujve... prandaj arti aktorial zbrazet kaq lehtë, imitim pas imitimesh, pashpirt, dinamik, armik ndaj artit. Ai duhet të gjallërohet nga aktorë si Moisiu, të cilët dinë të lexojnë partiturën."

Komenti ynë mbi këtë pjesë do të qe i tepërt. Po nënvizojmë vetëm theksimin e temperamentit të veçantë të aktorit, që edhe nga kritikë të tjerë bashkëkohës është vënë re te Moisiu. Interes të veçantë paraqet përqasja e këtyre vlerësimeve me gjykimin e mësipërm: Maks Brodi shënon


efektin e mrekullueshëm të artit magjepsës të Moisiut dhe thekson: "Hamleti është shkruar për Moisiun dhe Moisiu ka lindur që të interpretojë Hamletin dhe vetëm ai të interpretojë Hamletin!". Feliks Salteni e quan rolin e Hamletit "shkallën më të lartë që ka dhënë përsosja artistike e Moisiut..." dhe se "ai rroku menjëherë konceptin gjenial dhe krejt njerëzor të kësaj figure të pavdekshme".

Në kohën kur Robert Musil bën vlerësimet e tij, Moisiu ishte formuar plotësisht si artist i madh i teatrit shekspirian. Falë forcës së tij gjeniale e talentit të tij të rrallë, përvojës dhe pjekurisë artistike, ai mund t'i lejonte vetes ta kapërcente Shekspirin. Besojmë se këtu e ka fjalën Musili ku shkruan për Moisiun në rolin e Romeos: "Moisiu... e mposht figurën. Ai luan një vëlla jugor të Hamletit të tij, një riosh të rrëmbyer, më shumë të vetësigurt, erotik, që gjithsesi, atij i ishte stamposur në fytyrë. Ngjashmëria nuk qëndronte në shpirt, por në mish, në zë, në të pavullnetshmen, në rrethin e dukjes... Por një (Romeo) të tillë, të sendërtuar

me penel modern, Shekspiri nuk do të kishte të lehtë ta përshkruante". Në galerinë e roleve shekspiriane, të realizuara nga Aleksandër Moisiu, është dhe roli i Otellos. Për interpretimin e Moisiut në këtë rol, nga kritikë të kohës, janë bërë vlerësime të ndryshme, jo gjithnjë pozitive. Në kundërshtim me këto të fundit, për Robert Musilin, Otello i Moisiut është "një qenie e veçantë, një qenie magjike arti, një kafshë përralle, (që) kishte gjetur një gur të çmuar, një copë xham vezullues, e mbante atë në grusht dhe e shikonte gjithnjë me shpesh, ashtu si gjithë të çmendurit e botës. Dhe kjo ishte Desdemona." Shkrimtari austriak, me gjykimin e një njohësi e kritikë shijehollë, nënvizon në artin e madh realist të Moisiut - Otello, një figurë të ndërthurur me zgjuars, thekson aftësinë në zberthimin e trajtimin e veçantë të karakterit, forcën e talentit që shpesh arrin përmasa të tilla, për të cilat ai është i mendimit se "ne duhet t'i njohim edhe kur nuk i kuptojmë."

Mjeshtri i penës për Mjeshttrin e skenës...

Vëmë re se, përveç analizës koncize, por të mjaftueshme, pa hyrë në detaje të hollësishme, me penelata të shpejta, Musili bën vlerësime për dhunti, karakteristika e cilësi të qenësishme të artit të Moisiut. Pa u ndalur te gjuha e vlerat e larta shprehëse e profesionale të shkrimeve të një mjeshtri të penës - për një mjeshtër të skenës, këtu po citojmë, shkurt, disa shembuj nga të cilët mund të nxirren lehtësisht përfundime. Për madhësinë e interpretimit: "Moisiu është në mënyrë të paimagjinueshme i bukur. Këtu natyra ka vendosur një kufi, të cilin mendja njerëzore e kapërcen vetëm indirekt ose nuk e kapërcen fare. Por, mendja dhe interpretimi i Moisiut duket sikur e kapërcen këtë kufi:" (në rolin e Romeos). Për zërin e aktorit, Musili shkruan: "Vetë muzika magjike e zërit të tij është një muzikë e bukurisë së copëtuar". Për plastikën: "Gjestet e tij kanë diçka gjysmë të rritur, gjysmë të endur..., ato flakërijnë me gjallëri, gjarpërohen atje tej, thurin flamuj të zjarrtë, pastaj fundosen përsëri në ëndrrën e lëmuar," (në rolin e Hamletit). Për përku-



shtimin: "Moisiu luan me patos fund e krye" (në rolin e Dantonit) etj. Më tej, në shkrimet për turneun e shfaqjeve të Moisiut në Volkstheater, Musili vlerëson arritjet e suksesin e këtij aktori të pakrahasueshëm në rolin mjaft të vështirë të Dantonit në pjesën "Vdekja e Dantonit" e G. Byhnerit dhe në rolin e Carincenit në pjesën "Dhe vdekja ndriçon në errësirë" e L. Tolstoit. Përmbajtja e këtyre shkrimeve na duket me interes, jo vetëm

për vlerat njohëse e këndvështrimin origjinal, por edhe për ndihmesën që sjellin në zbulimin e rivlerësimit e cilësive dhe aftësive interpretative skenike të artistit të shquar.

Në mbyllje....

Besojmë se shkrimet e shkrimtarit të shquar austriak Robert Musil për Moisiun nuk janë të vetmet që nuk njihen ndër ne. Megjithatë punë e bëre

nga studiuesit tanë, në bibliotekat dhe arkivat e teatrove të qyteteve (Vjenë, Berlin, Pragë, Shën Petërsburg, etj.) ku luajti e krijoi Aleksandër Moisiu gjendet një pjesë e pazbuluar e trashëgimisë së shkruar për jetën e veprën e këtij gjeniu të skenës. Rrahja e gjoksit e krenaria jonë për origjinën e tij shqiptare na vë domosdoshmërisht përpara një detyrimi të madh. Kërkimi, zbulimi, studimi i thelluar e sistemimi me kritere

shkencore i kësaj trashëgimie, është në nderin dhe detyrën e institucioneve tona të shkencës, kulturës e artit si dhe të studiuesve të artit të aktorit. Në këtë kahe, një punë të vlerëshme bën "Fondacioni Aleksandër Moisiu", arkivat e të cilit u shfrytëzuan përkëtë punim që nuk është gjë tjetër, veçse një qasje modeste ndaj vlerësimeve të një shkrimtari të mirënjohur si Robert Musil për bashkëkohësin e tij të madh, aktorin Aleksandër Moisiu.

Pikëpamje

NJERIU I REVOLTUAR OSE NJERIU QË THOTË JO!

Sado paqartësisht qoftë, nga fryma e revoltës lind një vetëdijësim: perceptimi, befaz shkëlqimtar, se te njeriu ekziston diçka me të cilën njeriu mund të njëjtësohet, qoftë dhe për një kohë të caktuar



Albert CAMUS

Ç'është një njeri i revoltuar? Një njeri që thotë jo. Mirëpo, nëse ai kundërshton, ai nuk heq dorë: ai është gjithashtu një njeri që thotë po, sapo bën lëvizjen e parë. Një skllav, i cili ka marrë urdhra gjithë jetën, por që papritur e gjykon të papranueshme një urdhëresë të re. Cila është përmbajtja e kësaj "jo"-je? Ajo do të thotë, për shembull, "gjërat kanë zgjatur së tepërmi", "deri këtu po, përtej jo", "po shkoni tepër larg", apo dhe, "ka një kufi që nuk do ta kapërceni". Shkurt, kjo "jo" pohon ekzistencën e një kufiri. Të njëjtën ide të një kufiri e ndeshim sërish në ndjesinë e të revoltuarit se tjetri po

"e tepron", se ai po e shtrin të drejtën e tij përtej një kufiri nga ku një tjetër e drejtë i del përpara dhe e kufizon atë. Kësisoj, fryma e revoltës mbështetet, njëherazi, mbi kundërshtimin e prerë të një ndërhyrjeje të gjykuar si të papranueshme dhe mbi sigurinë e vagullt për një të drejtë të pamohueshme, ose më saktë përshlytjen, tek i revoltuari, se ai është "në të drejtën e tij për...". Revolta nuk mund të mendohet pa ndjesinë se ti vetë, në njëfarë mënyre, dhe diku, ke të drejtë. Pikërisht për këtë skllavi i revoltuar thotë njëherazi po dhe jo. Ai pohon, në të njëjtën kohë me kufirin, gjithçka që ai vë në dyshim dhe kërkon të mbrojë brenda këtij kufiri. Ai demonstroi, me vendos-

mëri, se tek ai ka diçka për të cilën "ia vlen të...", që kërkon të mbahet parasysh. Në njëfarë mënyre, ai i kundërvë rendit që e shtyp një lloj të drejte për të mos qenë i shtypur përtej asaj që ai mund të pranojë. Brenda çdo revolte, në të njëjtën kohë me neverinë për furacakun, ka një aderim të plotë dhe të atypëratyshëm të njeriut me një pjesë të caktuar të vetë atij. Ai vë kështu në veprim në mënyrë të vetëvetishme një gjykim vlerësues, dhe aq pak të papërfillshëm sa që i përmbahet atij përballë çdo rreziku. Deri atëherë, ai heshtte të paktën, duke e lëshuar veten nga dëshpërimi kur një gjendje, edhe kur gjykohej si e padrejtë, pranohet. Duke heshtur, lë të besohet se nuk

gjykon dhe nuk dëshiron asgjë dhe, në disa raste, do të të thotë vërtet të mos dëshirosh asgjë. Dëshpërimi, si dhe absurdja, gjykon dhe dëshiron, përgjithësisht, gjithçka, dhe asgjë, në veçanti. Heshtja e shpreh mirë këtë gjë. Mirëpo, nga çasti kur ai flet, edhe duke thënë jo, ai dëshiron dhe gjykon. I revoltuari, në kuptimin etimologjik, bën prapakthehu. Ai ecte nën kamxhikun e të zotit. Dhe ja ku i kthehet përballë. Ai ballafaqon atë që është e pëlqyeshme me atë që nuk është e tillë. Jo çdo vlerë bën që të lindë revolta, por çdo frymë revolte i referohet heshtas një vlere. Por a kemi të bëjmë të paktën me një vlerë? Sado paqartësisht qoftë, nga fryma e revoltës lind një vetëdijësim

im: perceptimi, befas shkëlqimtar, se te njeriu ekziston diçka me të cilën njeriu mund të njëjtësohet, goftë dhe për një kohë të caktuar. Deri atëherë, ky njëjtësim nuk ishte përjetuar në mënyrë të njëmendtë. Të gjitha keqtrajtimet e kohës para frymës kryengritëse, skllavi i duronte. Madje shpesh, ai u ishte bindur pa kundërshtim dhe urdhrave më revoltuese se ai që shkakton mosbindjen e tij. Ai bënte durim, duke i

flakur tej ndoshta brenda vetes, por, përderisa heshtte, ishte më i shqetësuar për interesa të atypëratyshme sesa i vetëdijësuar edhe për të drejtën e tij. Me humbjen e durimit, lind përkundrazi një frymë e cila shtrihet mbi gjithçka që, më parë, ishte pranuar. Ky vrull është thujtë gjithmonë pasveprues. Në çastin kur hedh poshtë urdhrin poshtëruës të eprorit të vet, skllavi hedh poshtë njëherazi vetë gjendjen e tij prej skllavi.

Fryma e revoltës e çon më larg se ç'ishte në kundërshtimin e thjeshtë. Ai kapërcen madje kufirin që kishte përcaktuar për kundërshtarin e tij, duke kërkuar tani të trajtohet në mënyrë të barabartë. Ajo çka ishte fillimisht një qëndresë e paepure njeriut, bëhet tërë qenia e tij, e cila njëjtësohet me këtë qëndresë dhe përmbledhet në të. Këtë pjesë të vetvetes që ai kërkonte të respektohej, ai e vendos tashmë mbi gjithçka tjetër, dhe

shpall më të parapëlqyerën nga çdo gjë, madje dhe në raport me jetën. Ajo shndërrohet për të në pasurinë më të epërme. Skllavi, që deri atëherë gjente strehë brenda një kompromisi, rend befas ("përderisa është kështu...") drejt kërkesës "Gjithçka ose Asgjë". Vetëdija lind bashkë me revoltën.

(Përktheu Ilia Lëngu)

Midis nesh

DIÇKA KA MARRË FUND

(Një tekst brilant dhe, ndonëse i shkruar në një kohë tjetër, është më shumë se aktual)



György KONRÁD

Kur gjithçka përreth nesh ndryshon, është e pamundur që ne të mos ndryshojmë. Letërsia si institucion kombëtar - çka ishte në kohën e socializmit - nuk ekziston më. Ka marrë fund periudha e librave të subvencionuar që, si të kishin lexues, si të mos kishin, shtetit pak i interesonte. Tashti nuk mund të jesh më as propagandist i madh dhe as heretik. Deviacionet politike nuk kanë më për terren letërsinë. Kritika ka si vend shprehjeje parlamentin apo gazetën, ajo s'mund të luajë më kukamshefti në teatër. Në ditët tona pohimet politike rrallë i çudisin njerëzit, madje ka filluar të funksionojë kundërpesha e indiferencës. Në pjesën më të madhe të debateve të njerëzve, shkrimtari nuk është tjetër veçse një amator. Të shkruarit është bërë një mjeshtëri

më pak serioze sesa ç'ka qenë dikur; më tepër trajtohet si një pasatempo, dëfrim apo diletantizëm. Vendi tonë për të thënë gjëra sublime e kanë zënë priftërinjtë. Ndërkaq, burrat e shtetit mbajnë në duar tekste që redaktorët e tyre i kanë ujdur për mreku. Pra, edhe shprehja e ideve të larta nuk është më detyra jonë. Në një demokraci liberale bashkëqytetarët tanë nuk kanë më nevojë për udhëheqës shpirtërorë. Ata do të vazhdojnë të kenë nevojë për libra të mirë. Shkrimtari ka pasur një rol të dukshëm pozitiv apo negativ vetëm në sistemin socialist. Në një shoqëri borgjeze, ai është një person privat nga i cili mund të përfitohet diçka. Në demokracinë liberale - të paktën për aq sa ne e jetojmë, - poezia rikthehet tek hobi; teksti i shkrimtarit është një çështje private. Po qe se ai u intereson vetëm pak vetave, ai mund

ta botojë me paratë e tija në njëmijë apo dymijë kopje. Vetëm disa vjet pas ndryshimeve shkrimtarët i ka zënë drithma: a ka më vërtet nevojë për ta?

Artisti dyshon se është bërë një personazh i dalë mode. Shteti nuk ia ka më nevojën, kurse tregu nuk mund ta mbështesë financiarisht. Shteti kishte nevojë për të me kusht që ai të mos ishte shumë bezdisës. Dje kishte një kulturë shtetërore të krijuar nëpërmjet veprave që kishin kaluar censurën si dhe një kulturë të pacensuruar që e plotësonte atë. Po sot? Paratë e shtetit vazhdojnë të mbështesin një kulturë që pak a shumë i qëndron përsëri besnikë atij. Mbështetja e kulturës joqeveritare i mbetet sektorit privat, i cili nuk është në gjendje ta bëjë këtë si duhet. Librat po bëhen gjithnjë e më të shtrenjtë, kurse lexuesi gjithnjë e

më i varfër; gjithçka po shembet nën peshën e romanit komercial; njerëzit kanë më pak kohë dhe më pak para për letërsinë; shumë shkrimtarë praktikisht janë të papunë. Ka marrë fund koha e sigurisë, kur një libër në vit i subvencionuar nga shteti përmbushte edhe nevojat tona materiale.

* * *

Letërsia po zë gjithnjë e më pak vend në jetën tonë. Ka marrë fund një epokë e historisë së letërsisë dhe këtë ne nuk e kuptuam kur po ndodhte, por vetëm pasi ndodhi; në nivelet institucionale letërsia ka zbritur një kat më poshtë. Republika e letrave - si korpus intelektual, si fanar i qytetërimit - i përket së shkuarës. Ja ku erdhi koha e sprovës, kur dikujt i duhet ta ndërrojë letërsinë me një aktivitet tjetër, duke u bindur se nuk mund të ndiqet

t i njëjti zanat gjatë gjithë jetës. Edhe botimet po kalojnë të njëjtën krizë si sektorët e tjerë të ekonomisë: edhe letërsia po ecën paralel me varfërimin e shoqërisë. Megjithatë, këtë epokë të karakterizuar nga humnera midis çmimeve astronomike të librave dhe fuqisë së dobët blerëse unë e quaj tranzitore dhe besoj se letërsia do të mbijetojë. Pas disa vitesh do të shfaqet një klasë e mesme e kamur, e cila do ta kërkojë letërsinë. Herët a vonë gjërat teknike do të kenë çmime të përbalueshme dhe aftësia blerëse do të rritet. Gjatë kësaj ndërkohe, në këto vite të lopës së dobësuar, do të vazhdojnë të shkruajnë pareshtur vetëm shkrimtarët e regjur dhe diletantët e përjetshëm. Vazhdimësia e një veprë nuk mund të sigurohet veçse nëpërmjet një këmbënguljeje prej murgu. Duhet një kurajo dhe siguri e veçantë për të guxuar të angazhohesh në një ndërmarrje letrare jetëgjatë. Shumë shkrimtarë, për të siguruar kësh-tu mbijetesën, do të shtrëngohen të bëhen intelektualë profesionistë dhe, nëse do t'u mbetet pak fuqi, herë pas here edhe do të shkruajnë. Paralelisht me mecenatin e shtetit, meceneve privatë, ndërmarrjeve, fondacioneve u bëhet thirrja që të luajnë një rol gjithnjë në rritje: atë të rish-përndarjes së vlerave qytetare. Edhe dy faktorë të tjerë do të kontribuojnë për ta mbajtur gjallë letërsinë: shtypi dhe botimet jashtë shteti. Disa gazeta zhduken, të tjera shfaqen; media elektronike dhe media e shkruar konsumojnë një numër të madh tekstesh. Pasi mbaron me informacionet e ditës, që zënë faqet e para, lexuesi arrin me një ndjenjë lehtësimi te tekstet me tjetër përmbajtje të shkrimtarëve. Pasi ka dëgjuar intelektualët politikanë dhe spërdredhjet e pseudo të pavarur, ai ndjen nevojën të dëgjojë pikëpamje më të menduara, thjesht personale. Në një terren vlerash të pasigurta, ndjehet nevoja për njerëz që të shërbejnë si pika referimi. Disa gjëra kanë nevojë për emra, për autoritete dhe tekste të lidhura mirë. Sa më kapricioze dhe e pasigurt të jetë jeta publike, sa më e madhe të jetë pasiguria e bashkëqytetarëve, aq më shumë ndjehet nevoja për gjykime personale të përpunuara dhe peshuara me përgjegjësi. Ndiham tjetër është tregu ndërkombëtar i librit. Orientimi i përgjithshëm i Evropës Perëndimore është rritja e interesit për evropianët e tjerë, dmth për njerëzit e tjerë. Të pranosh që atdheu ynë kulturor përputhet pikë për pikë me territorin e shtetit tonë, ose që, në rastin më të keq, ai shtrihet deri në kufijtë e komunitetit tonë gjuhësor, kjo, sipas meje, do të thotë të dhunosh atë çka quhet identitet. Në lindje të perdes së hekurt rizgjimi i ndjenjave nacionale ka qenë një faktor i fuqishëm për dizintegrimin e bllokut sovjetik, atij që quhej "sistemi botëror i socializmit". Këto ndjenja kombëtare

nuk kanë qenë vetëm katalizatorë në marrëdhëniet me vendet e ish-kampit socialist, por kanë kontribuar edhe për shkëmbimin e kulturave zyrtare, çka bënte pjesë në ritet e asaj kohe. Sot nuk është gjetur ende kohë dhe as nuk janë bërë përpjekje për të realizuar një dialog real midis kulturave të Evropës qendrore dhe lindore. Kësaj i duhet shtuar edhe skleroza e tregut të librit - sipas pesimistëve, rrënimimi i tij. Në vendet tona është e vështirë të gjesh best-seller. Në shekullin XX njerëzit e letrave e kanë ekzagjeruar rolin e tyre: ata janë bërë propagandistë, predikatorë të një ideje apo të një tjetre, urrejtës të armiqve të ndryshëm, demonizues; kanë luajtur edhe rolin e udhëheqësit shpirtëror. Sotata duhet ta humbasin këtë peshë. Shtetet ideologjike nuk do të kishin mbijetuar pa kontributin besnik të intelektualëve. Tani, sëpaku njëri prej kapitujve të angazhimit të tyre jashtëletrar është mbyllur. Nuk është më e detyrueshme të shkosh përtej zanatit tënd e ta ngatërrosh letërsinë me diçka që nuk është e tillë. Ngatërrimi i letërsisë me gjëra të tjera ka lidhje gjithmonë me një shtysë thuajse morale. Disa autorë mendojnë se pa ta asgjë nuk mund të ecë më. Ata sikur ia behin në çastin e fundit, përpara katastrofës finale, për të shpëtuar, - po çfarë?

*

*

*

Për mua shekulli i XX fillon me lindjen time më 1933, tamam në vitin kur nazistët erdhën në pushtet. Shekulli ynë është karakterizuar nga ide të e atyre radikalëve, sipas të cilëve ishte diçka e mundshme, madje e dëshirueshme, që ta merrje pushtetin me çfarëdo mjeti, qoftë edhe me forcë, dhe të mos e lijmë atë. Njerëzit dhe fjalët endeshin midis mentaliteteve revolucionare nacionaliste dhe atyre socialiste. Rruga e shumë intelektualëve shkante nga njëra tek tjetra. Tensioni midis politikës dhe kulturës është i përhershëm - ato as nuk mund të bashkohen me njëra-tjetrën dhe as të ndahen. Në shekullin XX politika hyri në shtëpi, në vatra, në telefona, në kafkat e njerëzve. Fashizmi, ashtu sikurse dhe komunizmi, rrëmoi në sirtaret tona për të na gjetur shkrimet në emër të mbrojtjes së shtetit. Është në interesin tonë ta kontestojmë çdo lloj ideje që i lejon shtetit të kryejë abuzime të tilla. Në diktaturë është e pamundur ta harrosh politikën. Ngacmimet e saj të vazhdueshme dhe të mërzitshme ndërkallen fuqimisht në kujtesën tonë. Askush nuk mund të ishte vërtet naiv, të gjithë ishin të kujdesshëm. Fryma e shtetit nuk mund të çlirohej dot nga mbajtja anë, po ashtu edhe ajo e kundërshtarëve të tij, edhe e pjesës që mbetet; atyre që kërkonin një qoshezë të qetë për të mos rënë në sy. Sot sytë shndrisin nga kurioziteti. Njerëzit duan të dinë se cila është gjendja, duan të shohin qartë.

Qytetari mesatar është shumë më i vështirë nga ç'ka qenë tre vjet më parë; ai ka mësuar shumë dhe do të mësojë edhe më. Ai i kërkon gjërat "këtu dhe tani". Njeriu sot është ai që është dhe jo ai që do të mund të ishte në një regjim të ndryshëm. Ky kapitalizëm social-kombëtar do ta ketë jetën të gjatë. Tash e mbrapa me të do të jetojmë; atë do të na duhet të shfrytëzojmë dhe mallkojmë. Dyshuesit kërkojnë vlera, por ndërkaq nuk e vrasin njëri-tjetrin, askush po vdes nga politika. Me perde apo pa perde të hekurt e gjitha kjo nuk është një punë fort e keqe. Tani ka më shumë të varfër, nesër do të ketë më pak. Tani ka shumë grabitje me armë; pas ca kohësh do të ketë më pak. Bankierët dhe intelektualët ndjehin një lloj tërheqje ndaj njëri-tjetrit, por veçanërisht intelektualët. Është zhdukur një enigmë. Nuk ka mbetur veçse ajo që shikojmë. Ajo çka shihet mbi të gjitha është ky kthim i xhakëtës së prapthi, ky ndryshim i madh i retorikës. Kthesat historike shoqërohen me një lloj të ri amnezie. Shumë veta kanë përshtypjen se atyre u kanë vjedhur të kaluarën. Tashmë është e qartë se pjesa më e madhe e gjërave që ata kishin mësuar nuk ishin tjetër veçse budallallëqe. Ata nuk i entuziazmon e ardhmja, do ta durojnë atë, ndoshta edhe do ta duan, por vetëm e vetëm sepse ajo ekziston. Librat e mirë do të lindin së bashku me stabilizimin e identiteteve të reja; kur njerëzit e të sotmes do të kenë kuptuar ata të së djeshmes dhe të së par djeshmes - kur të jetë krijuar ajo gjendje shpirtërore që do të marrë parasysh kompleksitetin nganjëherë aq tragjik të fateve njerëzore dhe kombinimet e frikshme vetëjustifikuese të njerëzve të kësaj zonës sonë. Nëse një letërsi e tillë do të lindë, ajo do ta tregojë kursin e historisë si diçka që buron nga absurdi dhe që zgjon aq e aq aspirata aspak absurde, fort të arsyeshme, e madje dashamirëse. Koha e tregimit, e dialogut epik vjen vetë. Tani çështja shtrohet: kush mbizotëron në letërsi, dialogu apo logjika e mbrojtjes së klanit? A jemi ne në gjendje ta transformojmë të kaluarën në një gjini epike? Atë të kaluar që opinioni publik ende e konsideron si një fenomen që ka të bëjë me modat ideologjike? Cili është mësimi më i rëndësishëm që mund të nxjerrim nga shekulli XX? Fakti që kemi mbijetuar nuk provon ende që aventura jonë ka qenë e arsyeshme. A mundet njeriu të ketë një fat të arsyeshëm në një histori të paarsyeshme? Ne i kemi mbyllur vitet tetëdhjetë dhe kemi hyrë në vitet e panjohur nëntëdhjetë që shtrojnë përpara nesh pyetjen: në fund të mijëvjeçarit të dytë, a do ta festojë njerëzimi me mirënjohje krijimin e tij, me gëzimin që ende mundet të ekzistojë, që nuk e ka braktisur ende atë luginë vuajtjesh dhe gabimesh në të cilën e argëtojmë Zo-

tin sipas trilleve dhe aftësive tona? Shekulli XX po mbaron. Ai ka qenë shekulli i agresionit dhe i papërgjegjshmërisë. Marrëzira pa fund, marrëzira të tmerrshme janë derdhur nëpër libra e deri tek varret kolektive. Shkrimtarët, politikanët, oratorët nuk janë të pafajshëm për këtë. Askush nuk është i autorizuar të akuzojë dhe askush nuk ka të drejtë të mos ndjehet fajtor. Ndjenja e fajësisë është pamja tjetër e ndjenjës së përgjegjësisë. Ai që merr mbi vete përgjegjësi për të ardhmen duhet të mbajë përgjegjësi edhe për të kaluarën, përndryshe njerëzve të dobët do t'ua zënë vendin të tjerë njerëz të dobët. Ku qëndronte papërgjegjshmëria e shekullit XX? Tek ajo fryrje dhe irritim i unit kolektiv, që çoi në luftrat dhe diktaturat. Ky "un kolektiv" i rëndomtë, të cilit ia pushtuan ndërgjegjen ethe dhe flaka, ndërmori një ekspansion brutal, theu rregullat e fqinjësisë së mirë, kujtoi se vetëm ai duhej të mbretëronte, ndy ajrin dhe ujin e tjetrit, komplotoi bombardimin e tij, koleksionoi argumente të bukur për të justifikuar dhomat e gazit, shpalli epërsinë e komunitetit të vet si dhe misionin e tij universal. E kam fjalën për vanitetin kolektiv, natyra e vërtetë e të cilit shpaloset sapo një person i vetëm filon të na shpjegojë, jo në vetën e parë shumë, por në vetën e parë njëjës, arsyet pse ai është më i mirë se të tjerët.

Argumentet e mi mund të bëhen pluhur e hi; ndoshta optimizmi im është patologjik, megjithatë jam optimist. Përse? Sepse unë konstatoj që shumë koka të forta ecin përpara me guxim, që vendi funksionon, që fusha është e hapur jo vetëm për mashtruesit, por edhe për themelonjësit. Ka mbërritur koha e themeluesve të fondacioneve. Sot janë shumë më të pakët ata që e presin gjithçka të vijë nga lart. Qeveria ndërhyr më pak për të ndaluar dhe kjo nuk është gjë e keqe. Ai ankthi i hidhët që e karakterizonte njeriun socialist është i pranishëm edhe te njeriu postkomunist; veçse tani frika vjen nga të tjera gjëra. Ne do ta shihnim me dyshim një njeri që nuk do të ishte i rrethuar nga frikëra dhe ankthe gjithfarëshe. Ne e shohim ankthin të na vijë në mbrëmje, përpara një gote me verë, teksa për apokalipsin, por të nesërmen u kthehemi punëve. Përderisa njerëzit përpiqen të jenë gjithnjë e më shumë zotë të situatës së tyre, përderisa puna e papërgjegjshme ka të bëhet objekt përçmimi, mund të thuhet se gjërat thuajse kanë filluar të funksionojnë. Autori i këtyre radhëve nuk i trembet as tiranisë dhe as luftës civile; ashtu si pjesa më e madhe, ai ndjehet si një "i urtë për t'u lidhur". Nuk ka as galop dhe as humnerë, vetëm një hap të vogël të madh.

(Përktheu F. Lubonja)

NUMRI I ARDHSHËM MË 1 MARS

HEJZA

15 Shkurt, 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shala & Rexhepi

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000